

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS  
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS  
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË

# KRIJIMTARIA LETRARE E ALI ALIUT

(Në 90-vjetorin e lindjes)

Tryezë shkencore

Prishtinë, 2 prill 2024



PRISHTINË  
2024

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS  
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS  
SECTION OF LINGUISTICS AND LITERATURE

ACADEMY OF SCIENCES OF ALBANIA

# ALI ALIU'S LITERARY WORK

(On the 90<sup>th</sup> anniversary of his birth)

A discussion

Prishtina, 2 April 2024

Organizing Committee: Academician Sabri Hamiti, chair,  
Academician Mehmet Kraja, member, Academician Shaban Sinani, member

Editor: Academician Sabri Hamiti, Secretary of the Section of Linguistics and Literature



PRISHTINA  
2024

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS  
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS  
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË

# KRIJIMTARIA LETRARE E ALI ALIUT

(Në 90-vjetorin e lindjes)

Tryezë shkencore

Prishtinë, 2 prill 2024

Këshilli organizues: akademik Sabri Hamiti, kryetar,  
akademik Mehmet Kraja, anëtar, akademik Shaban Sinani, anëtar

Redaktor: akademik Sabri Hamiti, Sekretar i Seksionit të Gjuhësisës dhe të Letërsisë



PRISHTINË  
2024

Copyright © ASHAK

## PËRMBAJTJA

Sabri Hamiti FJALA E HAPJES .....	9
Mehmet Kraja PËR ALI ALIUN, FJALË RASTI .....	11
Sabri Hamiti ALI ALIU BASHKËKOHËS .....	13
Shaban Sinani PËRTEJ KUFIJVE TË NËNSISTEMEVE TË LETËRSISË SHQIPE.....	29
Matteo Mandalà “KUR DON KISHOTI ZBRITI NDËR ARBËRESHË”: JERONIM DE RADA NËN PRIZMIN KRITIK TË PROF. ALI ALIUT.....	41
Zejnullah Rrahmani ALI ALIU – PËRBALLË NJË SHEKULLI .....	53
Nysret Krasniqi ALI ALIU: LIRIKU I KRITIKËS.....	63
Arian Leka E ARTA E POEZISË SHQIPE .....	73
Fatmir Sulejmani NJERIU, STUDIUESI DHE KRITIKU LETRAR ALI ALIU .....	81

Zija Çela	
I PANGJASHËM MES TË NGJASHMËVE.....	95
Resul Shabani	
AKADEMIK ALI ALIU – ANTOLOGJIST .....	99
Rexhep Ismajli	
DISKUTIM: IMPRESIONI / REFLEKSIONI.....	111
Ali Aliu	
FJALA PËRSHËNDETËSE .....	113





Sabri Hamiti

## FJALA E HAPJES

Kolegë të nderuar e të çmuar akademikë, kolegë të dashur dhe miq të pranishëm,

I nderuar akademik Mehmet Kraja, kryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës,

I nderuar dhe i dashur akademik Ali Aliu,

Sot kemi në program Tryezën shkencore *Krijimtaria letrare e Ali Aliut* në 90-vjetorin e lindjes së tij, të cilën e organizon Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, së bashku me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë.

Ali Aliu është një personalitet i njohur sot në botën shqiptare. Tryeza jonë është e fokusuar vetëm në krijimtarinë e tij letrare, sepse puna e tij që nga fillimet lidhet edhe me mësimdhënie në universitet, edhe me punë redaktoriale në botimet shqipe, edhe me punë politike që ka qenë e koncentruar në politikën nacionale për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, në lëvizjen e njohur të prirë nga Ibrahim Rugova. Në punë letrare ka mbi gjashtë decaie që Ali Aliu është paraqitur me shkrimet e veta dhe kjo vijon deri më sot. Ai është i përkushtuar në shkrime letrare edhe sot si para pesëdhjetë vitesh. Ky besoj është një kompliment i sojit të veçantë për kontinuitetin e paprerë të leximit dhe interpretimit të letërsisë shqipe. Studimet e tij janë botuar në dhjetra libra shqip dhe janë përkthyer edhe në gjuhë të tjera.

Krijimtaria letrare e Ali Aliut përbëhet nga kritika e studime letrare, përkthime letrare nga gjuha shqipe dhe në gjuhën shqipe, antologji letrare të letërsisë shqipe dhe antologji letrare të letërsisë së përbotshme, është botuar në dhjetra libra në Prishtinë, në Shkup dhe në Tiranë, duke pasur një seri botimesh e përkthimesh në gjuhë të ndryshme.

Libri i tij më i vlerësuar, *Don Kishoti te shqiptarët*, ka pasur disa botime në shqip si dhe përkthime në gjuhë të huaja përfshirë gjuhën angleze.

Përsëhendes dhjetë kumtuesit në këtë Tryezë, të cilët do të lexojnë sipas rendit në program.



Mehmet Kraja

## PËR ALI ALIUN, FJALË RASTI

Të nderuar kolegë, akademikë dhe të tjerë të pranishëm,

Në mënyrë të veçantë, dua të përshëndes me këtë rast akademik Ali Aliun, mikun tonë të përbashkët, njërin nga veteranët e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe, në një mënyrë, sinonim i saj, dhe në emër të po kësaj Akademie t'i uroj 90-vjetorin e lindjes, t'i uroj shëndet, vullnet pune dhe forcë të pashtershme krijuese.

Më lejoni të them me këtë rast se njohja ime me akademik Ali Aliun, si e disa të tjerëve që jemi këtu të pranishëm, ka filluar që më shumë se pesëdhjetë vjet dhe, si për të gjithë kolegët e mi, ka qenë dhe është miqësi e gjatë substanciale, sepse ka qenë dhe është miqësi letrare, është miqësi krijuese. Kjo miqësi ka një konstante të vazhdueshme: është miqësi e njerëzve që bëjnë letërsinë dhe institucionin, miqësi mbi parime të respektit ndaj vlerave krijuese, të cilat Ali Aliu i kërkonte, i hulumtonte dhe i promovonte më shumë se çdokush tjetër. Ai na promovoi të gjithë neve, të gjithë poetët dhe prozatorët, të Kosovës dhe të Shqipërisë, pa bërë asnjë ndarje. Për të, letërsia shqipe ishte një dhe e pandarë, të tillë e shihte, të tillë e trajtonte, të tillë e promovonte. Promovoi, vlerësoi dhe afirmoi, duke shkruar qindra e qindra faqe për të gjithë poetët dhe prozatorët, veçmas për ata që vazhdojnë të qëndrojnë në themelet e asaj që sot quhet letërsi bashkëkohore shqipe: Esad Mekuli, Petro Marko, Din Mehmeti, Jakov Xoxa, Adem Gajtani, Fatos Arapi, Azem Shkreli, Ismail Kadare, Rexhep Qosja, Fahredin Gunga, Dritëro Agolli, Rrahman Dedaj, Xhevahir Spahiu, Ali Podrimja, Zija Çela, Teki Dërvishi, Beqir Musliu, Musa Ramadani, Basri Çapriqi, Resul Shabani, Sabri Hamiti, Eqrem Basha, Zejnullah Rrahmani dhe mbase edhe nja njëqind të tjerë, përfshirë edhe autorë që ende nuk e kanë stabilizuar vendin e tyre në ndonjë hierarki letrare, qoftë të gjeneratës së parë, të dytë, apo të tretë të letërsisë në Kosovë dhe në Shqipëri.

Ajo që mua më ka bërë përshtypje gjithnjë në shkrimet e Ali Aliut është guximi për të qenë i pari në vlerësimin e një vepre letrare, pa pritur që dikush tjetër të shfaqë mendim para tij. Ai ka ndjekur me shumë vëmendje, dhe me shumë kurajë vlerësimi, pothuajse secilin libër që dilte nga shtypi, të autorëve të rinj ose të vjetër, me një vlerësim të

mbështetur në argumente letrare dhe artistike, por në rend të parë dashamirës për çdo arritje sado të vogël të autorit dhe të botimit përkatës. Ai ka qenë dhe është altruisti më i madh në letërsisë shqipe: shkrimet e tij gjithmonë kanë qenë dashamirëse, inkurajuese. Qasja e tij ka qenë jo vetëm qasje krijuese prej eruditi të shkrimit kritik dhe eseistik, por, mbi të gjitha, ka qenë dhe është qasje e ndjeshmërisë së thellë ndaj substancës vlerore të një vepre letrare. Tek Ali Aliu unë kam parë gjithmonë njeriun që gëzohet sinqerisht kur lexon një vepër të mirë letrare dhe e promovon atë zëshëm, pa ngurrim, pa smirë, gjithnjë duke i mbetur besnik vokacionit primar të kritikut që vlerëson dhe promovon njëkohësisht.

Unë kam lexuar shumë shkrime të Ali Aliut, një numër syresh në dorëshkrim, sepse për një kohë të gjatë kemi bashkëpunuar në të gjithë suplementet kulturorë dhe letrarë që kam redaktuar. Është një bashkëpunim që ka filluar diku në vitet shtatëdhjetë në “Rilindje” dhe ka vazhduar në “Zëri” dhe në “Kohën Ditore”. Edhe sot, me shumë kërshëri, vazhdoj t’i lexoj shkrimet e Ali Aliut, jo vetëm ato që shkruan për mua apo për kolegët e mi, por edhe për ndonjë autor që unë ende nuk kam arritur ta akceptoj si duhet.

Ali Aliu ka një meritë të veçantë edhe në një plan tjetër, që mbase pakkujt i bie ndërmend në rrethanat e sotme: Ai është më meritori nga të gjithë të tjerët që sot letërsia shqipe në Maqedoni trajtohet si pjesë përbërëse e mbarë letërsisë shqipe. Ai nisi herët jo vetëm ta bëjë të njohur këtë letërsi, por me një ngulm të madh ai insistoi që ajo të zërë një vend të dinjitetshëm në kuadër të letërsisë shqipe. Shkroi dhe i promovoi të gjithë autorët e kësaj letërsie, që nga Abdylazis Islami e Murat Isaku, Fejzi Bojku, e deri te Luan Starova, Resul Shabani, Kim Mehmeti, Selajdin Salihu, Fatmir Sulejmani, Ahmet Selmani, Lindita Ahmeti, etj.

Në fund: Profesor, jetë të gjatë, shëndet dhe vepra të reja!

Ju faleminderit!

Sabri Hamiti

## ALI ALIU BASHKËKOHËS

### I. Pasioni i leximit

Ali Aliu (1934) me karrierë gazetari, botuesi, profesori e akademiku, kurrë nuk ka pushuar të jetë lexues i pasionuar i letërsisë shqipe.

Kritika e tij letrare, si shkrim subjektiv i proveniencës së Konicës, mbetet karakteristikë e ligjërimit të tij kritik; në fillime e përqendruar në poezi, e më vonë edhe në prozë e në kritikë. Pasioni i leximit letrar, duke kaluar nëpër zbulimin e vlerës letrare si akt të *mbresës estetike*, bëhet akt i mahnitjes, në penën e tij. Mahnitja lidhet gjithmonë me leximin e parë (zbulues e rekomandues) edhe si akt i promovimit të parë të librit letrar.

Prandaj kritika e tij, plot motivacion e emocion, lindet si dialog me tekstin bashkëkohor në dialog me bashkëkohësinë. Për pasojë shkrimi i tij e ka karakterin e kronikës letrare (kohëtores, me terma të Konicës), i cili një ditë do të bëhet *dëshmi, kërkim, shqyrtim, lexim*; dhe në fund të synojë *sistematizimin*. Këta terma kritikë do të dalin dhe në trajtën themelore të librave të tij kritikë. Gjakimi për diskursin kritik krijues e kushtëzon formën e shkrimit të tij si *ese* dhe *sprovë*, ku teksti është mbështetje themelore për të thurur fantazitë në letërsi e për letërsinë.

Ky veprim vetanak promovon qasjen kritike të admirueshme për shkrimtarë të rinj e bashkëkohës, e po ashtu duke lexuar edhe shkrimtarët e kohëve të përparme, si shkrimtar bashkëkohës. Kjo qasje kushtëzon trajtën e kritikës së tij, me shumë pamje, shumë fytyra, si vetëdije proteike, që u ikën konvencave.

Summa Summarum: kjo vetëdije punën gjysmëshekullore të Ali Aliut e kthen në një *dëshmi letrare* të kohës së tij. Intuicioni dhe kreationi, dikur e lakmon edhe sistematizimin. Prandaj, kjo është fazë e kritikës së tij, që kap deceniet e para të shekullit 21. Fenomeni deshmohet me dy vepra, që provojnë shijen e tij letrare (në poezi) dhe kritikërin e tij interpretues (në kritikë).

Në librin *Antologji e poezisë shqipe* (2002)<sup>1</sup>, Ali Aliu përfshin lirikën shqipe të gjysmës së dytë të shekullit 20, të cilën e karakterizon

---

<sup>1</sup> Ali Aliu, *Antologji e poezisë shqipe: gjysmëshekulli i artë*, Tiranë, 2002.

si ylber shumëngjyrësh, apo e vlerëson si “gjysmëshekulli i artë”. Në këtë antologji përfshihen tridhjetë e nëntë poetë, duke nisur me Vorea Ujkon (1918–1989) e duke mbaruar me Arian Lekën (1966). Në fund të veprës, autori kurorëzon metodën e vet të leximit subjektiv, qoftë në një antologji: “Akëcila antologji, është lexim vetanak. Kjo që po ia ofroj opinionit letrar është leximi im, me përkushtim disavjeçar poezisë sonë”<sup>2</sup>.

Vepra tjetër e Ali Aliut quhet *Libri i jetës* (2020)<sup>3</sup> dhe përbëhet nga një përzgjedhje e kritikave dhe e studimeve të tij për letërsinë shqipe. Në një vëllim prej 528 faqesh, të përbërë nga tri pjesë: I Poezi, II Prozë, III Teori, përfshin shkrimet kritike për poetët: Naim Frashëri, Jeronim de Rada, Andon Zako Çajupi, Ndre Mjedja, Lasgush Poradeci, Fan Noli, Migjeni, Dritëro Agolli, Din Mehmeti, Azem Shkreli, Fatos Arapi, Ali Podrimja, Xhevahir Spahiu, Sadik Bejko dhe Sabri Hamiti; kritikën për prozatorët: Faik Konica, Ismail Kadare, Luan Starova, Zija Çela, Kim Mehmeti, Eqrem Basha, Mehmet Kraja dhe Zejnullah Rrahmani; dhe nëntë tekste ku trajton bukurinë, dashurinë dhe erosin, duke rivizituar autorë ekselentë të letërsisë shqipe.

Autori sugjeron, porse nuk e deklaron, që në këtë zgjedhje përfshihen autorët kanonikë shqiptarë që i paraqet pena e tij kritike. Ali Aliu paraqet *Librin e jetës* së vet, e ne mundohemi të japim shenja të *Jetës së librit* të tij, në botën letrare dhe kulturore shqipe. Ai është bashkëkohës yni, lexuesi e shkruesi pasionant për *magjinë* dhe urtinë e fjalës shqipe. Misionar letrar, që pëlqen dashamirësinë para kritikës së detestimit. Miku i tij i letrave, Zejnullah Rrahmani, së fundmi, e karakterizon: “Akademik Ali Aliu, ky studiues i palodhshëm i letërsisë shqipe edhe në këtë moshë mbetet një lexues i madh i saj, njëri ndër lexuesit më të mirë që ka pasur ndonjëherë”<sup>4</sup>.

Ali Aliu, vetëm kritik vijon ta lexojë letërsinë e aktualitetit. Që nga fillimet me veprën *Kërkime*, deri te libri i fundit *Libri i jetës*, është mbresa, përjetimi i tekstit, alfa e procedimit kritik, ku teksti është pikë referimi për të ngjallur imagjinime. Edhe së fundit, kur bilanci i shkrimeve për autorët, i shpërfaq vetvetiu kadencën e krijimit të autorëve të vetë ikonikë.

<sup>2</sup> Po aty, f. 427.

<sup>3</sup> Ali Aliu, *Libri i jetës*, ASHAK, 2020.

<sup>4</sup> Po aty, *Parathënie*, f. 9.

## II. *Leximi i poezisë*: Pol Valeri/Tomas Eliot

Na tërheq në mënyrë të veçantë fenomeni se e lexojnë poezinë poetët e mëdhenj, si qenie krijuese që shpalon botën e tjetrit duke paraqitur edhe botën e vet. Na mjafton të paraqesim poetin e madh francez Pol Valeri dhe poetin e madh anglez Tomas S. Eliot, që të dytë nyja të forta të modernitetit poetik.

Pol Valeri, poet e poetolog, u kurorëzua më i madhi poet francez që me librat poetikë, *Parka e re* (1917) dhe *Varreza detare* (1920), si dhe me ligjëratat poetike në Collège de France mbas këtyre viteve. Ligjëratën e tij “Fjalë për poezinë”, të mbajtur më 1927, e nis duke bërë dallimin e poezisë si emocion, perceptim të botës së jashtme me poezinë si rimëkëmbje e vullnetshme e emocionit poetik me anë të artificeve të gjuhës. Emocionin poetik e sheh si *ndjesi të universit* për të perceptuar botën që krijon relacione të ndryshme dhe analogji me *universin e ëndrrës*, ku gjërat reale ndryshojnë në ndjeshmërinë e thellë për të krijuar një gjendje poetike. Artet: muzika, piktura e arkitektura janë mënyra riprodhimi që përkojnë me shqisat, por mjeti më i ndërlikuar i riprodhimit është *gjuha*, ku “çdo fjalë bashkon një tingull e një kuptim” – shumë fjalë e shumë kuptime. Teksti gjuhësor mund të trajtohet nga fonetika, semantika, sintaksa, logjika, retorika.

Arti letrar, si art i gjuhës ka dy modalitete: prozën dhe vargun, midis tyre janë llojet e ndërmjetme. Këto dallime Valeri i shpjegon në një traditë kulturore frënge: *ku proza krahasohet me ecjen, ndërsa poezia me vallëzimin*. Ecja, proza ka një objektiv të përpiktë, synim ku arrihet. Vallëzimi, poezia nuk shkon askund, nuk kërkon të arrijë asgjë. Në përdorimin praktik dhe abstrakt të gjuhës në prozë, forma nuk i mbi-jeton të kuptuarit dhe tretet në qartësi. Poezia nuk vdes ngaqë ka shërbyer, forma poetike rikuperohet automatikisht. Prandaj në poezi vlere dhe fuqish “midis formës e mbrendësisë, midis tingullit e kuptimit, midis vjershës dhe gjendjes së poezisë”. Kështu poezia është e dallueshme nga çdo prozë. Nisur nga këto venerime e arsytetime Valeri ngulmon që ka një mënyrë të ndryshme të krijimit të prozës dhe poezisë, për pasojën ka dhe një mënyrë të ndryshme të leximit dhe të interpretimit të tyre. Në këtë rrjedhë ai nënvizon dramën e krijuesit (poetit), të keqkuptuar si frymëzim të vetvetishëm e të mjaftueshëm, herë një labirint të disiplinuar, duke i bërë këto ballafaqime me ekstaza rastësore apo kryevepra të mundimit, për të prodhuar energji individuale superiore.

Pol Valerí, në fund të kësaj ligjërate, i ikën rigorozitetit të doktrinës së *frymëzimit të kulluar*, që do të paraqiste një *posedim djallëzor* (të ngjashëm me *daimonian* e Platonit), kur krizat e individit zhvillojnë e shpalojnë aftësi të papara dhe të pamatshme krijimi e komunikimi. Mirëpo, mjaftohet duke pohuar: “Një emocion i karakterizuar nga fuqia shprehëse e vetvetishme, është thelbi i poezisë”. Për të shtuar pastaj se *frymëzimi* i përket lexuesit, ashtu si krijuesit, që vepra e këtij e përkryer është e njeriut, jo e hyjit. Edhe pse kumton gjendje ideale, kur njeriu prodhon një shprehje të mrekullueshme të natyrës së tij dhe të fateve të njerëzve.

Pol Valerí këtu zbret nga roli i poetit në rolin e lexuesit. Këtë komunikim me letërsinë (me këtë status) e bën praktikë duke lexuar klasikën moderne frënge, duke nisur nga Bodëleri dhe sidomos Malarmé.

Tomas S. Eliot, amerikani që u bë anglez (europian), u kurorëzua poet i përbotshëm me veprat poetike *Toka e shkretë* (1922) dhe *Katër kuartetet* (1943), i vlerësuar me çmimin Nobel për letërsi. Famën e mori edhe si kritik letrar me esetë “Tradita dhe talenti individual”, “Ç’është klasiku” dhe “Kritika letrare”. Për një kohë është mbas Valerisë, por edhe i lidhur me të, jo vetëm për shtegtimin kulturor e poetik në Francë, por edhe me leximin kritik të poezisë së Valerisë, madje në një nivel të sistematizimit në studimin “Prej Posë deri te Valerí”. Te eseja “tradita dhe talenti individual” problematizon traditën letrare (poetike), që ka burimsinë europiane, që është diskursi për kultura të zhvilluara, madje këtë fenomen e sheh qoftë ndërmjetshëm të mbështetur në përvojën personale (individuale) në poezi, më fort të lidhur me poetët metafizikë anglezë të shekullit shtatëmbëdhjetë – pararomantikë. Kjo trashëgimi poetike (individuale) është çmuar më lartë në poezinë angleze veçanërisht poema *Toka e shkretë*, kurse poema tjetër *Katër kuartetet*, ka marrë famë më tepër te egzegetët europianë të poezisë së tij.

Te eseja “kritika letrare”, përsëri zhvillimet e kritikës në botën angleze dhe komunikimin e saj me poezinë i sheh në kontekst të kulturës anglofone, porse të lidhur edhe me kulturën këndeje Atlantikut. Porse tash, duke i parë kritikët-autorë, sidomos në leximin e poezisë, në kuadrin e komunikimeve të reja, individualitetin e tyre e sheh të shtresuar në nivelin e komunikimit social, sigurisht si shembuj ekselentë të mendimit, në vështrim të intelektualitetit. Klasifikimi i kritikëve bëhet duke pasur parasysh funksionin e kritikës, interpretues e komunikues; si kritikë universitare dhe kritikë publicistike. Ka, thotë Elioti, *kritikë* arsimtarë dhe *arsimtarë* kritikë; po ashtu, ka *kritikë* publicistë dhe *publicistë* kritikë. Kjo lidhet me metodën dhe morfologjinë e kritikës, e cila

prapë është produksion i kushtëzuar nga raporti me interpretimin e poezisë, në rend të parë.

Për rrjedhje, vetë kritika e tij autoriale e poezisë, ngritet mbi interpretimet e poetëve të tij të zgjedhur, për të cilët shkruan më shpesh e më thellë, duke propozuar një hierarki të vlerës letrare. Në këtë vështrim ai vetëdijshëm apo ndërrijshëm bëhet autoreferencial, kur shkruan për poezinë angleze dhe për poezinë europiane. Në këtë pikë Tomas S. Elioti, për një moshë më i ri, por poetikisht bashkëkohor, hyn vullnetshëm në vallen e poetëve modernë të kontinentit të vjetër, më së pari me Pol Valerinë dhe *Varietetet* (I-V) të tij.

Simbas kësaj logjike letrare të trashëgimisë dhe bashkëkohësisë, Elioti në Europë do të rinjihte Rajner Maria Rilken me *Sonetet e Orfeut* dhe *Elegjitë duinase* dhe “Sonetet” e Stefan Georges. Në fund të fundit, edhe “Vallen e Përjetësisë” të Lasgush Poradecit, ashtu siç pati parishkuar Eqrem Çabej në Grac më 1929.

### III. Ali Aliu: Një lexim i mundshëm i poezisë

Ali Aliu është kritik letrar, por nuk është poet. Nga viti 1971 deri më tash, për 50 vjet, ka botuar mbi 20 vepra kritike. Në titujt e këtyre veprave gjejmë segmente përcaktuese: krijime, kërkime, shqyrtime, rrjedhave, kritika, artikuj, ese, reflekse, magji, kronika, që më tepër se të mundohet për përkufizime të sistematizimit, dëfton qasjet personale ndaj letërsisë, pa u lodhur po ashtu të përkufizojë metodën. Përmbledhjet e shkrimeve kritike merren me poezinë, prozën, më pak me dramën e kritikën shqipe dhe në përjasje më një rrjedhë kohore të paratijes mund të quhen *kronika*, si formulim i fundit.

Këto kritika nisin si kritika publicistike, për të arritur kah fundi në kritika akademike. Kjo zakonisht iu ngjet lexuesve frymëgjatë të letërsisë nacionale. Mirëpo, duke qenë lexime të ditës për veprat e ditës, në rrjedhë gjysmëshekullore, ato vetvetiu krijojnë një histori të mbrendshme. Ali Aliu është i ndërgjegjshëm për këtë histori, prandaj në librat më të vonshëm provon rivizitim subjektiv në literaturë. Duke parë dominancën e kritikës për poezinë librat e tij përfaqësues janë *Antologjia e poezisë shqipe* (me tri variante), *Libri i jetës*, sprovë e leximit monografik, dhe më i fundit *Një lexim i mundshëm i poezisë*. Jo rasti kureshtar, por më thellë përkushtimi për njohje, na e shfaqë Aliun më të vetëvetishëm në këtë formulim, jo vetëm për ndërgjegjen për relativizim, por më tepër zbulim të natyrës së tij kritike që synon *autorësinë*

së pari e mëpastaj dhe aventurën që nuk ka mbaruar, pikërisht duke ringjallur habinë e fillimit, që nuk është më përsëritje por nënvizim i esenciales së tij. Interpretimi elementar tashmë shoqërohet me tekstin poetik të interpretuar pranë.

Tashmë hapet dritarja e magjisë së leximit të parë, e zbulimit të parë që nuk ka histori, por ka një të tashme të përhershme që sublimon *impresionin* duke kaluar në *ekspresion* për të mbaruar në *impresium*. Kjo procedurë përdoret për autorët që i zbulon për herë të parë; për poezitë që i lexon në nivele të ndryshme në kohë; për zgjedhjen formale të teksteve poetike antologjike të autorëve të preferuar.

Dhe çfarë ngjet? Përkundrajt varianteve të interpretimeve, është *zbulimi* i leximit të parë që bëhet kriter i vlerësimit të akëcilës poezi apo të akëcilit autor, natyrisht e shqiptuar përherë nëpër *shkallët e përshtypjes* për të arritur në shkallën e njohjes të *intuicionit*. Kjo mbetet kështu për Ali Aliun kritik, qoftë edhe kur e provokon vetveten duke çrëndomtësuar urti poetike të Ali Podrimjes apo kryengritje poetike të Azem Shkrelit.

Duke pasur parasysh titullin më ekspresiv të letrave kritike të Ali Aliut *Don Kishoti te shqiptarët* (1996), marrim guximin ta cilësojmë Ali Aliun kritik: *Don Kishoti në letërsinë shqipe*. Për ta paraqitur këtë aventurë letrare që nuk mbaron kurrë, duke lënë manash shqiptimin e cikleve poetike të Shkrelit, Kadaresë, Hamitit e Bejkos, si lakmi për sistematizim, do të zgjedhim të paraqesim 12 autorë me poezi nga libri *Një lexim i mundshëm i poezisë*<sup>5</sup>. Kjo për të provuar *leximin* si zgjedhje dhe si zgjidhje.

## ALI PODRIMJA

### SHQIPËRITË

(Dr. Pandeli Çinës)

*Na tmerruan shqipëritë  
Edhe tej e tej e tej  
Varre e nishana pikëllues*

*Në ëndrra pikëlojnë sy  
një asnjëherë o perëndi  
Të ketë 'i kërthizë guri*

<sup>5</sup> Ali Aliu, *Një lexim i mundshëm i poezisë*, SHB Ymeraj, Fier, 2016.

*Të dridhen tokeqiell  
Kur të dëgjohet në log  
At e bir e shenjtë të betohen  
Nadjembrëmje*

*Na bënë pikepesë shqipëritë  
Nuk dimë ku e bëjmë vdekjen  
Vaji na është këngë  
Frymë bëhemi e nga 'i grusht dhe  
Duke i kërkuar të uruarat  
Nëpër harta tragjike*

*(Tiranë, nëntor 2001)*

Pse e tmerrojnë poetin shqipëritë? Një (shqipëri), po edhe një, edhe një - shumëshqipëritë! E ëndërruara ndër shekuj: Një, s'u bë që s'u bë! Secili (bajraktar) do nga një shqipëri për vete... E ajo assesi të ketë një të vetmen kërthizë - një pikëmbështetje edhe guri arbëror...

Kështu këlthet e përgjërohet që dikur të rrëshqasë përhumbshëm në krahët e ëndërrimit poeti: do të dridhej tokeqiell - bashkë Arbëria - kur të jehonte mrekullia në hapësirë - ati e biri e shenjtë bashkë nadjembrëmje...

Vegimi ëndërror zgjohet vrikthi dhe poeti përplasat pas realitetit: na përçanë, na bënë pikepesë shumëshqipëritë, secila kokë më vete... Mallkimfat? Si bajraktarë të fantakosur me nga një copë shqipëri nën sqetull. Arbëri, si somnambul, s'di as ku i ka varret, s'di ta dallojë këngën nga vaji dhe të dytën nga e para në shumëshqipëritë... Nga sytë këmbët, me një grusht dhë të zhuritur, në kërkim të hartave tragjike të shumëshqipërive.

**AZEM SHKRELI**

**RUGOVA**

*Po kthehem  
E rrepta e mira  
Po kthehem*

*Po kthehem  
E egra e bukura  
Po kthehem*

*Përsëri  
Po takohem me ty  
Si me nënën*

Edhe një kthim i radhës, nga shumë kthime - takime të poetit me truallin e lindjes. Është kthim te rrënjët, te burimi nga i cili ka thithur dhe me të cilin është gatuar... Dhe, sa herë e kishte të rëndë jetën, sa herë përballë me sfidat e egra, të përditshme, ai i kthehej burimit, përtërinte, gjallëronte mbështetjen urtake, anteike të Rugovës - për të qëndruar, për ta mbajtur drejt boshtin kurrizor... Sidomos, për ta qortuar ndonjë hezitim të brendshëm joshës, për akomodim, për harresë e tjetërsim nga burimi...

Kthehej te burimi poeti sa herë e kishte vështirë, për të provuar rishtazi qëndresën, për t'u siguruar në drejtpeshimin mes: shpirtit dhe mendjes, sa herë rëndohej mbi të egërsia goditëse, agresive e ditës... Dhe, si pakkush ne poezinë tonë më të re, Azem Shkreli ndihej i veti tërësisht, i pastruar, urtësisht sipëror ne gjirin Rugovë.

Vetëm brenda tri tercetave, shpaloset i skalitur shpirti dhe urtia e Rugovës: "*i rrepti dhe i miri*" – një rreptësi perëndie që të bën mirë, që s'të lë të thyesh përballë sfidave... Dhe i egër në rreptësi mirësie, dhe me rrezatim shpirti të bukur, të virgjër, ashtu si natyra rugovase... Me këtë harmoni bote të brendshme dhe të jashtme me vete - vetëm kështu mund të jesh i denjë, i barabartë me zërin e truallit të lindjes - dhe në harmoni të plotë me të... Vetëm kjo përsosmëri është baras me atë të nënës dhe majat e bjeshkëve të Rugovës.

## DRITËRO AGOLLI

### *JUDA E KRISHTI*

*Ma do qejfi shkoj drejt dhimbjes  
dhe prej dhimbjes ik sërish,  
nisem plot inat mes grindjesh,  
kthehem i zbutur si dervish.*

*I kanosem ashpër fisit  
dhe përлотur. fisin falë,  
i penduar shkoj drejt Krishtit,  
ik nga Krishti, bëhem djall.*

*Hesht në prehje, rend në lodhje,  
njërën ndreq e tjetrën prish,  
kur mbledh lule, dua rrodhe,  
guvë e jetës - Judë e Krisht.*

Nga tërësia e veprës letrare të Dritëro Agollit, është e pranishme fryma, prirja që, në instancën e fundit, i thur ode universit njerëzor, vjen zë miqësor me gjithësinë që e rrethon përditë njeriun, zë miqësor me të gjithë të ngjashmit dhe të ndryshmit, i përafërt me vizionin e Uitmanit, ku të gjithë e çdo gjë shkrihet dhe bëhet një edhe me zërin lirik të universalizuar. Në këtë frymë filozofike dhe etike, poeti ia lë të hapur qe derën e vet Krishtit, edhe Judës, që, si prirje dhe mundësi, janë të pranishme kudo e kurdoherë...

EQREM BASHA

*SHTËPIA E VJETËR*

*ka rënë gjethi i ftoit*

*dërrasa të kalbura  
që do të digjen për dimër  
përhapin erë myku  
nuk hapen e mbyllen dritaret  
vetëm gjethi i ftoit  
plaket e zverdhet*

..Një mall i brendshëm për ditët, vitet e kaluara në pakthim. Ja çfarë ka mbetur nga tërë ajo botë e fëmijërisë: shtëpia që rrënohet, që kalbet në harresë... “*Vetëm gjethi i ftoit*” - vetëm ftoi dëshmitar që plaket, që hyn ngadalë, pakthyeshem në moshën vjeshtore...

## FATOS ARAPI

*PENELOPËS*

*Nuk ka mbaruar endja e pëlhurës, Penelopë  
 Ende nuk është kthyer nga Troja Odiseu  
 Ishujve të kohës endet...  
 Po vuri këmbën mbi bregun e thatë,  
 me vdekje dhëndurësh do ta mbjellë Itakën  
 Vazhdo të endësh, Penelopë.  
 Rrahja e avlëmendit tënd  
 është krismë e përjetshme e valëve të Jonit  
 Ti mos u mërzit, mos u lodh duke pritur, o grua  
 Kemi nevojë për një ëndërr malli në sy,  
 dhe vetë ajo, dashuria, ka nevojë për pafajësinë tonë  
 Mos më moho, Penelopë*

Endja e pëlhurës në avlëmendin e Penelopës – e përjetshme. E përjetshme le të jetë edhe pritja e saj, e Penelopës, e përjetshme dhe bredhja e Odiseut nëpër ishujt e kohës... Le të jenë cak-cak i papërfunduar, pritje e papërfunduar edhe nëpër shekujt që do të rrjedhin: po shkeli këmbë e tij, e Odiseut në Itakë, vdekje dhëndurësh do të mbjellë... Po përfundoi së enduri pëlhura, vjen edhe fundi i dashurisë! Dhe, ç' do të ishte njeriu në këtë botë (pa pritje), pa shpresën se ajo, dashuria, një ditë do të vijë?... Ajo ka nevojë për pafajësinë e poetit, për pafajësinë tonë – të tillë jemi vetëm në pritje të dashurisë...

Prapë një kënd dhe një ndjeshmëri tjetërfare e poetit ndaj mitit Penelopë, Itakë...

## ISMAIL KADARE

*MONOLOGU I TË VETMUARIT*

*Tani unë ngjitem lart dhe s'kam asnjë gëzim.  
 Këtu ku kam arritur më ftohtë është, më vetmi.  
 E dija këtë gjë, por padurimi i vdekur  
 Më shtynte te ky cak të mbërrij, te kjo kotni.*

*Krahë grash të thyera mbi supe, si të prera nga një  
morg,  
Më japin një gëzim po aq të vdekur.  
Më duket ende dimër, ndonëse është prill.  
Kam ftohtë. -  
Kam ftohtë.*

*(Prill 1989)*

Për shijen e zgjedhësit, është njëra nga poezitë më të bukura të Ismail Kadaresë dhe të poezisë shqipe. E shkruar në pranverën e vitit 1989, pra, para ikjes së poetit nga Shqipëria... Cili është burimi i kësaj vetmie të madhe? Shkalla më e lartë e arritjes, e famës - cak i ëndërruar dhe i pushtuar, që, nga ajo majë, megjithatë, ndien një bosh, një përtej që s'i afroresh dot, që s'e prek e s'e kupton dot...Të jetë atmosfera tiranase e atyre ditëve, çasteve kur poeti gjendej para vendimeve dramatike? Të. jetë koha e kaluar dhe ngjitja viteve? Mbase të gjitha e vatra të tjera të cilat i sugjeron për shpalim poezia e Ismail Kadaresë, si çdo poezi e madhe...

LINDITA AHMETI

*SYTË TU*

*sytë tu të mrekullueshëm  
të vizatuar në letër  
para meje qëndrojnë*

*o zot sa të bukur janë  
si lule të kaltëra mali  
që kanë fuqi magjepsëse  
sytë tu  
lule të kaltra  
të lëna këtu nga fryma e shenjtë  
në letër*

*në letër  
vetëm në letër*

Është përmasash totale dhembja e shpaluar në këtë poezi të Lindita Ahmetit: të mos mund t'u gëzohesh syve të gjallë, syve që të dehin, që të magjepsin, syve që i adhuron dhe të adhurojnë... Meqë është përcaktim i të plotfuqishmit, është prerje qiellore: vetëm syve në letër, atyre të krijuara nga fryma dhe dora e njeriut, mund t'u gëzohesh...

MARTIN CAMAJ

*FILL I GJETUN*

*Natën që shkoi u fikën dritat dhe mbeti  
qyteti në terr deri n'agim  
Amviset kërkun llampa vojquri  
e s'i gjetën në terr*

*Në nadjë ra dielli e zbeu  
faqet e rrokaqiellëve*

*Në nadjë vrejta rrethin e andrrave  
në truell  
e gjeta fillin e tretun  
në pikën e ndaljes së dritës,*

E qartë dhe e paqartë njëherësh kjo poezi dhjetëvargëshe... Në pikën e agimit, poeti sjell ndër mend: natën që shkoi qyteti mbeti në terr - u fikën dritat dhe rrëmujë e njohur: amvisat kërkojnë llampat e vajgurit që si gjejnë dot. Në mëngjes, ndërsa dielli shkëlqen mbi faqet e rrokaqiejve, shpalohe tëndrra e ngjizur natën e kaluar terr... Një natë e rëndomtë, mbase, do të thoshim pas leximit të parë, të shpejtë të poezisë...

Jo, nuk është as qytet i rëndomtë, as natë dhe terr i rëndomtë, as llampa vajguri të rëndomta, as agim, as ëndërr e rëndomtë: po të qe një natë-terr e rëndomtë, do të gjendeshin edhe llampat e rëndomta - nuk do të fshiheshin ato përfundimisht, pa nam e nishan... Shtimungu: nata që shtrihet terr mbi gjithësi, llampat e dikurshme, ato të fëmijërisë shkodrane mbase, e që tani s'janë asgjëkundi, përpos në kujtesën plot mall e dhembje, janë në funksion të ngjizjes, të ndjelljes së ëndrrës, kurse kjo e fundit, ëndrra në funksion të gjetjes së fillit, të rrënjëve, të truallit të lindjes...

Le të sjellim ndër mend jetën, fatin e poetit të madh Martin Camaj, të arratisur dhe të përbuzur, të harruar, në truall të huaj, ku kalon një natë të gjatë e cila e ndjell poetin të ëndërrojë, në krahët e së cilës do ta gjejë fillin e lëmshit të vet, fillimet e veta...

SABRI HAMITI

*HYRJE PËR LEXIM*

*Tash kur s'kam erë as ngjyrë as zë libri  
Mund të ec e të prek rrugët si i verbëri  
Mund ta lexoj veten më mirë rreth-veten  
T'ia lë kujtimet deri në mbarim  
Lëkura s'më le të dal prej shtëpisë  
Po i humbur i tëri në hapësi zbrazëti  
Nis lexoj malin drurin shiun  
Gjurmët e hershme gjurmët e vona  
Shkrimin që del i tmerrshëm i prishur  
Ti mik lexo me mua më lexo mua  
Lexo veten apo acarin malin barin  
Tash kur janë larg librat shënimet  
E kujtimet lexohen kafshohen  
Harrohen. Nga harrimi zbret thellë  
Në pavetëdiqe, në trup në shpellë,  
Ku luftojnë shpatat e dyshimeve,  
Kafshohet mënia me përgëzimet  
E s'mund të lindë zemrimi, mik!  
Lexomë po munde mua lexo veten  
Ashtu të shprishur të shkapërderdhur  
Të pashkruar kurrë nga librat  
Pa rendin e bukur të fjalëve të moçme*

(Kallnor 1977)

Në poezinë e parë, “Hyrje për lexim”, gjakohet e pamundshmja - uni i dikurshëm, uni i parafjalëve, uni i zhveshur nga fjalëlibratbota, uni i mishëruar me natyrën e paprekur, të virgjër - aty le ta kërkojë folësin lirik edhe lexuesi... Poeti, në kërkim të unit të vet të zhveshur nga mbështjellja, nga shtresimet e botëlibrit - përditshmëri reale që të tjetërson

pamëshirshëm, që të mposht, të bluan, të nënshtron të shkapërderdhur, të bën të pandijshëm ndaj prapësisë, të paaftë për zemërim...

VISAR ZHITI

*GJITHMONË JAM ME TË MUNDURIT*

*Gjithmonë jam me të mundurit,  
me përpjekjet e tyre  
(që afrojnë dritë)  
Deri në fitore,  
pastaj iki, i braktis  
dhe bashkohem me të mundur të tjerë.*

*...dhe kur arrij ndonjë fitore  
ndahem dhe me veten  
për të nisur beteja të reja...*

*Vetëm fitoret  
pa të mundur  
dua!*

Poeti bashkohet gjithnjë me të mundurit por jo me çfarëdo të mundurish. Siç dihet, shpesh mundet e keqja. Poeti është gjithnjë me ata të mundur që luftojnë për të sjellë dritë... Por, edhe kur qëllon që të fitojë pala e tij, ai ndahet edhe nga fitorja e vet dhe vazhdon rrugën drejt të mundurish të tjerë... Kështu detyrohet - e ka përcaktim të brendshëm, edhe pse do të kishte ëndërruar që të mos kishte fitore me të mundur - fitoret të mos ishin fitore mbi të mundurit, por fitore e të gjithëve.

XHEVAHIR SPAHIU

*TOMORI*

*Mjegulla u var,  
Mali s'duket më.*

*Fusha ka mbetur pa Zot e pa Zë.*

Ja një kryepoezi e realizuar vetëm brenda tri vargjeve, qe lexohet duke të mbushur kënaqësi estetike: edhe si një poezi mirazh, pamje dhe natyrë e mrekullueshme - ditë e vrenjtur, e mbyllur, që i ka varur mjegullat majave të malit Tomor dhe tërë hapësira ka marrë pamje të zymtë, të mrrolur, si rrjedhim i shkëputjes së malit që deri atëherë vigjilonte mbi fushat, mbi tokën; mbi gjithësinë...

Pastaj mund të lexohet edhe si gjuhë lashtësish mitologjike: Tomori, mal i shenjtë, strehë e hyjnive ilire nëpër shekuj, i shpallur nga më të mëdhenjtë e Rilindjes Kombëtare si fron perëndish... Do të mjaftojë, po ashtu, për kënaqësi estetike dhe emocionale, duke ecur shtigjeve historike - iliroarbërore...

Poeti palos edhe më shtresime kuptimore, mbase edhe më të thella dhe më të rëndësishme. Mos vallë hapësira aktuale shqiptare ka mbetur pa Olimpën e vet, pa urtinë dhe pa praninë e hyut, që e mbron nga të ligat atë? Pse paskësh mbetur fusha, hapësira arbërore edhe pa zot edhe pa zë? I mungon, pra, zoti, i mungon zëri i Arbërisë së sotme?

Edhe më tej është i pranishëm shumë shtresimi që reflekton nevojën e lindur të njeriut për mbështetje... Qoftë në zot, qoftë në iluzion, qoftë në shpresë, qoftë në mashtrim-vetëmashtrim, pa të cilin nuk mundet ekzistenca, pa këtë mbështetje të malit sovran, të malit Tomor...

Të gjithë e kemi nga një të tillë.

ZEF ZORBA

GOZHDË

*Një gozhdë ngulur thik në mur, një gozhdë  
E ngulur thik në mur, një gozhdë e ngulur...*

*Një gozhdë e futur thellë në mur, një gozhdë  
E mbetur thatë në mur.*

*Një gozhdë e mbetur thatë në mur, një gozhdë  
E mbetur thatë në mur, një gozhdë e mbetur.*

*E ngulur thik...  
E futur thellë...  
E mbetur thatë...*

...Dhembje të madhe, të hidhur rrezatojnë nga brendia e unit poetik vargjet e kësaj poezie: si thikë-gozhdë e futur në trup, në mish. Është dhembja - gozhdë e poetit, që, përballë botës së pandishme, të egër, ndihet i humbur, i flakur brutalisht - është plagë e hapur, gozhdë në shpirt... Rrezaton shija e dhembjes së të zhgënjyerit përfundimisht, e të pashpresit... Dhembja, me këtë rast, është artikuluar si shkallëzim artistik brenda një harku kohor si një univers ekzistencial: e futur thikë në trup të njomë, të qenies që jeton, që e nis jetën hovshëm, e futur thellë që në krye të udhëtimit e që dikur arrin ta shterë njomësinë, lëngjet e jetës, të trupit dhe të frymës, arrin ta thajë atë...

Poezia “Gozhdë” nuk do të arrinte maja artistike, po të mos ishte e hapur, e pashtershme në komunikim me lexuesin: gozhdë në ndërgjegjen e folësit lirik, gozhdë në atë të folësit arbëror dhe njerëzor, gozhdë mbamendjeje dhe gozhdë harrese kolektive, gozhdë zgjim e gozhdë gjumë, fjalëgozhdë dhe gozhdë urrejtjeje...

Rrafshet e leximit në këtë poezi antologjike të poetit të talentuar shkodran (1923-1993), që gjatë diktaturës komuniste shkroi në heshtje, për vete, pa botuar gjë për së gjalli, janë porta të hapura në kohë dhe hapësirë: gozhdë dhembjeje personale, gozhdë kolektive arbërore, gozhdë universale...

#### IV. Ali Aliu bashkëkohës

Ali Aliu është bashkëkohësi ynë: gjithmonë *sot* e gjithmonë *këtu*, në vështrimin e një të tashmeje të përhershme; duke u mahitur me kohën si imagjinatë të njëtrajtshmërisë; duke lakuar hapësirën si qerthull të imagjinimit. Në këtë dramatikë të çrëndomtësimit ai është *dëshmitar* imagjinar dhe *pjesëmarrës* ëndërrimtar. I bartur në anijen me vela, lëvizjet e tij tallen me hapësirën e vizituar si rreth që ka një pikë tërheqëse të largimit dhe të përfrimit. Sepse jemi në sojin e shtegtimit nga trupi te shpirti. Nëse nuk është deklaruar vetë Poeta, ai i gjason Poetit, kërkon të njësohet me të nëpërmjet trajtës së bukurisë e të urtisë së poezisë.

Na e ka andja që ligjërimin kritik të Ali Aliut, në kuadër të Bioletrës së tij, ta shohim si shkrim të jetës dhe jetë të shkrimit. Prandaj na përshkon një fije lumturie e gjallërimi, po sot në akademinë tonë si klasë të dijes, për të tallur kufijtë e jetesës dhe të mbijetesës në aventurën e leximit të poezisë: nga impresioni nëpërmjet ekspresionit kah intuícioni.

Shaban Sinani

## PËRTEJ KUFIJVE TË NËNSISTEMEVE TË LETËRSISË SHQIPE

Konceptin e *nënsistemeve në letërsi* në këtë paraqitje e kuptojmë sipas Itamar Even-Zohar, stabilizuar në dy veprat e mirënjohura të tij *Polysistem theory* dhe *Polysistem studies*, botuar disa dekada më parë dhe të rivizituara prej tij gjegjësisht më 1997 dhe më 2005. Ky koncept, që fillimisht shërbeu për të krijuar një hierarki midis *letërsisë në gjuhë amtare* dhe *letërsisë së përkthyer*, më pas edhe midis *letërsive metropolitane* dhe *letërsive periferike*, së fundmi u përdor edhe *për letërsinë e së njëjtës gjuhë*, me histori kufijsh për shkak të faktorëve historikë, duke përfshirë letërsinë e vetë vendit të origjinës së autorit, me opozicionin e saj *yiddish literature - hebrew literature*.

Një fat të ngjashëm ka pasur edhe letërsia shqipe, e cila prej fillimeve deri në shekullin e romantizmit zhvillohet e ndarë në *qarqe / qerthuj*, për shkak të përkatësisë fetare të autorëve dhe të përdorur prej tyre (E. Çabej). Pas një periudhe jo dhe aq të gjatë të *homogjenizimit që solli romantizmi kombëtar*, ndarja në nënsisteme e letërsisë shqipe u rikthye në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar, për shkak të kufijve ndërshtetërorë që u rivendosën midis shqiptarëve në mbarim të luftës antifashiste pas vendimmarrjeve gjeopolitike dhe të dallimeve e pengesave ideologjike që vepruan.

Letërsia shqipe gjatë kësaj periudhe funksiononte së paku në katër nënsisteme: 1. Letërsia shqipe në Shqipëri, me sundimin sovran të realizmit socialist dhe probleme të tjera të kontrollit politik, ideologjik dhe fetar; 2. Letërsia shqipe në Kosovë dhe më gjerësisht ndër shqiptarët e ish-Jugosllavisë, me trysnitë e mëdha kufizuese në pikëpamje të raporteve me identitetin dhe etnicitetin; 3. Letërsia shqipe në diasporë, kryesisht e diasporës politike antikomuniste; 4. Letërsia shqipe tek arbëreshët në shekullin e 20-të, që ndoqi, edhe në këtë fazë, *dhimbjen e atdheut të munguar*. Krahas tyre, si në Shqipërinë shtetërore, ashtu dhe në Kosovë, jashtë sistemit ekzistonte *letërsia e ndaluar*, *letërsia e sirtarëve* (Primo Shllaku), *letërsia e burgjeve* (*burgologjia*, sipas Visar Zhitit e Bajram Kosumit).

Se sa *rreptësisht veprues* kanë qenë kufijtë që e ndanin letërsinë shqipe në parcela, teknikisht të quajtura *nënsisteme*, vlen të silltet në

kujtesë një rrethanë historike. Në shumë raste, deri në mesin e viteve 1970, *Rilindja* e Prishtinës ishte një mundësi e artë për të shpëtuar veprat e ndaluara në Tiranë. Prej saj patën një jetë të dytë vepra të hequra nga libraritë të Petro Markos, Fatos Arapit, Jakov Xoxës, madje edhe të Dritëro Agollit (*Njeriu i mirë*, titull alternativ për *Zhurmen e erërave të dikurshme*). Por, pas botimit në Prishtinë të dramës *Mosha e bardhë*, e cila në Tiranë sapo qe ndaluar, dy shtëpitë botuese kryeqytetase të letërsisë u urdhëruan që në asnjë rast të mos japin kopje të daktiloshkrimeve të veprave ende në proces për delegacionet vizitues nga Kosova.

Përballë kësaj pamjeje tej mase të copëtuar të letërsisë shqipe, e cila vazhdon t'i vuajë edhe sot dëmet e shkaktuara prej kufijve të gjithfarshëm (sidomos në studime), vepra shkencore e Ali Aliut, pa ndonjë kërkim të thelluar, thjesht në mënyrë empirike, nxitur prej leximeve të paqëllimta për ndonjë kumtim apo ngjarje publike, të vjen në mendje si manifestim i së kundërtës, si model pune kërkimore-realizuese e një dijetari që gjatë gjithë jetës së tij e ka vështuar letërsinë shqipe përtej kufijve ndarës, jashtë nënsistemeve, duke udhëtuar me një liri sfidante në gjithë hapësirën historike shqiptare, në gjithë hartën e pranisë së letërsisë shqipe si veprimtari krijuese. Si *thyes kufiri* ai dëshmohej përmes veprimtarisë shkencore qysh në fillimin e viteve 1970, atëherë kur kishte një përlligje objektive për t'u mbyllur brenda *ngastrës letrare*.

*I parrethueshëm* përmes përkufizimeve klasike më të njohura që përdoren në shkencën letrare, Ali Aliu është krijues i një lirie vetjake profesionale që shpërfill jo vetëm kufijtë e nënsistemeve, sepse në konceptin e tij ka vetëm një letërsi, pavarësisht dallimeve për shkak të faktorëve që ndikojnë prej së jashtmi, por edhe *kufijtë e zonave të interesit shkencor në pikëpamje të tipologjisë së llojeve dhe nënlojeve të studimeve letrare*, pavarësisht formatit, madhësisë, hierarkive dhe çfarëdo dallimi tjetër.

*Përshtypjet empirike*, të shprehura në idioma gjysmë-figurative, që përdoren shpesh për të cilësuar me fjalë të kursyera profilin shkencor të Ali Aliut, si: *shkencëtari që bashkoi tri kryeqytete të shqiptarëve, njeriu i trinisë së hapësirës historike kombëtare* etj.; përshtypje që jo rastësisht krijohen, bëhen menjëherë të vërtetueshme duke ua lënë vendin kërkimeve për një paraqitje të objektivizuar, përmes *të dhënave numerike*, para së gjithash përmes atyre të dhënave që rezultojnë duke ndjekur në mënyrë prapavajtëse udhën krijuese prej mbi 60 vjetësh të tij.

Në data jubilarë dhe në vlerësime të meritave jetësore gjuha e statistikës nuk është e huaj dhe e tepërt edhe për studimet letrare. Përmes *përkthimit* të arritjeve shkencore në shifra, është e mundshme të realizohet një *qasje panoptike* ndaj autorit dhe të shqiptohen përfundime të shkallës relative, që, vështruar paralel me vlerën e brendshme përmbajtësore të vetë veprës, verifikohen e ndihmojnë për kërkime të tjera.

Një mundësi për t'i kthyer mendimet në shifra ose për të statistikuar veprimtarinë shkencore të Ali Aliut në shërbim të një rinjohjeje retrospektive ishte shfrytëzimi i bazës së të dhënave të kujtesës elektronike të platformës së mirënjohur të katalogimit, bibliografive, kodifikimit dhe qarkullimit të informacionit shkencor *Cobiss*, njëherësh edhe program, sistem kërkimi dhe *thesaurus ballkanik* në këtë zonë veprimi. Gjatë kërkimit paraprak dhe më tej në përgatitjen e një bibliografie vetjake të botimeve të Ali Aliut, patëm ndihmën e punonjëseve të specializuara për bibliografitë në dy bibliotekat tona shkencore: Mirlona Buzo, Sabina Vaqari, Arta Kqiku dhe Irida Bineri, të cilat i meritojnë falënderimet.<sup>1</sup> Dy *motorët e kërkimit*, që përpunojnë dhe shërbejnë informacionin shkencor, *Cobiss.al* dhe *Cobib.al*, bujarisht ofruan të dhëna për të pasur një *identict* të numerizuar me besueshmëri për profesorin tonë Ali Aliu.

Rezultatet paraprake, të pafiltruara prej përkimeve rastësore (me emrin e autorit, me tituj të veprave dhe shkrimeve të tij), gjenden në *urën elektronike* të shenjuar këtu në vijim:

<https://bib.cobiss.net/biblioweb/direct/al/alb/cris/00815>

Në tërësi, duke përfshirë edhe dyfishimet (ribotime, rishtypje), numri i rekordeve që bashkohen në emrin e Ali Aliut, prej vitit më të hershëm (që edhe vetë *Cobiss.al* e shenjon me dy pikëpyetje: 19??), deri para dy vjetësh, rezulton jo pak por 1032 njësi bibliografike, në të cilat gjendet thuajse i gjithë udhëtimi shkencor i tij. Nuk është ndërhyrë për të qortuar tipologjinë, në ndonjë rast të rrallë që *Cobiss* ka gabuar (p. sh., *Don Kishoti shqiptar* është konsideruar *vepër letrare*).

<sup>1</sup> Për më tepër shih: *Bibliografi e veprimtarisë botuese të akad. Ali Aliu*, zgjedhur dhe rënditur nga bazat e të dhënave “*Cobiss.al*” dhe “*Cobib.al*”, sipas kriterit të tipologjisë. Punuan për mbledhjen dhe grupimin e lëndës: Mirlona Buzo, Sabina Vaqari, Arta Kqiku dhe Irida Bineri, nën kujdesin dhe drejtimin shkencor të studiuesit Shaban Sinani, Tiranë, mars 2004.

	A	B	C	D
1003	1002	2.048E+09	Hamiti, Sabri	Studime letrare / Sabri Hamiti ; recensues Ali Aliu, Enver Gjerqeku ; redakt
1004	1003	2.048E+09	Aliu, Ali	Magjia e fjalës / Ali Aliu ; [redaktor Eqrem Basha ... et al]
1005	1004	2.048E+09	Aliu, Ali	Don Kishoti shqiptar : një histori ndryshe e letërsisë shqipe / Ali Aliu
1006	1005	2.048E+09	Çela, Zija, 1946-	Pika drite në eklips : minus '90 : novela dhe tregime / Zija Çela ; parathënia
1007	1006	2.048E+09	Çela, Zija	Pika drite në eklips : minus '90 : novela dhe tregime / Zija Çela ; parathënia
1008	1007	2.048E+09	Çela, Zija, 1946-	Buza e kuqe dhe gjaku i errët : plus '90 : novela dhe tregime / Zija Çela ; [p
1009	1008	2.048E+09	Çela, Zija	Buza e kuqe dhe gjaku i errët : plus '90 : novela dhe tregime / Zija Çela ; [p
1010	1009	2.048E+09	Aliu, Ali	Atdhedashuria si metaforë fataliteti : romani i Mehmet Krajës "Hotel Arbë
1011	1010	2.048E+09	Aliu, Ali	Disa veçori krijuese të brezit më të ri letrar / Ali Aliu
1012	1011	2.048E+09	Aliu, Ali	Vizioni testamentar i Jeronim De Radës te Parime të estetikës / Ali Aliu
1013	1012	2.048E+09	Aliu, Ali	Vizion shumëstresor kominikimi / Ali Aliu
1014	1013	2.048E+09	Sinani, Shaban	Historia e letërsisë shqipe : çështje të hapura : kurs ligjëratah universitare
1015	1014	2.048E+09	Aliu, Ali	Poezi e mendimit dhe shqetësimit / Ali Aliu
1016	1015	2.048E+09	Aliu, Ali	Sërish mbi lirikat e Naim Frashërit / Ali Aliu
1017	1016	2.048E+09	Aliu, Ali	Azem Shkreli : lirika që la gjurmë të një epoke / Ali Aliu
1018	1017	2.048E+09	Aliu, Ali	Dritëro Agolli : poeti lirik dhe prozatori i sfidave / Ali Aliu
1019	1018	2.048E+09	Aliu, Ali	Fatos Arapi : poezia lirike që vendosi standarde / Ali Aliu
1020	1019	2.048E+09	Aliu, Ali	Ismail Kadare : mund titanët e letërsisë / Ali Aliu
1021	1020	2.048E+09	Aliu, Ali	Kim Mehmeti dhe imagjinata kreative / Ali Aliu
1022	1021	2.048E+09	Aliu, Ali	Majlinda Rama : dhe universaliteti krijues / Ali Aliu
1023	1022	2.048E+09	Aliu, Ali	Zija Çela dhe tërmetet narrative / Ali Aliu
1024	1023	2.048E+09	Aliu, Ali	Shkrimtar i majave letrare : mbi prozën e Zija Çelës / Ali Aliu
1025	1024	2.048E+09	Aliu, Ali	Zija Çela : shkrimtar i majave letrare : mbi prozën e Zija Çelës / Ali Aliu
1026	1025	2.048E+09	Rrahmani, Zejnullah	O njeri! : (tregime të zgjedhura) = Oh man! : (selected stories) / Zejnullah R
1027	1026	2.048E+09	Pashku, Anton	Aventurat e tezes : (tregime të zgjedhura) = Adventures of thesis : (selecte
1028	1027	2.048E+09	Kraja, Mehmet	Rrëfime nga fletoret e vjetra : (tregime të zgjedhura) = Narratives from old
1029	1028	2.048E+09	Basha, Eqrem	Rruga rreth si zero : (tregime të zgjedhura) = A round road like zero : (selec
1030	1029	2.048E+09		Poetët akademikë : antologji e poetëve anëtarë të Akademisë Maqedonase
1031	1030	2.048E+09	Aliu, Ali	Leximi dhe rileximi i Mjedës / Ali Aliu
1032	1031	2.048E+09	Aliu, Ali	Robert Elsie : prezantues i letërsisë në përmasa ndërkombëtare / Ali Aliu

Pamje e pjesshme e fletës së fundme të listimeve të *Cobiss.al* dhe *Cobib.al* për titujt/njësitë bibliografike të kërkuara

Nxjerrja, përzgjedhja, grupimi dhe statistikimi i rekordeve të veprimtarisë botuese të Ali Aliut u bë sipas standardit ndërkombëtar të njohur si ISO 690. Ky standard mundëson ardhjen në vëmendje të gjithçkaje që ka njohur shprehje publike gjatë jetës shkencore të autorit: prej monografive, përmbledhjeve me studime, artikujve shkencorë e njohës, shkrimeve në shtypin shkencor e letrar, recensioneve e recensimeve, parathëniet e pasthëniet, hyrjeve dhe shenjimeve autoriale në libra të të tjerëve, deri tek *autorësia e dytë* apo *e tretë* (redaktor, përkujdesës, përgatitës, ideues e realizues kolane/projekti), duke përfshirë edhe mentorimin në universitete. Pasi ky standard u zbatua me disiplinë shkencore, duke përjashtuar ko incidencat dhe përsëritjet, duke vërejtur mungesat e qarta për shkak të shkallës së pamjaftueshme të numerizimit të informacionit shkencor, duke verifikuar rastet e dyshimita dhe pasaktësitë teknike, në regjistrin e Ali Aliut rezultuan 518 rekorde/njësi, përshkrime bibliografike, të cilat më pas u renditën sipas kriterit të tipologjisë dhe të kronologjisë.

Mbi këtë bazë mund të përshkruhen me një shkallë të lartë saktësie itineraret e gjata në kohë dhe me shtrirje ndërshqiptare të studiuesit Ali Aliu jo vetëm *përtej kufijve të nënsistemeve*, por edhe *përtej kano-neve të llojeve e nënlojeve*, siç do të shihet në vijim përmes larmisë së tyre, si formë e refuzimit të hierarkisë zhanrore.

Përshkrimet bibliografike, edhe pas përpunimit sipas standardit ISO 690, duhet të konsiderohen jopërfundimtare, jo vetëm sepse në *Cobiss.al* nuk janë depozituar ende të dhënat e dy viteve të fundme - dhe fatmirësisht jubilari ynë vazhdon të jetë pjesëmarrës i shenjuar në zhvillimin e mendimit shkencor për letërsinë, madje duke e ndjekur procesin e saj paralelisht - por edhe për disa arsye që *dekonspirojnë* paplotni edhe nga vetë sistemi, i cili hera-herës ngjan se *e kobit* shfrytëzuesin:

1. Mungojnë thuajse në tërësi shkrimet e autorit në *Flakën e vëllazërimit* të Shkupit, ku ai kaloi disa vite të veprimtarisë së tij. Me sa duket, ende nuk ekziston një bibliografi e numerizuar e kësaj gazete;


2. Askush nuk do ta besonte, për shembull, që studiuesi Ali Aliu ka gjithsej vetëm 4 pjesëmarrje në konferenca shkencore, siç raporton baza e të dhënave e *Cobiss.al*. Me shumë gjasë, programet e veprimtarive tona shkencore nuk evidencohen, humbasin rrugës me mbarimin e aktivitetit, nuk lënë gjurmë në bazat e të dhënave;

3. Ali Aliu është ligjërues lëndësh themelore në universitete, duke përfshirë faktin që për dekada me radhë ka qenë titullar lënde për teorinë e letërsisë, por të dhënat e veprimtarisë universitare ose janë rastësore, ose mungojnë fare.

Parë në tërësinë e tyre, duke i hartëzuar kërkimet e Ali Aliut në gjithë hapësirën shqiptare, përkundër copëtimit historik të letërsisë shqipe si e tillë, studimet e Ali Aliut *përbëjnë sistem*. Nuk ka hapësira të lëna mënjanë a të dytësuar, nuk ka asgjë rastësore apo kalimtare në zgjedhjet e tij. Thjesht për lehtësi metodologjike, në vijim hartëzimi i kërkimeve të tij bëhet sipas kufijve të nënsistemeve të dikurshëm, jo krejt të kapërcyer qoftë konceptualisht, qoftë në përvojën e kërkimeve.

Në letërsinë shqipe të *shtetit të vjetër*, Ali Aliu përgjithësisht zgjedh *autorin që bart një dukuri letrare*, që mund të jetë raporti me pushtetet (Petro Marko, Fatos Arapi, Xhevahir Spahiu); përfaqësimi i një rrjedhe letrare apo i një breznie (Naimi, De Rada, Lasgush Poradeci, Migjeni); atipizmi në raport me zhvillimet e kohës në letërsi (Zija Çela, Koço Kosta); njohja ndërkombëtare (Ismail Kadare, Fatos Kongoli); nevoja për ndërmjetësim me lexuesin e një kohe tjetër (Jakov Xoxa). Në këtë hartë të interesave parësorë të Ali Aliut për autorë nga Shqipëria


ka edhe dhjetëra të tjerë, veprës së të cilëve u është rikthyer vetëm kur ka ardhur bashkë me një dukuri, me një zhvillim (Agim Spahiu, Fatos Lubonja, Frederik Reshpja, Piro Misha, Majlinda Rama, Mira Meksi, Irhan Jubica, Mimoza Ahmeti, Skënder Buçpapa).



#### Letërsia në Shqipëri në studimet e Ali Aliut

Sa i takon letërsisë së Kosovës, pritës i vëmendjes përparësore të studiuesit është grupimi që njihet gjerësisht si *breznia e modernitetit*, shfaqur në vitet 1970 (me Azem Shkrelin, Ali Podrimjen, Sabri Hamitin) dhe me të afërtit e mëvonshëm të tyre (Basri Çapriqi, Beqir Musliu, Kujtim Shala, Shaip Beqiri). Zgjedhjet e tij në plejadat e letërsisë së re të Kosovës janë me të njëjtat kërkesa dhe shije si dhe në Shqipëri e në Maqedoninë e Veriut. E përherëshme është kërkesa për *shkallë të lartë*

*përfaqësimi*. Është e kuptueshme që brenda *kriterit referencial* të shfaqet dhe *ndjesia preferenciale*. Nuk është për t'u habitur që *Breznia 1970* e letërsisë shqipe në Kosovë, grupim që zakonisht lidhet me thirrjen *Vox clamantis in deserto*, përbën për studiuesin një yllësi që mbetet gjithnjë përparësore, ndërkohë që Anton Pashku, me emrin e të cilit lidhet zakonisht ky dokument, shfaqet vetëm kalimthi. Për arsye historike, por me sa duket edhe në respekt të parimit të senioritetit, kanë vend të qëndrueshëm në studimet e Ali Aliut poetët dhe prozatorët e *Brezit të parë*: Esad Mekuli, Enver Gjerqeku, Besim Bokshi, Fahredin Gunga. Sidoqoftë, *kriteri i paanshmërisë*, sa i takon vendit në trashëgimin letrar shqiptar (në rastin e antologjive të hartuara prej tij), sundon mbi parapëlqimet dhe kjo shpjegon, për shembull, pse nuk mungojnë në to Din Mehmeti apo Martin Camaj, për të përmendur vetëm dy prej rasteve.



Vërtetohen të njëjtat nivele përzgjedhjeje të autorëve dhe veprave si në Shqipëri, ashtu dhe në Kosovë, që në thelb e përbën *autori-dukuri*

apo *vepra-dukuri*. Me këtë mund të shpjegohet pse Ali Aliu, edhe në kohën kur kritika letrare po degradon me shpejtësi drejt shuarjes si nëndisiplinë shkencore, vazhdon ta ndjekë thujtë *i vetëm* me durim dhe ngulmim procesin letrar në zhvillimin e vet bashkëkohor, duke rezultuar mes ndërmjetësve të fundmë të letërsisë me lexuesin. Më me fat kanë qenë përfaqësuesit e brezave të rinj e të mesëm të letërsisë në Shqipëri, të cilët kanë fituar prestigj publik të merituar edhe për shkak të përrurimit prej tij (Arian Leka, Ilirjan Zhupa, Luljeta Lleshanaku, Ben Blushi, Preç Zogaj, Mimoza Ahmeti, Majlinda Rama). Nuk mund të thuhet e njëjta gjë për poetët e shkrimtarët e së njëjtës kohë në Kosovë, si Ag Apolloni, Adil Olluri apo Gëzim Aliu, për të cilët *dr. Cobiss*, por dhe kërkimet në forma tradicionale, nuk ofrojnë diçka për t'u shenjuar.



*Hartëzimi* i kontributeve të Ali Aliut për letërsinë shqipe në Maqedoninë e Veriut është, si dhe ai i Shqipërisë apo i Kosovës, i lexuar nga majat, duke pasur si synim kryesisht vërtetimin e *kriterit të tërësisë* si kusht për të mos gabuar në *leximin e letërsisë shqipe përmbi dallimet e shkaktuara prej ekzistencës së nënsistemeve*, si letërsi kombëtare. Kë-

tu janë zgjedhur kryesisht autorët me të cilët jubilarit ynë ka një marrëdhënie konstante afatgjatë. Paraqitja grafike, edhe në këtë rast, ka thjesht qëllim pragmatik: lehtësimin e punës për të provuar se nuk ka disa shkallë interesimi a vëmendjeje nga autori të ndërvarur nga rajonalizimi gjeopolitik, por *vetëm prag pranimi* të njëjtë për të gjithë. Duke i krahasuar autorët dhe veprat që janë studiuar nga Ali Aliu jashtë ndonjë discipline institucionale në Maqedoninë e Veriut, fillimisht mes tyre dhe pastaj edhe me *letërsitë e tjera shqiptare*, rezulton se në krye të herës ai i përgjigjet vetëmëvete pyetjes se sa të nevojshme janë ato për një histori letërsie kombëtare dhe pastaj merr vendimin për t'u thelluar në studim. Me gjithë përpjekjet për të gjetur ndonjë gjurmë privilegjimi për shkak se letërsia shqipe mund të shihet si *letërsi pakice*, kjo nuk u dëshmuar në asnjë prej rasteve. E njëjta sjellje vërtetohet edhe në menyrën si zgjedh e ndalet në autorë e vepra të letërsisë shqipe tek arbëreshët, qoftë për të vjetrën, qoftë për atë që zhvillohet sot.

Ky *hartëzim i pjesshëm* i përfaqësimin të interesave të Ali Aliut për letërsinë shqipe në Maqedoninë e Veriut (ku do të kishte vend edhe për të tjerë, si Shkëlzen Halimi, Halil Zendeli, Teki Dërvishi, Ahmet Selmani, Luljeta Isaku, Lulëzim Haziri, Kalosh Çeliku, që janë pjesë e tyre), do të kuptohej më mirë e më plotë me një ndalesë në punën e tij si përkthyes: janë jo pak por *12 rekorde vetëm për përkthimet nga shqipja në maqedonisht*. Përkthimet e Ali Aliut, të realizuara prej atij vetë ose të mbështetura në procesin e botimit, përbëjnë një bibliotekë specifike, që u ka paraprirë nismave të sotme europiane që nxisin dialogun midis letërsive të popujve të rajonit mes tyre; tejkalimin e kompleksit të refuzimit gjuhësor, respektit për *gjuhën e tjetrit*. Fatos Arapi, Ismail Kadare, Dritëro Agolli, Xhevahir Spahiu, Visar Zhiti, janë disa prej autorëve që Ali Aliu ua propozon lexuesve maqedonas në gjuhën e tyre. Ndërkohë vijnë në shqip jo për rastësi Matvej Matevski, Ante Popovski, Gane Todorovski, pa përmendur mbështetjen e letërsisë dygjuhëshe të Luan Starovës.

Sa i takon *shkeljes së kufirit tjetër*, atij të kanonit ndarës të llojeve dhe nënlojeve të studimeve letrare, këtë e provon lehtësisht pema hierarkike e ndërtuar prej *Cobiss.al*, që dëshmon se për Ali Aliun nuk ka vetëm *lloje prioritare* (monografi, artikull shkencor), *enkas për të mëdhenjtë*, por, të gjitha format e të shprehurit të mendimit shkencor-letrar janë instrumente të dobishme, që i ofrohen studiuesit për të realizuar misionin e tij në marrëdhënien trekëndore autor - vepër - lexues. Struktura e llojeve dhe nënlojeve të zhvilluara prej tij shpreh shpërfillje ndaj kanonit të ndarjes së tyre. Prej disa dekadash është mbajtësi gjallë i nëndisiplinës së kritikës letrare. Ashtu si tejkalimi i kufirit të nënsistemeve

i ka dhënë mundësi studiuesit tonë të navigojë në të gjitha hapësirat ku krijohet letërsi shqipe, ashtu tejkalimi i kufijve të llojeve e nënlojeve i ka dhënë mundësi të demokratizojë marrëdhëniet me të gjitha breznitë, prej atyre tradicionale deri te më të rejat.

**347.** ARAPI, Fatos. *Odbrani pesni: poetski izbor na avtorot = Poezi të zgjedhura = Selected poems: poems selected by the author.* [Struga]: Struški večeri na poezijata: = Struga poetry evenings, 2008. 286 str., slika na avtorot. ISBN 978-9989-193-10-1. [COBISS.AL-ID 73419530]

**348.** ARAPI, Fatos. Zošto se sakavme dvajcata; Dva po polnok; Tagata me napušti posledna; Ne mi doağaj nasone; Polovina son vo oko; Sudbina; Po pat vrví eden kiparis; A poezijata; Albancite; Ne sakam da staneš spomen; Snegot vo Tirana; Jas ne go sakam Ahil; Spaluvanjeta na Aleksandriskata biblioteka; Aheron si teče no Haron go nema; Kade e Kain?; Nastan; Jas i mojata smrt; Večerva; In - tenebris; Raka za raka so tragedijata...; Bogot na Albancite. *Kniževno žitie: [spisanie za kniževnost, umetnost i kultura]*. Maked. izd. mart/april 2008, br. 6/7, str. 140-153. ISSN 1857-5730. [COBISS.AL-ID 83479818]

**349.** ARAPI, Fatos. Vo tolku malku Tirana; Prošetka bez sebesi; Na poetite na zemjava moja; Što da i kažam na dušava Avel. *Kulturen život: spisanie za kultura, umetnost, opštestveni prašanja.* juni/septemvri 2008, god. 53, br. 3/4, str. 26-27. ISSN 0047-3731. [COBISS.AL-ID 85333002]

**350.** *Magjia e irtisë islame: antologji tregimesh.* Gostivar: Aliu A.F., 2006. 2 sv.(350; 350 str.). ISBN 9989-2530-0-5, ISBN 9989-2530-1-3, ISBN 9989-2530-2-1. [COBISS.AL-ID 64250378]

**351.** KADARE, Ismail. Portret na Skenderbeg. *Akt: spisanie za kniževnost i kultura.* Maked. izd. 2006, god. 3, br. 19, f. 46. ISSN 1857-6184. [COBISS.AL-ID 74656522]

**352.** ZHITI, Visar. *Bos i lud.* Skopje: Štrk, 2001. 80 str. Biblioteka Kopneži. ISBN 9989-662-55-X. [COBISS.AL-ID 44641546]

**353.** POPOVSKI, Ante. *Fluturimi i shpendit të kuq: poezi.* Tiranë: Mësonjëtorja e parë, 2000. 106 f. ISBN 978-99927-46-15-8. [COBISS.AL-ID 389263367]

**354.** POPOVSKI, Ante. *Providenca.* Tiranë: Mësonjëtorja e parë, 2000. 152 f. ISBN 978-99927-46-14-1. [COBISS.AL-ID 389262855]

**355.** ARAPI, Fatos. *Den so taga.* Struga: Struški večeri na poezijata, 1999. 109 str. Biblioteka Plejadi. ISBN 9989-9503-4-2. [COBISS.AL-ID 33259530]

**356.** SPAHIU, Xhevahir. *Koski i maslini.* Skopje: Detska radost, 1998. 133 str., ilustr. Sovremena balkanska poezija, Kolo 2, Albanija. ISBN 9989-30-403-3. [COBISS.AL-ID 31145482]

Në pasqyrën sinoptike në vijim është shprehur përmes statistikash vendi që kanë zënë llojet e nënlojet e kërkimit shkencor në botimet e Ali Aliut, të të gjitha niveleve: prej monografive tematike dhe interpretime, artikujve shkencorë dhe kritikë, teksteve universitare dhe shkollore, përkthimeve e përshtatjeve, deri te recensionet, shkrimet kritike, artikujt polemikë e popullarizues.

Sikurse u shenjua që në krye, në këtë panoramë mungojnë të dhëna që ende nuk janë përpunuar në trajtë të numerizuar, por mungojnë gjithashtu përbërëse thelbësore të veprimtarisë së tij, që nuk shprehen e nuk mund të shprehen dot vetëm me numra, si veprimtaria universitare, mentorimi i brezave të rinj të studiuesve, hartimi i antologjive, botimi kritik i veprave të autorëve tradicionalë apo bashkëkohorë.

Nr.	Lloji/nënloji	Numri i përafërt
1.	Artikull shkencor-profesional	30
2.	Artikull kritik në shtypin letrar	100
3.	Kumtime, referate, ligjërata në konferenca	4
4.	Recensione	108
5.	Polemikë, kritika, komente, diskutime, intervista	8 +2 🗳️🗳️🗳️🗳️
6.	Monografi shkencore-profesionale	68
7.	Tekste mësimore	3
8.	Redaktor	47 🗳️🗳️🗳️🗳️
9.	Përkthyes	25
10.	Përshtatës	13
11.	Vepra më e ribotuar dhe më e përkthyer: <i>Don Kishoti te shqiptarët</i>	11 🗳️🗳️🗳️🗳️
12.	Tekst shtesë në veprën e një autori tjetër (parathënie, shenjim, cituar në anën e pasme të ballinës	85
13.	Tekst shtesë në veprën e një autori tjetër (parathënie, shenjim, cituar në anën e pasme të ballinës	22
14.	Recenzent (para botimit)	17
15.	Të tjera	20

Mungon sigurisht edhe pjesa e misionit të tij në kohëra shumë të vështira, si kryesues i së parës zyre përfaqësimi të Kosovës në Shqipëri, për çka dokumentet dhe burimet do të flasin në kohën e duhur, duke zbuluar merita që historia do t'i nderojë.

Mungojnë gjithashtu të pamatshmet vlerësime të anës njerëzore të personalitetit të Ali Aliut, që, në mjediset ku kemi jetën profesionale e familjare, thënë në gjuhë relative, me të drejtë konsiderohet një prej burrave më të sjellshëm të botës shqiptare.



Matteo Mandalà

“KUR DON KISHOTI ZBRITI NDËR ARBËRESHË”:  
JERONIM DE RADA NËN PRIZMIN KRITIK  
TË PROF. ALI ALIUT

Fama e Don Kishotit dhe e shqytarit të tij Sanço Panços janë universale dhe shpesh dalin nga bota e letërsisë për të hyrë në botën reale. Janë të tilla sepse fatet e tyre si personazhe janë ontologjikisht të lidhura pazgjidhshëm mes tyre: njëri pa tjetrin do të ishte i gjymtë. Kështu, me termin “donkishotizëm” shënohen ato qëndrime njerëzore që priren drejt idealesh objektivisht të p realizueshme, ndërsa me termin e kundërt “antidonkishotizëm”, që ndoshta do të duhej ripagëzuar “sançopançizëm”, për të rivendosur ekuilibrin në marrëdhënien e çiftit mes dy personazheve të Servantesit, shënohen pritjet po aq tipikisht njerëzore që rreken të frenojnë ato shtysa ekstravagante, surreale, ndonjëherë të marra, që karakterizojnë *donkishotizmin*. Gjithsesi, ana gjeniale e shpikjes së Servantesit qëndron në vendosjen e këtyre dy karikaturave të njeriut të çdo kohe në atë zonë që shënon kufirin, madje ndonjëherë hendekun, mes dy realiteteve të kundërta, të palidhura e të pareduktueshme në një përfaqësim të thjeshtë logjik. Në letërsi kjo vendosje ka të bëjë me autorë të epokave dhe të kulturave të ndryshme, nga Homeri te Lukano, nga Dante te Shekspiri, nga Gogoli te Xhojsi, nga Kafka te Kadare, për të përmendur vetëm disa prej tyre. Tek autorët bashkëkohorë, vepra revolucionare e Servantesit ka qenë gjithmonë e pranishme dhe nuk mund të ndodhte ndryshe, sepse falë atij kufiri të labërguar që ndan identitetet, qofshin individuale a kolektive, mund të përsiatim mbi mëdyshjet që i pengojnë njerëzit të lidhin një marrëdhënie të qartë, të thellë e të përhershme me realitetin. Kjo temë e fundit është objekt i një debati filozofik, që, krahas shndërrimit të tij letrar, zhvillohet qysh nga fillimet e mendimit spekulativ, pra nga epoka preindustriale, deri në ditët tona tashmë i përtëritur nga obsesioni i kalimit të të njëjtit kufi ekstrem: atij të inteligjencës artificiale. Të jetosh në kapërcyell të dy botëve të kundërta të realitetit dhe të marrëzisë ka qenë *conditio sine qua non* i epifanisë së shpikjes, krijimit, zbulimit, qoftë në kuadrin e shkencës, qoftë në atë të artit. Jo më kot gjenialiteti ka shoqëruar “punëtorët e intelektit”, qofshin shkencëtarë apo poetë, të cilët kanë jetuar dashur pa dashur gjendjen e vështirë të dyzimit, të copëzimit, të tjetërsimit të shkaktuar nga raporti mes “donkishotizmit” dhe së kundërtës së tij,

“sançopançizmit”, a thënë ndryshe mes fantazisë së shfrenuar dhe arsyes, mes shtysës së tepruar të së parës dhe moderimit të së dytës. Është e tepërt të themi se gjatë kësaj sfide, sikurse e dëshmon edhe shqyrtimi retrospektiv i historisë së mendimit dhe kulturës, e para ka qenë vendimtare në mënyrë që zhvillimi i së dytës të shpinte në kapërcimin e kufirit të vjetër dhe në vendosjen e një objekti të ri më ambicioz.

Këto konsiderata të shkurtra na lejojnë të hyjmë në trajtimin e kontributit kritik që i ka sjellë prof. Ali Aliu njohjes së historisë së letërsisë shqipe, një njohje që pasi është quajtur *një histori ndryshe* në nëntitullin e botimeve të fundit të librit, e detyron lexuesin e vëmendshëm të hulumtojë arsyet e përdorimit të metaforës që gjendet në titull: *Don Kishoti Shqiptar*<sup>1</sup>. Pse prof. Aliu ka shtënë në punë këtë imazh ikonik të mendimit kritik evropian për të propozuar një interpretim “alternativ” të historisë së letërsisë shqipe? Mbi cilat premisa bazohet botëkuptimi i ri i studiuesit të shquar dhe cilat janë synimet e tij?

Nuk është e tepërt të saktësojmë që për t’u përgjigjur drejt këtyre pyetjeve fillimisht do parashtruar një përmbledhje e shkurtër e arsyeve të suksesit të jashtëzakonshëm që vepra e Servantesit ka arritur historikisht kudo në botë, por sidomos te shqiptarët, veçanërisht tek ata që, duke jetuar në vise të ndryshme shqipfolëse nëpër Europë, e njohin mirë brengën e ndarjes dhe barrën e rëndë të kufijve. Në këto radhë do të lëmë mënjanë gojëdhënat e pambështetura gjëkund mbi robërinë e Servantesit në një burg diku mes Malit të Zi dhe Shqipërisë dhe nuk do t’u japim peshë spekulimeve marroke mbi emrat e disa personazheve që popullojnë romanin e Don Kishotit, dhe që sipas autorëve të tyre sjellin në vëmendje marrëdhëniet që shkrimtari spanjoll paskësh pasur me botën shqiptare.

Më të thella dhe jetëgjata janë dëshmitë e pranisë së *Kalorësit mendjemprehtë* në kulturën e re letrare shqiptare, qoftë të asaj që gjatë fazës së “modernizimit” ka ndjekur pavetëdijshëm hullinë e “donkishotizmit” militant, qoftë edhe të asaj tjetrës, më të matur, që ka njohur trajtat më poliedrike të kësaj dukurie të jashtëzakonshme të kulturës moderne, sidomos pas përkthimit shqip të pjesës së parë të romanit prej Fan S. Nolit mes viteve 1932-1933<sup>2</sup>. Nuk është e thjeshtë ta përmbledhim në pak rreshta suksesin e madh të veprës së Servantesit në

<sup>1</sup> Shih Ali Aliu, *Don Kishoti Shqiptar. Një histori ndryshe e letërsisë shqipe*, Ribotim i zgjeruar, Botimet Toena, Tiranë, 2020<sup>3</sup>. Të gjitha citimet e mëposhtme, nëse nuk specifikohen ndryshe, i referohen këtij botimi të veprës së prof. Aliut.

<sup>2</sup> Përkthimi shqip i pjesës së dytë të romanit *Don Kishoti i Mançës u krye nga Petro Zheji, në vitin 1977*.

Shqipëri, por edhe më e vështirë është të shtjellojmë receptimin e jash-tëzakonshëm dhe “dobinë” që pati në rrafshin artistik “miti” i moder-nitetit që përcillet nga personazhi i Don Kishotit, çka në fakt përbën një temë kyçe në historinë e kulturës shqiptare<sup>3</sup>, madje do të thoshim ball-kanike. Do të mjaftonin vlerësimet që ka shprehur më se një herë Ismail Kadare<sup>4</sup> për *Kalorësin* tonë, që të mund të qëmtojmë ndikimin e këtij romani në veprat e tij, duke filluar nga shija e kërkuar për grotesken dhe irrealen, që janë dy prej elementeve tipologjike që përshkojnë dhe lidhin si fill i kuq pjesët e ndryshme të universit narrativ të *Ismailand*-it, duke na dhënë kështu një imazh artistikisht kompakt dhe ideologjikisht ko-herent. Të njëjtën gjë mund të themi për shumë vepra shkrimtarësh të tjerë, si Jeronim De Rada, Naim Frashëri, Lasgush Poradeci, Dritëro Agolli, Luan Starova dhe Kim Mehmeti, sa për të zënë ngoje vetëm disa ndër interpretuesit e “donkishotizmit” militant që u përket dy fazave të lartpërmendura të historisë letrare shqiptare. Po të duam ta zgjerojmë horizontin e pranisë së personazhit të Servantesit në suazën e historisë së kulturës shqiptare, ç’mund të themi për kontributin që kanë dhënë disa ndër interpretuesit më të mprehtë të tij në dritën e mësimëve që rrjedhin pikërisht nga “donkishotizmi”? Nga shtjellimet e mprehta kra-hasuese në kufijtë e letërsive që kreu Aurel Plasari, i cili mund të konsi-derohet si një nga studiuesit e parë që morën dhe hodhën në qarkullim mësimin “donkishotesk” të Nolit gjatë periudhës së tranzicionit<sup>5</sup>, te përsiatjet e të ndjerit Alfred Uçi<sup>6</sup>, është e vështirë të mos rrokim gjurmët e thella që ka lënë në kulturën letrare shqiptare figura e Don Kishotit.

<sup>3</sup> Mbi këtë temë të rëndësishme rreth identifikimit të ndikimeve europiane mbi kulturën shqiptare bashkëkohore, të shihen punimet e Admirina Nushit, “Don Quixote, Figures and Philosophical Journey of Cervante’s Masterpiece in Albania” në *Speculative truth Fantasy and reality*, Annals of “Ştefan cel Mare” University, Volume II, Ştefan cel Mare” University of Suceava Press, Suceava, 2014, f. 101-114; Admira Bekteshi-Nushi, “Don Quijote, su lectura en Albania” në *Didaktik – Linguistik – Literatur – Gender-Pädagogik und albanische Hochschul-reform*, Herausgegeben von Mario de Matteis und Jürgen Röhling, (Albanische Universitätsstudien, Band 11), Athena, 2014. Këto dy studime paraprinë punimin e tezës së doktoratës së Admirina Nushit, *Don Kishoti ky humbës fitimtar*, Universiteti i Tiranës – Fakulteti i Gjuhëve të huaja, Tiranë, 2015.

<sup>4</sup> Ismail Kadare, “Don Kishoti në Ballkan” në *Vepra*, vëllimi XVIII, Onufri, Tiranë, 2009, f. 519-542. Një “lexim” i parë kadarean i “donkishotizmit” i përket vitit 1994, por ai që pati sukses të gjerë u kumtua gjatë ceremonisë së dorëzimit të çmimit prestigjioz “Princi i Asturias 2009”, paraprirë nga një intervistë që shkrimtari dha në Palermo me rastin e marrjes së *Laurea Honoris Causa* nga Universiteti i Palermos.

<sup>5</sup> Aurel Plasari, *Don Kishoti zbret në Shqipëri dhe ese të tjera të letërsisë së krahasuar*, Shtëpia Botuese Naim Frashëri, Tiranë, 1990.

<sup>6</sup> Alfred Uçi, *Filozofia e Donkishotizmit*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2010.

Tani, pikërisht sepse vepra e prof. Aliut do parë brenda këtij perimetri të receptimit aktiv të “donkishotizmit”, është e nevojshme të theksojmë paraprakisht se, ndryshe nga studiuesit e tjerë, vëmendja e profesorit tonë ka qenë konstante. Madje mund ta quajmë obsesive po të mbajmë parasysh suksesin që ka njohur *Don Kishoti* i tij. Në fakt, pas botimit të parë të vitit 1995<sup>7</sup>, qasja fillestare mori tiparet e një projekti të mirëfilltë kërkimi që u shndërrua gradualisht në një hermeneutikë të historisë letrare shqiptare, pra në një histori “alternative”, që pati një sukses në rritje mes publikut dhe kritikës. E përkthyer në maqedonishte<sup>8</sup>, në bullgarishte<sup>9</sup> dhe në anglishte<sup>10</sup>, monografia e prof. Aliut njohu katër botime të tjera të zgjeruara: botimi i parë doli në Prishtinë<sup>11</sup>, ndërsa tri të tjerat (2010, 2012, 2020) dolën në Tiranë nga Shtëpia Botuese *Toena*. Është rasti të theksojmë, edhe duke pasur parasysh shtimin e vëllimit në botimet e fundit, se ky “efekt anësor” i çuditshëm është rezultati më i dukshëm i angazhimit të profesorit tonë, pasi përbën zgjerimin e horizontit kritik dhe fuqizimin e impiantit origjinal metodologjik, me synimin e vetëm të arritjes së objektivit hermeneutik, pra për të dhënë një ide të plotë mbi realizimin e “donkishotizmit” në *res publica litterarum albanensium*. Kështu, futja e portreteve të reja të shkrimtarëve shqiptarë, mes të cilëve veçojmë atë të Luan Starovës, mikut të paharruar që për arsye të ndryshme përjetoi gjendjen e vështirë të të mërguarit që ka karakterizuar historinë kulturore dhe letrare të arbëreshëve, nuk ka funksion tjetër përveçse të na thotë se kufijtë e “donkishotizmit” nuk janë shtjelluar ende mjaftueshëm. Së paku në Shqipëri nuk janë shtjelluar në raport me prirjet e letërsisë bashkëkohore, çka hedh sërish dritë mbi kurajën kritike me të cilën prof. Aliu është rrekur të arrijë këto rezultate. Nga kjo pikëpamje na vijnë në ndihmë vlerësimet që Gane Todorovski ka shprehur në parathënien e botimit të fundit të librit të prof. Aliut:

«Nuk është ky libër i njohjes nominale shkollareske, as doracak për nxënësit e shkollave të mesme dhe studentët, nuk është as përmbledhje “qëllimmirë” dhe “praktike apo e dobishme” për

<sup>7</sup> Shih: Ali Aliu, *Don Kishoti te shqiptarët*, Flaka e vëllazërimit, Shkup, 1996.

<sup>8</sup> Shih: Ali Aliu, *Don Kihotot medju albancite*, Kultura, Skopje, 2004.

<sup>9</sup> Shih: Ali Aliu, *Don Kihotot meždu albancite*, Blgarski pisatel, Sofija, 2008) dhe në anglisht (*Don Quixote among Albanians*, translation from Albanian Granit Zela, St. Clement of Ohrid, National and University Library, Skopje, 2011).

<sup>10</sup> Shih: Ali Aliu, *Don Quixote among Albanians*, Translation from Albanian Granit Zela, St. Clement of Ohrid, National and University Library, Skopje, 2011.

<sup>11</sup> Shih: Ali Aliu, *Don Kishoti te shqiptarët*, Redaktor Eqrem Basha, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Botime të veçanta LXIII / Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. Libri 27, Prishtinë, 2005.

*shkollat. Këtu nuk është me rëndësi se sa janë dhe cilët janë autorët për të cilët bëhet fjalë. Ata janë tetëmbëdhjetë përfaqësues të fjalës letrare shqipe (nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia<sup>12</sup>), të cilët veçohen si dominues, superiorë, eminentë, të njohur [...]. Ata janë përfaqësues antologjikë të fjalës letrare. Dhe zgjedhja si zgjedhje pasqyron njohjen, shijen, arsyen e vlerësimit tematik dhe estetik, por, të gjithë autorë të moshës jo të njëjtë dhe nga periudha të ndryshme kohore, janë të ndriçuar nga reflektorët e qëndrimit që e thamë se është – vrojtim i thellë, e si i tillë paraqet shenjë njohëse të dimensionit të ndërlikuar donkishotian në përcaktimin dhe rrumbullakimin e tyre programor»<sup>13</sup>.*

Mund të themi se akti i parë hermeneutik i prof. Aliut kryhet gjatë zgjedhjes së autorëve, sepse pikërisht nga interpretimi i një vepre ose i një autori rrjedhin karakteristikat që përlligjin përfshirjen (ose përjash-timin) në këtë galeri të jashtëzakonshme që nga shumë aspekte na kuj-ton atë të Giambattista Marino-s, eksponentit të shquar të kulturës baro-ke së cilës i përkiste edhe Servantesi. Në hullinë e këtij konstatimi mund të themi se Aliu përdor një metodë të ngjashme me atë ekfrastike të Marinos, paçka se me dallimin thelbësor të përshkrimeve që nuk kanë të bëjnë me piktura, por me të njëjtën “fjalë letrare” që rroket në procesin historik, në procesin e shndërrimit në vizion të botës, pra në kodi-fikimin e saj në “historinë e letërsisë”. Elementi që shmang rreziqet e improvizimit dhe që, duke përdorur rreptësinë metodologjike, na jep një perceptim të lakores kohore, historike dhe strukturore, përbëhet nga binomi *donkishotizëm-sançopançizëm* si busull që orienton, ndërton dhe parashtron perspektivën hermeneutike të interpretimit kritik. Këtej rrjedh e drejta për të folur për një histori letrare “alternative”, që nuk përkon me atë ku zakonisht bazohen tekstet didaktike të letërsisë dhe që për të afirmuar nevojën e rishqyrtimit të zhvillimit letrar mbi themele të shëndosha, sipas një parimi rregullues dhe një kategorizimi takso-nomik, përmbledhet në paradigmen e “donkishotizmit”, që prof. Aliu jo më kot e quan «paradigmë e pakapërcyeshme e shumë popujve»<sup>14</sup>, ndër të cilët, natyrisht, janë edhe shqiptarët. Pajtohemi plotësisht me argu-mentet e studiuesit tonë: «Shqiptarët, – shkruan profesori – të shpër-ndarë në të gjitha kontinentet [...], ende vazhdojnë të jenë të ndarë me

<sup>12</sup> Citimi i Todorovski-t do plotësuar me përmendjen e Italisë dhe të arbëreshëve, që nuk mungojnë në librin e prof. Aliut.

<sup>13</sup> Gane Todorovski, “Në gjurmim të reflekseve kuptimore të Don Kishotit servantesk në letërsinë shqipe”, në Ali Aliu, *Don Kishoti Shqiptar*, cit., f. 9.

<sup>14</sup> Ali Aliu, *Don Kishoti Shqiptar*, cit., f. 14.

vetveten, [por] e ruajnë identitetin e tyre letrar». Kjo arsye i ka bërë të mbeten «peng të një “*donkishotizmi*” specifik»<sup>15</sup>, duke i shndërruar në «*donkishotistët* e papajtueshëm, të cilët në periudha të gjera e të gjata kohore do t’ia dorëzojnë stafetën donkishoteske njëri-tjetrit duke besuar se jetën e tyre e kishin lidhur me kauzën e madhe: mbrojtjen e identitetit gjuhësor të popullit të tyre»<sup>16</sup>.

Zbritja e donkishotizmit në trojet shqiptare, përtej suksesit që ka njohur, nuk ka qenë krejt e papërshtatshme, madje duket se ka gjetur kushte të favorshme për t’u rrënjosur: shqiptarët që zgjodhi prof. Aliu janë «autorë [...] të shpërndarë mes Ballkanit dhe Evropës, mes Bizantit dhe Romës, mes Ballkanit dhe Perandorisë Osmane, mes traditës dhe modernitetit»<sup>17</sup>, pra janë të lidhur ontologjikisht me nyjën e pazgjidhshme që bashkon *donkishotizmin* me *sançopançizmin*. Përballë një synimi në dukje të porealizueshëm (që hera-herës mund të jetë identiteti kulturor, vlera e gjuhës, pavarësia kombëtare) ishte e pashmangshme, madje e volitshme për shqiptarët e çdo epoke dhe zone gjeografike ideja për t’u strehuar nën zhguallin e realitetit, për t’u dorëzuar përpara vështirësive dhe për të pranuar sfidat e irrealës, të së parrokshmes, madje të së parrëfyeshmes: me fjalë të tjera, ideja për të ndjekur gjurmët e Don Kishotit të Mançës në kërkim të realizimit të idealeve. Nga kjo pikëpamje duket se shqiptarët kanë bërë të veten filozofinë e njohur dhe të konsoliduar të *donkishotizmit*, kur në të vërtetë nga analiza e prof. Aliut del një vizion më i nyjetuar. Sipas studiuesit tonë, kushtet e “tjetërsimit” të përhershëm ku kanë jetuar historikisht shqiptarët, i kanë shtyrë ata të marrin një udhë alternative, paralele me të parën, por më të lashtë, pasi është rrënjosur në frymën antropologjike të të parëve. E kemi fjalën për udhën e tolerancës dhe të sensit të masës, të nderit dhe të solidaritetit, ku arrihet falë urtësisë dhe fuqisë shpirtërore që ushqehet nga përvoja e përditshme e ballafaqimit ndërkulturor. Në vështrim të parë duket se kemi të bëjmë me qasjen që karakterizon *sançopançizmin*, mirëpo në të vërtetë nuk është ashtu, pasi kjo udhë na shpie drejt një versioni të ri të *donkishotizmit*. Shqiptarët, në fakt, pa u shqetësuar se mund të bien në pozita groteske, kanë marrë një qëndrim mirëfilli donkishotesk nga çasti kur kanë pranuar si të pashmangshëm dialogun me kulturën e “të tjerëve”, pra të “të ndryshmëve”, që nga ana e tyre mishërojnë një vizion të kundërt të botës, duke i dhënë jetë kështu një hapjeje kulturore që vetëm një shpirt i lirë, a ndoshta duhet të themi një shpirt “i marrë”,

<sup>15</sup> Po aty, f. 14.

<sup>16</sup> Po aty, f. 15.

<sup>17</sup> Po aty, f. 15.

mund të zgjedhë në një gjendje konflikti. Përvijimi i ri i paradigmës së *donkishotizmit*, që shtjellohet hollësisht dhe mprehtësisht në vepër, përbën sintezën e mendimit hermeneutik të prof. Ali Aliut, veçantia e të cilit qëndron në faktin se arrin të identifikojë dhe të analizojë «një “donkishotizëm” specifik, fare pak të njohur nga popujt e tjerë»:

*«Akti i njohjes i gjuhës së tjetrit, prezantimi i thelbit të identitetit të tyre para palës tjetër, sidoqoftë ka qenë akt humaniteti dhe tolerance universale, një donkishotizëm shqiptar. Edhe pse kultura dhe letërsia shqiptare shkruhej në masën më të madhe, sidomos në shekullin XIX, në gjuhën e të tjerëve, në qendrat e largëta evropiane, tej vendit amë, ajo vazhdoi të ushqej përherë dhe pandërprerë nga donkishotizmi i frymës dhe i shpirtit shqiptar. Nëse zbulohen porosinë e thella humane të kësaj letërsie dhe kulture dhe anasjelltas, do të krijohet një bazë e gjerë dhe reale për një bashkëjetesë në mirëkuptim dhe kapërcim të pengesave objektive, për një jetë të përbashkët. Shqiptarët janë ndër të rrallët, në mos të vetmit në Ballkan, të cilët pa kurrfarë rezerve e pranojnë identitetin maqedonas, krejt ndryshe nga fqinjët e tjerë të këtij populli ballkanas»<sup>18</sup>.*

Prej kohësh tashmë me mikun dhe kolegun Francesco Altimari mbështetim të njëjtën ide të një identiteti që është afirmuar historikisht si tipar i vizionit plural që kultivojnë shqiptarët në marrëdhënie me kulturat e tjera, marrëdhënie të karakterizuara nga respekti, hapja, toleranca dhe gjithpërfshirja. Sa u përket arbëreshëve, ky qëndrim dëshmohet nga një dokumentacion i gjerë historiko-arkivor, që nxjerr në pah zanafillën e ndërlikuar dhe zhvillimin po aq të koklavitur të kundërvënieve dhe ballafaqimeve që karakterizuan shekujt e parë *te dheu i huaj*, deri te shpikja përfundimtare, falë shtysave që vinin prej lëvizjeve romantike evropiane, e një identiteti kulturor modern, që pastaj do të zhvendoset në Ballkan. Nuk ka dyshim se tek ideja largpamëse e prof. Ali Aliut mbi ekzistencën e «një donkishotizmi shqiptar», gjejmë shumë elemente që kanë ushqyer procesin e ndërtimit të identitetit ndër komunitetet arbëreshe. Kjo konfirmon faktin se zgjedhja për të imituar thelbin ideologjik të mishëruar në bëmat e Don Kishotit për shqiptarët diktohej nga vetë historia e këtij populli ballkanik, madje nga vetë struktura antropologjike e identitetit të tij: i ndarë së jashtmi, por edhe së brendshmi. Një rast i rrallë i copëzimit të identitetit, të atij “kolektiv”,

<sup>18</sup> Po aty, f. 16.

sikundër edhe “individual”, por edhe një rast unik i “rindërtimit” të identitetit, si reagim utopik ndaj rrezikut të asimilimit, pra të shfarosjes kulturore. E vërteta e përvojës historike rezulton edhe ajo groteske, pothuajse një oksimoron antropologjik: a mund të pretendohet për një identitet të caktuar duke bashkëjetuar me një tjetër, duke valëvitur disa flamuj, madje duke folur gjuhë të ndryshme? Kush duhet t’i paguajë kostot për arritjen e këtij objekti të ri e të lartë të humanizmit modern? Deri në ç’ pikë mund të shtyhet kufiri i vetvetes para se ajo të reshtë se qeni vetvetja dhe të shndërrohet në diçka tjetër?

Këto janë pyetje kyçe të cilave njerëzit rreken t’u japin përgjigje nga këndvështrime të ndryshme epistemologjike. Me siguri më bindëset nuk do të jenë ato që ndjekin hullinë e *sançopançizmit*, në mos tjetër sepse, të dënuara të përsërisin përjetësisht në mënyrë niçeane të njëjtën, do të kufizohen ta përfaqësojnë realitetin në shfaqjen e ndryshueshme e të pandryshueshme fenomenologjike, përfundimisht të fragmentarizuar dhe në dukje të papajtueshme. Përkundrazi, do të jenë përgjigjet e ihtarëve të *donkishotizmit*, të intelektualëve – në radhë të parë të artistëve, shkrimtarëve dhe poetëve, të vetmit adhurues të mitit – të cilët, duke qenë subjektet më përfaqësuese dhe interpretuesit më të sinqertë të shpirtit të popujve, joshen në mënyrë instinktive nga ana e errët e realitetit, kërkojnë shfaqjet e asaj ane të errët, madje orvaten t’i ndjellin ato duke ia hyrë një gare të shfrenuar që i përfshin deri në atë pikë sa të shkaktojë shndërrimin rrënjësor të vetë subjektivitetit të tyre intelektual. Detyrës së vështirë për t’u dhënë zgjidhje këtyre çështjeve hemeutike i ka bërë ballë më së miri prof. Aliu, i cili, ndër vlerat më të mira shpirtërore të shqiptarëve që përcillen nga historia e tyre letrare, përfshin edhe dëshmitë estetike të dy shkrimtarëve që gjenden në dy skajet kohore të kësaj kozmogonie letrare të përvijuar sipas filigranës së *donkishotizmit*: i pari është *italo-shqiptari* Jeronim De Rada, ndërsa i dyti është *maqedono-shqiptari* Luan Starova, të dy bij të mallkimit historik që ka rënë hera-herës mbi shqiptarët duke i shtyrë ata të zhvendosen “gjetkë” dhe duke i detyruar të rishpikin një identitet “të dyfishtë” në lartësinë e sfidave të reja të kohës së tyre historike.

Tani, meqenëse me *Sagën ballkanike* të Starovës jam marrë gjetkë<sup>19</sup>, është rasti këtu të shpreh disa mendime mbi faqet e ngjeshura

<sup>19</sup> Shih: Matteo Mandalà, “Në kërkim të identitetit të humbur: shënime rreth *Sagës ballkanike të Luan Starovës*”, kumtesë e mbajtur në veprimtarinë shkencore kushtuar veprës krijuese e studimore të akad. Luan Starovës në 80-vjetorin e lindjes, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, më 17 shtator 2021, në shtyp e sipër.

kushtuar figurës poliedrike të De Radës, që në Panteonin e *donkishotizmit* të ndërtuar nga prof. Ali Aliu ka privilegjin të zërë vendin e parë. Natyrisht, privilegji që i rezervohet poetit të madh arbëresh nuk u detyrohet vetëm arsyeve kronologjike që shohin te De Rada shkrimtarin e parë “modern” në gjuhën shqipe. Më të rëndësishme janë arsyet historiografike që i japin mundësinë prof. Aliut të shqyrtojë me një “psikologjizëm” të rrallë kontekstin historiko-social të arbëreshit të shquar, natyrën plurale të identitetit të tij kulturor, gjendjen e tij të veçantë prej “refugjati gjuhësor”, krejt të ngjashme me atë të Luan Starovës – aspekte këto që jo më kot u shkojnë përshtat gjithë atyre që, pasi detyrohen të shpërngulen, e shohin veten në mbrojtje të identitetit të tyre duke bashkëjetuar me sisteme sociale, kulturore e gjuhësore “të ndryshme”.

Modeli “deradian” është shembull paradigmatic i «donkishotizmit specifik» që merr në analizë prof. Ali Aliu, së paku për tri arsytet e mëposhtme që po përmbledh shkurtimisht, duke ndjekur hullinë e mendimit kritik të studiuesit tonë:

a) Kërkimi i një përmase gjuhësore “vetë-përfaqësuese” zbulon aspiratat utopike dhe idealiste të poetit të ri arbëresh, duke na lejuar ta shohim atë në dritën e *donkishotizmit*: nga sprovat e para poetike italisht deri te përshtatja e këngëve popullore dhe stilemave shprehëse të poezisë gojore dëshmohet kalimi “ndërtekstor” mes dy modeleve të kundërta të referimit estetik. Pikërisht falë kësaj lakoreje të veçantë, Ali Aliu vëren se te De Rada «misioni kishte dimensionin e tij “donkishotesk”»<sup>20</sup>, pasi zhvendosja e boshtit poetik nga një rrafsh “anormal” eksperimentimesh krijuese të kryera në një gjuhë të huaj në një rrafsh tjetër më të guximshëm, që paçka se familjar, ishte i pakonsoliduar, parakupton medoemos metamorfozën e poetit që jo rastësisht me ndryshimin e identitetit të vet gjuhësor, ndryshon edhe perimetrin e botëkuptimit të tij ideologjik. Pikëpamja e prof. Aliut është vërtet largpamëse, sepse është formuluar shumë kohë para se të zbulohet ky tipar i veçantë i artit deradian në një suazë filologjiko-tekstore përmes analizës së dëshmive të para poetike që u paraprinë shkrimit të *Këngëve të Milosaut*<sup>21</sup>.

b) Shpikja e një bote “letrare” artificiale dhe mitike, paralele dhe alternative me atë “reale” si rezultat i një strategjie ndërtekstore e cila

<sup>20</sup> Ali Aliu, *Don Kishoti Shqiptar*, cit., f. 24.

<sup>21</sup> Shih: Matteo Mandalà, *Jeronim De Rada: Portret artisti në rini (1832-1837)*, Naimi – Shtëpi Botuese e Studio Letrare, Tiranë, 2018, f. 67-162.

bazohet mbi brengën që ndien një intelektual të cilit i janë mohuar rrënjët, përkon plotësisht me projektin deradian të *Milosaut*. Në të vërtetë, kemi të bëjmë me rezultatin e pashmangshëm të zgjedhjes së një kodi gjuhësor që kryhet në zbulimin e një përmase të re të identitetit kulturor dhe që ka nevojë të rrenjose në një sistem vlerash të idealizuar. Mjeshtëror është gjykimi kritik me të cilin prof. Ali Aliu përshkruan «fenomenin, atëherë të panjohur për letërsinë shqipe, të *realitetit konkret* si dhe të *realitetit fiktiv*». “Bota e re” është një krijesë artificiale që e autorizon poetin ta shohë të kundërtën e saj si “botë reale”: Të parën, si një vend të idealizuar, të frymëzuar «nga realiteti konkret arbëresh, nga ai kod mental socio-kulturor, të cilin poeti e kishte njohur me të gjitha atributet e tij»<sup>22</sup>. Në të vërtetë, sikurse kam pasur rast ta vërtetoj duke ndjekur udhëzimet e Francesco Altimarit, De Rada, si interpretues i mirëfilltë i *donkishotizmit*, kishte shkuar edhe më tej, duke arritur ta plazmonte realitetin konkret në mënyrë që t’i ngjante realitetit të stisur në veprat e tij poetike<sup>23</sup>. Kjo konfirmon dhe përforcon saktësinë e impostimit hermeneutik të prof. Ali Aliut.

c) Kapërcimi i kufirit hapësinor dhe shfuqizimi i kufirit kohor si ikje e poetit të syrgjynosur dhe si orvatje e fundit për t’i gjallëruar rrënjët e thara në botën e re “të shpikur”, por edhe për të ngjallur shpresën e “rilindjes” kulturore të botës së vjetër, që në vizionin deradian nuk është ajo e fshatit të tij të lindjes, por ajo që lanë prapa të parët e tij pas pushtimit osman. Nga kjo pikëpamje, fati i të mërguarit, sidomos i poetit, është që të jetojë gjendjen e dyzimit të përhershëm si një lloj dënimi që kërkon një akt shëlbimi: ruajtja e gjuhës nuk mund të jetë qëllim në vetvete, por duhet të synojë “ringjalljen e atdheut”, për të përdorur një shprehje të dashur për romantikët. Prof. Aliu nuk ngurron të pranojë se «Jeronim de Rada besonte si një Don Kishot i vërtetë të kthimi i njëmendtë nga ekzili, pikërisht përmes ruajtjes së gjuhës, përmes vazhdimësisë së gjallë të përdorimit të saj dhe vazhdimësisë së krijimtarisë poetike kolektive të popullit të vet. Besonte Jeronim de Rada gjithashtu se “kthimi” mund të ndodhte vetëm nëse mbrohej identiteti i arbëreshëve në tokë të huaj»<sup>24</sup>. Miti i “rikthimit” do të shndërrohet në një *topos* të zakonshëm në letërsinë arbëreshe të Rilindjes, i cili haset shpesh te autorë si: Gavril Dara i Riu, Zef Serembe dhe sidomos Zef Skiroi, që i kushtoi gjithë veprën e vet poetike këtij motivi. Se sa utopi

<sup>22</sup> Ali Aliu, *Don Kishoti Shqiptar*, cit., f. 24.

<sup>23</sup> Shih: Matteo Mandalà, *Jeronim De Rada*, cit., f. 27-66.

<sup>24</sup> Ali Aliu, *Don Kishoti Shqiptar*, cit., f. 28.

të ushqyer me realizëm të shëndoshë kishte në këtë vizion, vetëm pas-ardhësit mund ta thoshin. Kjo konfirmon edhe një herë vlerën e interpretimit kritik të prof. Ali Aliut, të cilin sot mund ta konsiderojmë si një nga njohësit më të thellë të veprës së De Radës.

Si përfundim, nuk gabojmë po të pohojmë se në interpretimin deradian të *donkishotizmit* të orëve të para fshihet një vizion më i pjekur i filozofisë së *kalorësit mendjemprehtë*. Kjo e vërtetë hermeneutike del në pah falë leximit të kujdesshëm që dëshmon natyrën donkishoteske të atij që e ka zbuluar dhe përhapur atë: tek e fundit, a nuk e kanë thënë gjithmonë studiuesit e Servantesit se në natyrën e thellë të Don Kishotit të madh dhe të shqytarit të tij besnik është materializuar edhe krijuesi i tyre?



Zejnullah Rrahmani

## ALI ALIU – PËRBALLË NJË SHEKULLI

### I

Pesë vjet më herët më qëlloi shorti që të përgatisja një vëllim shkrimesh të Akademik Ali Aliut, të cilin ASHAK-u po e botonte me rastin e ditëlindjes së tij të 85-të. Para se të filloja punën në atë vëllim, të cilit, në fund të një pune disamuajshe me shkrimet e Aliut, ia gjeta titullin dhe e quajta ‘*Libri i Jetës*’, duke dashur që vëllimi i veprës së tij i shkrimeve kritike mbi letërsinë dhe i studimeve letrare të flasë vetvetiu edhe për jetën e një njeriu i cili në veprimtarinë e tij të gjatë letrare, ashtu si në ekzistencën reale të kohës së tij, në një mënyrë të veçantë ka qenë jetë e pasur në mënyrë të shumëfishtë.

Tash, mbas pesë vjetësh, kur Akademik Ali Aliu po e jeton të 90-n dhe jemi mbledhur për ta shënuar këtë përvjetor të gëzuar të jetës së tij, më pëlqen ta theksoj që krijimtaria e tij letrare prek shumicën e fushave të dijes letrare dhe në të gjitha ka shënuar rezultate të konsiderueshme dhe shpesh të dorës së parë për dijen tonë: në shkrimin kritik e studimin letrar shënon vlera të prej më të lartave, në shkrimin teoriko-letrar ka lënë gjurmë të rëndësishme, duke qenë për më shumë se dy decenie profesor i teorisë letrare, dhe besoj që mund të presim edhe rezultate në planin e shkrimeve historiko-letrare. Vepra e tij shesh shpreh dhe shenjon personalitetin e Aliut. Shkrimtaria e tij flet edhe për frymën e asaj që ka karakterizuar edhe jetën e tij, preokupimin qendror dhe degëzimin e asaj linjeje të jetës së Ali Aliut në veprimin e tij ideologjik–jetësor dhe në veprimin e tij si shkrimtar. Për këtë arsye, nuk mund t’i lexoj e t’i shoh shkrimet e tij të shkëputura nga personaliteti i tij, nga autori, njeriu me të cilin kam ndërtuar një raport të gjatë miqësor, një miqësi që kap një gjysmë shekulli dhe uroj të zgjasë...

### II

Si njeri, si individ, Aliu ka bërë një udhëtim jetësor nga ata që mund të përmenden me krenari midis intelektualëve shqiptarë në përgjithësi dhe që nuk është vetëm një pasuri autobiografike e këtij personaliteti. Kjo jetë e tij na ka bërë më të pasur edhe ne të tjerëve, që në

segmente të saj kemi qenë afër tij, ose kemi ndarë me të pikëpamje dhe veprime në situata të jashtëzakonshme, siç ishin ato të viteve '81-1999', por edhe në ato të zakonshmet, si ta zëmë vitet '70- '80, dhe gjithë të tjerat pas tyre, si këto të sotmet, dramaciteti i së cilave nuk qëndron në konfrontim me pushtuesin serb, po në konfrontim të brendshëm për të ndërtuar një vend të pavarur dhe demokratik, të lirisë dhe të vlerave kulturore e shpirtërore, në të cilin kosovarët nuk do të jetonin të varfër dhe të shtypur si sot, vazhdimisht në kërkim të mundësisë për të emigruar, po do të ishin të barabartë para ligjit dhe të lirë për të ndërtuar të ardhmen e begatë të familjeve të tyre në Kosovë. Gjithë jeta e këtij njeriu është një apel i gjatë dhe i tejkohshëm për të qëndruar e jetuar në truallin amtar.

### III

Jeta e Akademik Ali Aliut, si të thuash, korrespondon më shumë se e kujtudo ndër emrat që njoh me atë vargun e Lasgushit: *'Dyke nisur udhëtimin mes-për-mes nër Shqipëri, / Drini plak e i përrallshëm po mburon prej Shëndaumi...'*

Aliu ka nisur udhëtimin e tij jetësor në një hapësirë gjeografike të largët, afër Prespës, dhe pothuajse në kufi të viseve shqiptare të Maqedonisë, në një shtëpi të pasur bejlerësh me origjinë nga Kolonja, te porta e së cilës kanë lënë gjurmë bektashinjtë dhe ai vetë mban emrin e liderit të tyre shpirtëror, dhe, pas Prespës, rruga e ka shpënë në Manastir, ku në fëmijërinë e tij ka pasur një shkollë për nxënësit shqiptarë dhe ku, në kohën e pas Luftës së Dytë Botërore, sipas tij, ka gjallëruar ende ndonjë lagje e njohur dhe një frymë e fortë shqiptare dhe ku Kongresi i Manastirit ka pasur rrënjë të thella të kujtesës shpirtërore, atdhetare e kulturore, që ka buruar nga Kongresi i Alfabetit shqip. Në këtë qytet, Aliu ka qenë nxënës i një shkolle ku mësimi është zhvilluar në gjuhën shqipe për nxënësit e atij qyteti dhe të rrethinës. Ai vend, Manastiri dhe ajo ndërtesë ku punoi Kongresi i Alfabetit, edhe sot është një nyjë kujtimi e reference shqiptare, përkundër realiteteve shoqërore e nacionale të ndryshuara prej atëherë në Manastir, nga i cili shqiptarët tashmë kanë firuar.

### IV

Tetova shënon pikën e dytë ku Ali Aliu do të vazhdojë shkollimin, por shënon edhe qytetin të cilit ai do t'i kthehet të paktën edhe dy herë

të tjera. Të parën herë ndonjë dekadë më vonë si gazetar i *Flakës* dhe së dyti si profesor i shquar që do të japë kontributin e tij edhe për institucionet e reja të këtij kryeqyteti të ri të shqiptarëve të Maqedonisë. Si gazetar, i shquar sidomos për temat letrare e kulturore, jo rrallë penda e tij ka ditur të prekë në tema më të gjera shoqërore të Maqedonisë së kohës së Jugosllavisë komuniste, por me vendosmëri, aftësi dhe guxim që vlen të përmendet, ka gjetur hapësirë dhe ka trajtuar çështje të natyrës nacionale shqiptare, ta themi më qartë të pabarazisë nacionale të shqiptarëve të Maqedonisë. Tema e tillë në Maqedoninë e asaj kohe ishte tabu të trajtohej dhe qoftë edhe aluzionet mbi një pabarazi ishin të dënueshme. Aliu i është qasur kësaj çështjeje në mënyrë të jashtëzakonshme në një seri artikujsh mbi gjendjen e shqiptarëve në Tetovë, duke shfrytëzuar argumentet krejtësisht zyrtare të raporteve e të statistikave zyrtare ekonomike, sociale, të punësimit, të shkollimit, të prodhimit, tatimit të qytetarëve, të pjesëmarrjes nacionale në organet e ndryshme, në administratë dhe polici etj., etj. Ngjarjet që kanë ndodhur në vazhdim të këtyre artikujve e kanë ilustruar plotësisht qëndrimin e tij kritik dhe insistimin e tij drejt avancimit të pozitës nacionale të shqiptarëve.

Mbas shpërthimit të demonstratave në Tetovë, për shkak të shkrimeve të tilla Aliu u quajt si njëri nga frymëzuesit e demonstratave dhe pas diferencimeve të ndryshme në gazetën ku punonte, u largua nga Shkupi dhe përfundimisht u vendos në Prishtinë.

## V

Natyrisht që nuk ishte kjo hera e parë që Ali Aliu do të përballej me pushtetin jugosllav. Edhe më herët, po e njëjta gjë kishte ndodhur në Beograd, ku edhe ishte paraburgosur disa muaj për shkak të veprimtarisë së tij brenda kuadrit të shoqatës së studentëve shqiptarë të Beogradit, që u quajt 'Përpjekja' dhe kryetar i parë i së cilës qe zgjedhur Latif Berisha, poeti i ri që sapo kishte botuar përmbledhjen me poezi 'Tufa' dhe ku historiani Zeqiria Cana ishte zgjedhur sekretar. Të dy këta, bashkë me Aliun, qenë arrestuar e mbajtur disa muaj në paraburgim dhe vetëm disa rrethana fatlume kishin ndikuar të liroheshin. Pas shumë vitesh prej asaj kohe, Akademik Ali Aliu, bashkë me këta të dy, do të jetë në fund të viteve '80 të shekullit të kaluar prapë në krye të lëvizjes për liri dhe me Berishën edhe në Lidhjen Demokratike të Kosovës, lëvizje që për herë të parë në historinë e lëvizjeve politike të shqiptarëve të

Kosovës, artikuloi dhe veproi për pavarësinë e Kosovës, që del se sot është ideja fitimtare për kosovarët.

Brenda kësaj lëvizjeje, roli dhe funksioni i Ali Aliut kanë qenë të një rëndësie të veçantë, sepse është më i rëndësishmi dhe kryesori në formimin e degëve të LDK-së në Evropë, Amerikë dhe në Australi. Përveç këtij fakti, Aliu është ndër themeluesit e Fondit të 3%, i njohur që ishte fond solidariteti, që mbajti gjallë gjithë jetën shoqërore, veprimtarinë arsimore, kulturore, informative e shëndetësore të Kosovës në vitet '90. Ai ishte gjithashtu përfaqësuesi i parë zyrtar i Kosovës në Shqipëri dhe njëri ndër pak personat që bënë të mundur trajnimin e një numri kosovarësh në poligonet ushtarake të Shqipërisë...

Natyrisht, këtu nuk mund të mos e themi edhe se në vitet e vështira të rrëzimit të komunizmit në Shqipëri, Aliu është ndër personat e paktë, nga jashtë Shqipërisë, që ka ushtruar një lloj ndikimi të qartë në jetën shoqërore të Tiranës, them një ndikim jashtëzakonisht pozitiv dhe të rëndësishëm, sidomos për kulturën e letërsinë, po edhe për shoqërinë shqiptare në përgjithësi.

## VI

Mbaj mend që në vitet '80-'90, Aliu filloi të bënte vetë verën dhe e pati hapur shtëpinë e vet në Dragodan për fqinjët dhe miqtë e shumtë dhe me krenari të veçantë e tregonte bibliotekën e tij të rëndësishme me libra që i kishte mbledhur që nga Shkupi, Beogradi, Prishtina e Tirana. Këtë shtëpi, Aliu do ta braktisë një herë, kur u vendos në Tiranë, dhe pas Tiranës qe kthyer në Shkup, mirëpo një kohë të gjatë e kalonte në vendlindje. Pikërisht në ato vite, bashkë me disa nga kolegët e Fakultetit po ktheheshim gjysmëilegalisht nga Tirana dhe vendosëm ta vizitonim Aliun. Po e përmend menjëherë dhe të parën shtëpinë, për arsye se në podrumin e saj dhe në dollapët e tjerë të shtëpisë, që edhe për ditët e sotme të krijon një imazh të një fortese të vogël, ndërtuar prej gurit të gdhendur, me hapësira të mëdha brenda dhe me shkallët që shpion në hajatat e gjera të katit të dytë, ku përkundër braktisjes së gjatë e kthimit të herëpashershëm, përveç verës së vjetër që gjendej asokohe në podrumet e saj, qenë ruajtur edhe libra të bibliotekës së prindit të tij, libra si ata të Naim Frashërit, botimi i parë i librave të shenjtë për bektashinjtë, *Luletë e verësë e Fletore e Bektashinjet*, *Qerbelaja* etj. Në margjinat e tyre ruhej një shkrimi i hershëm i lexuesit të tyre, që nuk ishte i dorës së Aliut, sigurisht i denjë për leximet e kritikës gjenetike...

Vetë Aliu, në shkrimet e studimet e tij letrare, iu kthye Naim Frashërit dhe veprës së tij në shumë shkrime, në kohë të ndryshme dhe shpesh edhe me qasje të ndryshme, duke e kthyer këtë autor në një lloj boshti tematik, në vetë rrënjët e një druri letrar e artistik shqiptar, rreth të cilit mandej ka vendosur autorët të tjerë të rëndësishëm të letërsisë shqipe, të Rilindjes Kombëtare dhe të mëvonshëm, mbi idetë të cilëve shoqëria shqiptare në përgjithësi ka vendosur themelet e Pavarësisë së Shqipërisë më 1912 dhe që jo më pak janë të rëndësishëm edhe për pavarësinë e Kosovës, fituar më 1999. E kam fjalën për Jeronim de Radën, Andon Zako Çajupin, Ndre Mjedjen, Poradecin, Fan Nolin e Faik Konicën dhe dhjetëra e dhjetëra autorë të tjerë shqiptarë të para dhe pas Luftës së Dytë Botërore e deri në ditët e sotme: D. Agolli, I. Kadare, F. Arapi, P. Marko, J. Xoxa, Din Mehmeti, A. Shkreli, A. Podrimja, Xhevahir Spahiu, Luan Starova, Zija Çela, E. Basha, S. Hamiti etj., që do të gjejnë vend në shkrimet e këtij autori.

Jo një herë përgjatë gjysmë shekulli, Aliu ka denjuar të reagojë dhe t'i rikthehet veprës sime letrare dhe për këtë i jam thellësisht mirënjohës.

## VII

Ajo që është karakteristike për shkrimin e Aliut është se brenda një njësie ai përmbledh gjithësi vlerësimin historik e të kohës për një vepër letrare ose për një autor, mirëpo më tutje interesimi i tij kritik thellohet në pikat me interes për konceptin e tij poetik dhe në vazhdimësi është autor që problematizon dhe diskuton rezultatet e njohura dhe njëkohësisht hap dilema e shtron aspekte të pavërejtura nga të tjerët. Në këtë aspekt, ta zëmë, Aliu vetëm pjesërisht ecën në traditën dominuese të mendimit kritik për veprën e Naim Frashërit, në atë pjesë që e konsideron veprën e tij si kontribut i shquar në ndërtimin e vetëdijes nacionale shqiptare: *Istori' e Skanderbeut, Bagëti e bujqësia* dhe *Luletë e verësë* – kjo e fundit shpesh e cilësuar si kryevepër e këtij poeti. Por, natyra kurioze e Ali Aliut nuk e ka lejuar të qëndrojë vetëm në këtë qark veprash për të cilat tashmë janë mendimet disi të unifikuar dhe të kodifikura, pothuajse uniforme, dhe as të pajtohet me mendimin nënvlerësues e ndonjëherë edhe diskriminues ndaj pjesës tjetër të poezisë së Naim Frashërit: *Qerbelaja, Katër stinët*, pastaj *Ëndërrime* e sidomos me disa vlerësime kuturu për poemën e tij të veçantë *Bukuria*, sidomos pohimet dhe në përgjithësi vlerësimin e kritikut Rexhep Qosja.

Në shkrimet mbi vlerat që shfaqin këto vepra, Aliu është prijatar dhe një iniciues i rëndësishëm i ideve që në të ardhmen kanë për t'u diskutuar e rivlerësuar. Aliu e ka rikthyer me shkrimin e tij poemën *Bukuria* në kontekst të realitetit jetësor-poetik, diskutimin që më herët e kishte trajtuar shumë më tepër si poezi në të cilën dominon frymë *idealiste* dhe *joreale*, cilësime negative ideologjike, gjë që vetvetiu e ka përjashtuar këtë kryevepër të Naimit nga diskutimi e mendimi kritik në gjysmëshekullin e komunizmit në Shqipëri. Aliu është i pari që ka shprehur mendim ndryshe, duke e vlerësuar lart si krijim artistik e estetik të këtij autori dhe duke propozuar leximin e saj edhe në raport e kontekst të krijimeve të Naimit në turqisht, greqisht e persisht: *Bukuria*, *Dashuria*, e *Katër stinët*, për të hetuar e gjetur atje gjurmët e shenjat dhe trazimet e shpirtit naimian. Rivlerësime ose inicime të këtilla në shkrimet e Aliut mund të konstatohen edhe për autorë të tjerë, si ta zëmë për veprën e Migjenit, çështja e Mbinjeriut migjenian, ose edhe për autorë të tjerë, si Fatos Arapi ose Azem Shkreli etj.

## VIII

Manastirin më ka rënë ta përjetoj gjithashtu në shoqëri të Akademik Ali Aliut, pasi përfundoi lufta e shqiptarëve të Maqedonisë në fillim të viteve 2000, kur edhe ndodhi kremtimi jubilar i përvjetorit të Kongresit të Alfabetit si një datë përkujtimore dhe konstituens shpirtëror, që ka për të ndikuar në vetëdijen e tyre përgjithmonë dhe historikisht.

Manifestimi te Shtëpia e Alfabetit shqip tashmë është një manifestim i përvitshëm, ndër më të rëndësishmit për shqiptarët e Maqedonisë. Ajo ndërtesë e vjetër qytetare e Manastirit dhe ajo datë do të duhej të futeshin përgjithmonë në arealin e vendeve të shënuara për shqiptarët, jo vetëm të Maqedonisë, dhe të bëhet vend që duhet vizituar nga nxënësit e shkollave shqipe kudo që janë...

Fakti që ajo datë tashmë është në kalendarin e përvitshëm si një nga datat e shënuara edhe për shqiptarët e Maqedonisë, është edhe meritë e ideve kulturore e politike të Aliut, midis të cilave, padyshim, që *ideja e gjuhës shqipe* si konstituens dhe formues i qëndrueshëm i esencës kombëtare shqiptare është ndër çështjet themelore dhe të përherëshme në shkrimet kritike të Ali Aliut. Këtë linjë studimi e gjejmë në të gjitha shkrimet për Naimin, gjuha e veprës së të cilit kritikut tonë i del gjuhë e jashtëzakonshme, për faktin se ai historikisht shfaqet menjëherë

pas *bejtegjijve*, por që në pikëpamje të asaj që Naimi shpreh në veprën e tij, përveç fushës së ideve krejtësisht të reja e të ndryshme nga ata, në pikëpamje gjuhësore paraqet një ndryshim të jashtëzakonshëm: poezia e Naim Frashërit ka kultivuar një gjuhë të themi të re shqipe, brenda së cilës ai vetë ka bërë pasurim të jashtëzakonshëm të saj, duke i dhënë fizionomi letrare një gjuhe deri atëherë pak të kultivuar, duke e ngritur në nivel të lartë stilistik dhe duke e pasuruar në leksik, në sintaksë dhe në mendim. Interesimin e këtillë ndaj gjuhës si pasuri nacionale dhe si shprehje e stil, Aliu e ka shfaqur në shumë shkrime dhe kjo linjë interesimi e vlerësimi në shkrimet e tij kritike mund të përcillet pastaj nëpër shumicën e autorëve të rëndësishëm të letërsisë shqipe: J. de Rada, Ndre Mjedja, Lasgush Poradeci, F. Noli etj.; element të cilin e ka hulumtuar e trajtuar edhe tek autorët e realizmit socialist, e nuk pushon së kërkuari në letërsinë e sotme. Prandaj e quaj si një stazë të shkrimeve kritike të Ali Aliut.

## IX

Në një mënyrë të bukur, të natyrshme, duke u mbështetur në *intuitën* e një kritiku të sprovuar në letërsi për një kohë të gjatë, Aliu ka shkëlur mirë dhe thellë në esencën e artit letrar: gjuha si fundament e konstituens i artit letrar; do të thotë, ka kaluar përmes *parimit ideologjik* në fushën e *parimit e estetik* të trajtimit të letërsisë, gjë që i jep rëndësi shumë më të madhe shkrimit të tij në përgjithësi.

Nuk ka asnjë dilemë që *intuita* e gjallë dhe frytdhënëse e përcjell shkrimin e këtij autori, ndoshta më shumë sesa zakonisht e shquajmë ndër autorët e tjerë të kritikës letrare shqipe, sigurisht kjo e mbështetur në përvojën e gjatë të leximit e të shkrimit kritik, por edhe e nxitur nga fakti që Ali Aliu shpesh është lexuesi i parë i një vepre letrare dhe po ashtu kritiku i parë që sprovon pendën prej kritiku fill pas botimit të veprave të ndryshme. Duke qenë i pari lexues kritik i një vepre, Aliu ndjek vetëm zërin e vet dhe, në këto raste, *intuita* shfaqet në aftësinë e këtij autori të zërë, të ‘kapë’ kompleksin e ndjesive, të njohurive artistike që një shkrimtar i ka manifestuar në një vepër letrare, të bëjë njohjen e ideve dhe domethëniet artistike të realizimeve në një vepër.

Tekstet kritike të Ali Aliut shpesh na japin atë domethënie e mesazh të veprës letrare që qëndron fshehur midis argumenteve të thëna në vepër dhe argumenteve të pathëna në vepër, por që një lexim i mirë duhet t’i zbulojë në mënyrën e vet, personale. Ma merr mendja që kjo

hapësirë, në të cilën vetëm *intuita* gjen deponinë e madhe të kuptimeve letrare, i jep mundësi lexuesit ta shohë kuptimin dhe vlerën e saj si vlerë personale.

Nëse një vlerë të tillë ‘pranimi’ ia atribuojmë lexuesit, për Aliun do të thosha që më shumë i përgjigjet ajo që e trajtonte Aristoteli si *dije konkluzive*, do të thotë e aftë për të nxjerrë përfundime në saje të zotërimit të aftësive për t’u mbështetur në disa fakte themelore, të cilat tek individit ndërtohen nga kombinimi i dijeve racionale dhe përshtypjet shqisore.

Nëse ndonjëri do të kërkonte një saktësim më të afërt, të më lejohet të them që autorin tonë, Aliun, ta zëmë, po ta vendosja figurativisht midis Dekartit e Kantit, do ta vendosja më afër me këtë të dytin, i cili i jep përparësi perceptimit shqisor, ashtu sikur ndonjëherë, kur flet për gjuhën e veprës letrare, mendimet e Aliut mund të ilustrohen me konceptin e Wittgenshtajnit mbi *objektet* dhe *shenjat*. Mirëpo, në mbyllje të këtij kapitulli, le të më lejohet ta parafrazoj Niçen, që thotë se *njeriu intuitiv* vuan më intensivisht, por edhe ruan gjakftohtësinë dhe dinjitetin vlerësues, sepse ka një ndjenjë të mirëkuptimit dhe shpesh veprën e veçantë letrare e sheh ashtu si do ta shohë dhe si dëshiron ta shohë...

## X

Dashurinë e pakufishme ndaj letërsisë, Ali Aliu e ka dëshmuar me dhjetëra e dhjetëra herë dhe sidomos me librat e autorëve të rinj, atyre që për herë të parë në jetën e tyre ia dalin që me përkushtim të kalojnë nëpër procesin e gjatë të krijimit të një vepre letrare dhe ta shohin dritën e botimit të saj dhe, me kureshtje e ndonjëherë edhe ankth, ta presin reagimin e parë të lexuesit – kritikut. Vlerësimi i tillë, shpesh i shfaqur në gazetatat e revistat letrare, ka qenë udhërrëfyesi i parë i leximeve dhe vlerësimeve të mëvonshme. Aftësia e leximit të këtyllë, të shpejtë dhe sistematik, të veprës së re të porsabotuar, është njëra ndër cilësitë e shquara të këtij autori dhe kjo vlen deri në ditët e sotme. Aliu është një lexues i madh i letërsisë shqipe kudo që krijohet ajo, e botuar në Prishtinë, në Tiranë apo në Shkup, ashtu si ka qenë një lexues i madh i letërsisë ballkanike dhe më gjerë, i letërsisë në përgjithësi, gjë që lehtësisht shihet nga gama e gjerë e librave për të cilët ka lënë gjurmë të shkruar në veprën e tij të gjerë e voluminoze kritike. Madje, do të shtoja, prej vitesh e vitesh, jam dëshmitar i faktit që ka një numër të madh autorësh, sidomos nga Tirana, që dorëshkrimet e tyre ia dërgojnë për vlerësim edhe para se t’ua japin botuesve të vet dhe, përveç kësaj, vlerësimi

i tij kritik i botuar në rubrikat e kulturës ose në mjete të tjera, është vlerësimi fundamental, ai që i jep vulën, dhe që përcakton leximet e mëtejme të veprës. Shikuar nga aspekti i këtillë i veprimtarisë kritike të Ali Aliut, mund të them që sot është më i gjeri dhe më gjithëpërfshirësi në arealin e shkrimit letrar shqip. Në një kuptim, të atij të shënimit të botimit të një libri të ri letrar, por shpesh edhe të kritikës e të shkencës letrare, Aliu ka herë e ka portretizuar veten në rolin e një kronisti letrar, sidomos në këtë kohë që është kundër shtypit ditor dhe shpesh është vështirë të mësohet lista e botimeve të reja në shqip.

## XI

Pavarësisht interesimeve të këtilla të gjera e gjithëpërfshirëse të letërsisë shqipe kudo që shkruhet, Ali Aliu, si njeri me përvojë të jashtëzakonshme letrare e të shkrimit të kritikës, ia ka dalë të skicojë e të punojë gjatë dhe qëndrueshëm në një projekt të cilin do ta veçoja si projektin më të qëndrueshëm e më të përpunuar të shkrimit të tij si studiu letërsie: Letërsia shqipe e vështruar në prizmin që ai e karakterizon si *donkishotizëm letrar*, një vëllim voluminoz i botuar për herë të parë rreth njëzet vjet më parë në Tiranë dhe i ribotuar me plotësime deri te varianti i fundit, që pret të botohet dhe që ka herë është edhe libër shkollor dhe do të thosha që është edhe një libër voluminoz.

Në konceptin e tij, libri përmban elemente të qarta e të rëndësishme kritike e historiografike shqipe dhe përfshin shumicën e autorëve të përzgjedhur shqiptarë, duke filluar nga Letërsia e Rilindjes e deri në ditët e sotme. Përzgjedhja dhe mënyra e trajtimit të këtyre autorëve në këtë vepër flet për një histori të fshehtë prapa saj, të menduar nga ana e autorit tonë. Nuk është një histori klasike e letërsisë, tekefundit çka është një histori letërsie sot?! Një kapriço për të ‘vendosur’ rend e hierarki vlerash letrare në mënyrë shkencore?! Apo funksioni i një historie të letërsisë është argëtimi i lexuesit? Ose një e tillë mund të përdoret për qëllime të edukimit, në shkolla? Vepra e Akademik Ali Aliut nuk mund të vendoset në një kategori të këtillë, megjithëse disa e kanë rekomanduar si vepër që mund të përdoret për nevoja të edukimit. Më duket, Aliu ka zgjedhur një mënyrë të veçantë për t’u shpëtuar kurtheve të një pretendimi të një historie të letërsisë që rendit argumente historike e shoqërore, me anë të së cilave përpiqet të shpjegojë funksionin e veprës së caktuar, ose të letërsisë; ose insiston në shpjegimin – interpretimin e asaj që autori ka dashur ta shprehë në veprën letrare. Dorë për një këndvështrim të veçantë ndaj veprave dhe autorëve të ndryshëm të letërsisë

i ka dhënë Fan Noli dhe parathënia e tij për *Don Kishotin* e M. Servantesit.

Disa teza kundërtënëse të tij dhe ideja e aventurës letrare, aventurës mendore e shpirtërore, i kanë dhënë dorë autorit të ndërmarrë inkursione kritike e teorike në hapësirat shpesh të paeksploruara të veprave letrare shqipe, pothuajse të shumicës së autorëve të shquar të saj. Kështu, do të shquhet aventura e Naimit me idetë e me gjuhën, aventura e Lasgushit me gjuhën e modernizimin dhe sidomos me evropianizimin e poezisë shqipe, aventura e Konicës me kritikën e letërsisë dhe kritikën shoqërore, donkishotizmi i Migjenit me idetë sociale e kombinimi me idetë e *Mbinjeriut*, donkishotizmi i Kadaresë në raport me diktaturën, ose idetë avangarde e sfiduese për pushtetin jugosllav dhe diktaturën komuniste në përgjithësi të autorëve të ndryshëm kosovarë si: Podrimja, Shkreli, Dedaj, Basha, Hamiti... Është një libër i shquar dhe i madh, në të cilin ky 'donkishotizëm' autorësh e veprash lidhet në varg e rrok aspekte të ndryshme të artit dhe rrëfen për aventurën e veprave të ndryshme dhe përfundimisht do të thosha flet për aventurën e shkrimtarisë kritike, por edhe shpirtërore të Ali Aliut: një *donkishot* brenda donkishotizmit të atit letrar...

Aliut i uroj jetë të gjatë, 101...!

Nysret Krasniqi

## ALI ALIU: LIRIKU I KRITIKËS

### 1. Biografema

Si pikënisje, falënderoj Akademik Sabri Hamitin, i cili e inicioi dhe e realizoi mbajtjen e kësaj Tryeze shkencore për veprën e Akademik Ali Aliut, në 90-vjetorin e lindjes, e në të cilën më dha mundësi të paraqitem me kumtesën time të stilit eseistik.

Ali Aliu (1934) lindi në Kranjë të Prespës në Maqedoni. Në vendlindje e nisi shkollimin fillor, të cilin e kreu në Manastir (1951). Kreu Shkollën Normale në Shkup (1955), ndërsa studimet për Albanologji i kreu në Universitetin e Beogradit (1960).

Nisi punën në redaksinë e gazetës *Flaka e vëllazërimit*, në të cilën për shtatë vjet ushtroi profesionin e gazetarit. Pastaj u bë redaktor në Redaksinë e Botimeve të *Rilindjes* në Prishtinë (1969-72) për të kaluar në botën akademike, në Fakultetin Filozofik (tash Filologjik) të Universitetit të Prishtinës, ku ligjëroi lëndën e *Teorisë së letërsisë*. Profesor e ndërkohë anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, si dhe anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë, Ali Aliu, deri më tash, ka botuar rreth njëzet vepra të kritikës letrare, librin normativ *Teoria e letërsisë* (1985), e tri antologji. Gjithashtu, hartoi tekste shkollore e përgatiti për botim opusin letrar të disa autorëve shqiptarë. Vepra e tij studimore e kulturore u nderua me çmimet më të larta nacionale dhe, një pjesë e saj, u përkthye në gjuhë të huaja.

### 2. Vlerësim

Ali Aliu është kritik letrar tradicional, i cili me veprën e tij studimore, të afilacionit teorik-hermeneutik, tashmë qëndron i lidhur, pashkëputshëm, me korpusin e letërsisë shqipe.

Vetëdija klasike se teksti letrar është krijim që sublimon ndjesinë dhe mendimin e autorit, ky i fundit, domosdo, i hedhur (pa dashjen e tij) në kohë e rrethana (mileun) historike, i ndikuar nga ndërndikimet

kulturore, ideologjike e letrare, e përcjell konceptacionin interpretues e studimor të Ali Aliut. Ky konceptacion na shtyn e na thërret që shkrimin kritik-hermeneutik të Ali Aliut ta vendosim në kohën e shfaqjes së tij, ta përcjellim dhe ta marrim si reflektim në kohën tonë. Pra, pa e pasur vetëdijen për kohën dhe për evolucionin kulturor e letrar shqiptar, krijimtaria e Ali Aliut mund të thjeshtëzohet e madje të moskuptohet.

Ali Aliu është kritik tradicional, i cili dialogon në kontinuitet me autorët e veprave të kohës së tij. Si rrjedhojë, kryesisht, nuk është studiuesi e rivlerësuesi i traditës letrare, por është interpretuesi e vlerësuesi i “shkrimit të gjallë letrar”. Këtij fakti, nëse pranohet si i tillë, i paraprin formimi i dijetar-utilitar i kritikut letrar Ali Aliu.

I vendosur në një kohë reale-historike në të cilën letërsia popullore ende e mbante fronin dominues, ndërsa letërsia e shkruar-autoriale (flas për produksionin letrar në Kosovë) sapo merrte trajtë libri, Ali Aliu zgjodhi të bëhej bashkudhëtar me librin e ri letrar. Do të thotë, një dashuri ideale, e ngjashme me mirësinë naimiane, për të kërkuar estetikën në librin e ri letrar, e përcjell gjithnjë konceptacionin interpretues e vlerësues të Ali Aliut. Pra, Ali Aliu, në bindjen time, mund të quhet *liriku i kritikës letrare shqiptare*.

Përveç kësaj, Ali Aliu nuk është kritik letrar statik, por dinamik, që do të thotë se procesi i tij vlerësues përcillet me aktivitetin promovues, dimension utilitar e kulturor që e bën të afërt me Esad Mekulin. Po ashtu, për aq sa evoluon shkrimi letrar, po aq evoluon edhe dinamika e vrojtimit të tij. Janë këto veçanti kulturore e shpirtërore të cilat Ali Aliun e nisnin në kërkimin e vlerës letrare me veprën *Kërkime* (1971), të cilat e përcjellin edhe sot. Ali Aliu është kërkuesi e lexuesi jetësor i librit të bukur e të ri letrar, i romanit të ri, i poezisë së re, i tregimit të ri, i vargut të ri, etj., qoftë ky i shkruar nga autori i formuar, apo nga shkrimtari juvenil. Kjo dëshmohet me faktin se shumica e autorëve të cilët i merr në shqyrtim janë më të rinj në moshë sesa studiuesi i tyre.

### 3. Komentim

Te vepra *Kërkime* (1971) Ali Aliu problematizon raportin e *letërsisë së re me traditën letrare*, ku thekson se artit të ri i duhet gnosisi i përgjithshëm nacional, si parakusht për ngritjen e tij në figuracion artistik. Shembull të mirë të këtij kapërcimi e sheh vargëzimin e Rrahman Dedajt, tek i cili heton metaforën e simbolin poetik përkundrejt figuracionit tradicional mimetik.

Mirëpo, vetëdija se procesi njohës (gnoseologjik) gjithnjë mbetet i dallueshëm nga procesi krijues, sidomos në krijimtarinë poetike, Ali Aliun e shtyn të diskutojë e ta theksojë *mrekullitaren* e vargut, pra formën e beftë e të mistershme të transponimit të kësaj njohjeje në strukturën poetike. Shenja të kësaj mjeshtërie si ikje nga ezopikja në vargjen te poezitë e Azem Shkrelit, Fahredin Gungës e Ali Podrimjes.

Kur përballet me konceptet e *angazhimit* e të *hermetizmit* në art, nocione këto që përplaseshin në vitet '70 në letërsinë e Kosovës, Ali Aliu sikur sugjeron ekuilibrin krijimtar: vëren se angazhimtaria e zbeh mrekullitaren poetike, mirëpo hermetizmi e pengon kënaqësinë e leximit. Kjo, një pikëpyetje që vijon edhe sot.

Ndërsa, kur letërsinë shqipe e përball me temat e stilet e letërsive të mëdha, Ali Aliu mbron konceptin se "letërsitë e vogla", por aktive mund të bëhen pjesë e kanonit botëror (në kuptimin që i dha Gëte), nëse do të arrinin ta kristalizonin gnosin e spiritin nacional në forma të ndërliqshme të figuracionit artistik. Model i këtij synimi bëhet depërtimi i prozës së Ismail Kadaresë në kulturën letrare evropiane, pikërisht nëpërmjet përfaqësimit të *koloritit vendës* me romanet *Gjenerali i ushtrisë së vdekur* dhe *Kështjella*, vepra të cilat Ali Aliu do t'i studiojë në *plan integral* në dy tekste të kërkimit të tij letrar në këtë vepër.

U rikthehet veprave në poezi, si diskutim i aktualitetit letrar, dhe vëren se Azem Shkreli reflekset poetike arrin t'i sintetizojë në poezi autentike si ringjallje e metaforave të vdekura, Fahredin Gunga e synon dhe e provon poezinë narrative që e formëson *simbolin*, Rahman Dedaj shihet si poeti më stilist i brezit, i cili kultivon *litotën* e kthimit në fëmijëri, pastaj veneron *apelativin* e kohës së kaluar te poezia e Din Mehmetit, si dhe poezinë e botës *krahasimtare* e të angazhuar të Ali Podrimjes, e cila i del si avancim i preokupimeve të mëparshme sociale të Esad Mekulit, por edhe kombinimin e simbolit me ironinë poetike te vepra e tij *Torzo*.

I rikthehet Azem Shkrelit për ta analizuar prozën e personazhit, me simbol Av (Dyl) Mehmetin, figurën e të cilit e analizon në tragjikën e *moskuptimit* të kohëve historike. Ali Aliu, Dylin e thyer të Azem Shkrelit e sheh të mundur nga *mosbesimi ndaj së resë*, pa i vënë faj e pa e akuzuar për bindjet e tij. Pra, Ali Aliu, konform konceptit të tij, të themi të pelegrinit letrar, përcjell e vlerëson autorët në rritën e tyre krijimtare estetike, duke e formësuar kështu atmosferën letrare të *brezitet* të *dytë* të shkrimtarëve në letërsinë shqipe të Kosovës.

Binjake me të parën, vepra vijuese *Shqyrtime* (1974) e Ali Aliut kap diskutimet e kohës për artin letrar, pra për dikotomitë krijuese sa i

përket të ashtuquajturit art *abstrakt* apo *konkret*, pastaj polemikat për vlerën e jovlerën artistike, poezinë e humusit vendës apo yshtjen moderniste mbas modeleve të jashtme, duke insistuar në konceptin se shkrimi letrar duhet të jetë shëmbëllim i jetës së njeriut, e jo synim i mohimit apo i abstragimit të vlerave të stabilizuara etike e morale. Pra, në planin e konceptcionit mendimtar, Ali Aliu parapëlqen funksionin utilitar të letërsisë (si humanizëm) dhe pandeh artistiken si reflektim të saj. Mirëpo, brezi i autorëve të rinj, të cilët po e thyenin bukurinë si stoli, thuajse e “mëson” kritikun letrar Ali Aliu se edhe “e shëmtuara” e ka (bukurinë) estetikën e saj. Dhe, në këtë krisje, Ali Aliu nuk mbetet statik, por vijon dinamikën e leximit pikërisht të veprave të autorëve që i njeh duke vënuar avancimin stilistik të shkrimit letrar të Musa Ramadani, Teki Dërvishi e Mirko Gashi, të cilët nisin dhe e individualizojnë shprehësinë poetike, pra unin e tyre e mbërthejnë në kontemplacione ekzistenciale.

Ali Aliu, ndonëse ruan botëkuptimet e tij për estetikën letrare, të themi të një *estetike mimetike* siç e dëshmon me studimin e veprës realiste të Petro Markos të studimi monografik *Koha dhe krijuesi* (1975), nuk ngulmon në një ide, por kërkon e dyshon, e gjithsesi merr në shqyrtim stilet e reja me vetëdijen se letërsia që nuk ndryshon vdes!

Me këtë vetëdije, te vepra *Rrjedhave të letërsisë* (1977), Ali Aliu, ndër të tjerash, pranon prozën parabolike e poezinë auto-refleksive të autorëve Anton Pashku, Rexhep Qosja, Eqrem Basha, Sabri Hamiti e Zejnullah Rrahmani. Do të thotë, Ali Aliu pranon ligjësitë e kapërcimeve stilistike, madje konceptuale, kur bëhet fjalë për autorë që tashmë trajtojnë krizën e individit, krizën e intelektualit e krizën identitare në një ambient politik e shoqëror, i cili prirej nga filozofia e përshtatjes doktrinare politike e nga përngjitja ideologjike. Madje, në këtë libër shkruan impresionet për poezinë e shkrirjes së emocionit dhe të mendimit të vepra *Thikë harrimi* e Sabri Hamitit, poezinë e ngjyrave të *nostalgjisë* të *Fluturojnë e bien* të Jusuf Gërvallës, prozën e refuzimit të censurës të *Vdekja më vjen prej syve* të tillë e Rexhep Qosjes etj, duke njohur po ashtu stilin minimalist e refleksiv poetik të Eqrem Bashës, stilin parabolik e temën identitare të Zejnullah Rrahmanit, e po ashtu veçaninë e prozës së ndërrijes tek Anton Pashku.

Në vijimësinë e refleksive letrare, Ali Aliu do të botojë edhe veprat e tjera kritike si *Kritika* (1980), *Artikuj kritikë* (1983), *Ese letrare* (1987), në të cilat interpreton e vlerëson vepra autorësh e po ashtu diskuton për fenomene kohore letrare, duke përcjellë procesin e evolucionit estetik.

Mirëpo, shquajmë veprën eseistike-studimore *Don Kishoti te shqiptarët* (1995), pikërisht për esenë “Don Kishoti te shqiptarët”, ku Ali Aliu mbron filozofinë estetike, si rrjedhje filozofike, të veprës së Servantesit. Pra, nëpërmjet saj mbron konceptin estetik të krejt fenomenit letërsi, duke vënë në krizë *Introduktën* reduksioniste të Fan S. Nolit, e cila pandehte se heroi i saj Don Kishoti është simboli i njeriut të marrës, i cili përpiqet ta rikthejë botën mbrapsht. Po ashtu, Ali Aliu mohon se vepra si e tillë identifikohet vetëm me ngulmimin e saj për të na bërë të qeshim. Ali Aliu, ndërkaq, mbron parimin estetik e polisemantik, duke besuar se thelbi i jetës së njeriut, si rrjedhje i shpresës për të jetuar, është *ëndërrimi donkishotesk*. Dhe ëndërrimi e mrekulltarja është bërthamë e shprehësisë letrare. Pra, Noli, për aq sa redukton, po aq tejinterpreteton, kur veprën e Servantesit, *Don Kishoti i Mançës*, më konkretisht heroin e saj, e shndërron në figurë rrezatuese të identifikueshme me figurat e politikës të kohës së përkthimit të saj. Për Ali Aliun, Don Kishoti nuk përbën simbol ideologjik, ngase spektri i tij i ndikimit mbetet tërësisht estetik, kur dihet se shprehësia letrare është botë e fantazisë e aventurës, madje ikje e përhershme nga ideologemat e realitetit e kredhje në imagjinatë.<sup>1</sup>

Si rrjedhje, duke mbrojtur parimin e kërkimit të së bukurës në artin letrar, veçanërisht në poezi, Ali Aliu do t'i vijojë kërkimet e tij në autorë e vepra të letërsisë bashkëkohore shqipe, duke qëndruar e bashkëjetuar me shprehësinë e autorëve të letërsisë sonë. Kjo kërkesë shpirtërore e shtyn të vijojë dialogimin *me autorë e vepra te Magjia e fjalës* (2003), vepër që sintetizon dialogimin letrar me autorët e letërsisë shqipe të zhvilluar edhe te vepra pararendëse *Reflektse letrare* (1999).

*Magjia e fjalës*, në kuptim të *literaritetit* të gjuhës apo të *estetikës së fshehur* (S. Hamiti) në poezi, prozë e dramë, do të kërkohet si shëmbëllim spiritualiteti përballë autorëve shqiptarë nëpërmjet konceptit vlerësues–estetik, të themi antologjist:<sup>2</sup> *Me Naim Frashërin, Me Azem*

<sup>1</sup> Ky koncept, pra i risematizimit të simbolikës së Don Kishotit në botën letrare shqipe, në kuptim të afirmacionit të këtij simboli si esencë filozofike të letërsisë, Ali Aliut do t'i bëhet figurë e titull sublimues edhe për vepra të tjera në fushë të kritikës letrare të botuara në variacione në kohë të ndryshme, për autorë e vepra letrare në Kosovë, Maqedoni të Veriut e në Shqipëri, me titujt alternues si vijon: *Don Kishoti te shqiptarët*, ASHAK, Prishtinë, 2005 dhe *Don Kishoti shqiptar*, Toena, Tiranë, 2010. Pra, duke e ruajtur konceptin si figurë, Ali Aliu gjithnjë rri në kërkim të *donkishotizmit* si magjikë e jetës të përthyer në letërsi.

<sup>2</sup> Ali Aliu, lexues dhe vlerësues i pasionuar i poezisë shqipe, ka përpiluar edhe antologjitë: *Antologji e poezisë shqipe*, Klubi letrar-94, Tetovë, 2000, *Antologji e poezisë shqipe* (ribotim i plotësuar), Albin, Tiranë, 2002, *Kush do ta vrasë ujkun*

*Shkrelin, Me Fatos Arapin, Me Ali Podrimjen, Me Xhevahir Spahiun, Me Mihal Hanxharin, Me Dritëro Agollin, Me Luan Starovën, Me Visar Zhitin, Me Eqrem Bashën, Me Kim Mehmetin, Me Sabri Hamitin, Me Mehmet Krajën, Me Lindita Ahmetin.*

Për Ali Aliun nuk ka *vdekje të autorit* (Roland Barthes), madje autori si krijues, për të, qëndron në fronin e *autoritetit* sa i përket krijimit të tij letrar me synimin që emri i tij të bëhet një yll i plejadës estetike letrare shqipe.

Ndër të tjerash, do ta venerojë *uratën poetike* të Naim Frashërit, *dëshpërimin poetik* të Azem Shkrelit, *revoltën poetike* të Fatos Arapit, *historizmin poetik* të Ali Podrimjes, *paradoksin poetik* të Xhevahir Spahiut, *melankolinë poetike* të Mihal Hanxharit, *kritikën poetike* të Dritëro Agollit, *intertekstualitetin e prozës* së Luan Starovës, *okazionalen poetike* të Visar Zhitit, *litotën poetike* të Eqrem Bashës, *dramatikën poetike* të Sabri Hamitit, *nostalgjinë e prozës* së Mehmet Krajës, si dhe *imazhet poetike* të Lindita Ahmetit.

Ky *dialogim* që kalon nga impresioni, interpretimi e vlerësimi për refleksionet artistike të këtyre autorëve, i cili kap qoftë një poezi, një tregim, një roman a dramë, bëhet si ridëshmi e venerimeve të mëher-shme, madje si përngjitje ndaj mendimeve të stabilizuara, pra si konkluzë për etablimin e veprave të këtyre autorëve në teatrin e magjisë së fjalës moderne letrare shqipe. Për Ali Aliun, bota letrare shqipe ruan gjallërinë stilistike e tematike dhe, përveç avancimit poliformal, kap edhe avancimin polisemantik. Pra, për Ali Aliun, letërsia shqipe ofron kënaqësinë e leximit, gjithsesi nëse kjo e fundit ndërlihet me kërkimin e saj specifik nga lexuesi shqiptar dhe i huaj.<sup>3</sup>

Dhe koncepti i ridëshmisë do të marrë trajtën e titullit të veprës vijuese *Dëshmi letrare* (2008), ku Ali Aliun e shohim të njëjtë, sa i përket mahnitjes letrare, mrekullitares e kureshtjes leximtare. Domosdo do ta mahnitë Ismail Kadare, i cili nëpërmjet tematikës nacionale arrin pranimin estetik ndërkombëtar. Po ashtu, do ta mahnitë spektri i ndikimit të Skënderbeut në heroikën kombëtare, por edhe në kategoritë e humanizmit, ky i fundit i parë si imanencë e ndjenjës për liri. Do të ruajë kureshtjen leximtare për rebelizmin poetik të Sabri Hamitit, epizmin

(zgjedhje dhe analizë e poezisë së Ali Podrimjes, Albas, Tiranë & Prishtinë, 2022 dhe librin instruktiv e interpretues *Si ta lexojmë poezinë?*, Albas, Tiranë, 2004.

<sup>3</sup> Një variant i plotësuar i kërkimit të *magjisë së fjalës*, por tashmë me koncentrim vetëm në hetimin e refleksive të poezisë shqipe, botohet si libër binjak me veprën *Magjia e fjalës*, me titull *Shtegtim metafore – shkrime kritike për poezinë shqipe*, Toena, Tiranë, 2006.

romanësor të Mehmet Krajës, paradoksin e përhershëm letrar të Kim Mehmetit, interkulturalitetin ballkanik të Luan Starovës, melankolinë e Rrahman Dedajt etj., duke përplotësuar kështu galerinë e autorëve dhe të veprave të nisura në kërkimin e tij jetësor–studimor qysh te vepra *Kërkime* (1971).

Po ashtu, koncepti i tij i *donkishotizmit*, i kërkimit të mistereve të artit, qoftë edhe me vetëdijen e vetëshkatërrimit emocional autorial, do të riaktualizohet te vepra vijuese *Kënaqësia e leximit* (2012). E kërkon në vijimësi mrekullitaren tek autorët e dashur, tashmë me traditë interpretimi nga ana e tij, siç janë: Dritëro Agolli, Zija Çela, Kim Mehmeti, Eqrem Basha etj., ku empiria e ditunia e kritikut letrar Ali Aliu kombinohen për të dhënë tekste *mini-monografike* si karakterizime për stilistikën e poetikën autoriale. Donkishotizmi i këtyre autorëve, në prizmin e Ali Aliut, kap figurën e reales (Agolli), figurën e magjikes e të kritikës (Zija Çela) e figurën e pamundësisë njerëzore (Eqrem Basha) si përzgjedhje e transformimeve brenda-poetike, të cilat autorit i ofrojnë laru-shi poetike, por edhe aromë luleje si *antropoetikë*, në kuptimin e një kërkimi universal të dashurisë, i cili, si filozofi e shpirtit udhëtar, prapë rikthen te Naim Frashëri!

Po ashtu, te vepra *Urtia e fjalës* (2018), e cila qysh në titull thekson utilitaren, Ali Aliu vetëm sa e zgjeron gamën e mini-monografive për autorët, tashmë të sprovuar e provuar në stilistikën e tyre autentike krijuese në kuadër të korpusit letrar shqiptar. Në këtë sistematikë, ndër të tjerë, janë autorët: Azem Shkreli, Ali Podrimja, Zejnullah Rrahmani, Mehmet Kraja, vepra e të cilëve tashmë vrojtohet në ndërlidhje me kohën e maturisë apo të zenitit të tyre krijues. Nëse i ka përcjellë në inicime, Ali Aliu tashmë e vlerëson veprën e tyre në lakoren evolutive, të themi figurën autentike të Azem Shkrelit, figurën reaguese nëpërmjet simboleve etnike të Ali Podrimjes, figurën mistike në bashkëdyzim me autentiken shqiptare te Zejnullah Rrahmani e figurën e fatalitetit historik te Mehmet Kraja.

Ndërsa, vepra *Libri i jetës* (2020)<sup>4</sup> konceptohet si antologji e teksteve studimore e kritike nga më se 30 vepra studimore-kritike të autorit-kritik Ali Aliu, ku, ndër të tjera, radhiten 23 autorë nga Romantizmi deri te bashkëkohësia në formë të një *historie personale të letërsisë*. Pra, jeta e teksti letrar sublimohen në një rend kronologjik, i cili,

<sup>4</sup> Vepra *Libri i jetës* (2020) është përzgjedhje tekstesh nga Akademik Zejnullah Rrahmani, me rastin e 85–vjetorit të lindjes së Akademik Ali Aliut.

nëpërmjet përzgjedhjes së Zejnullah Rrahmanit, e jep *historinë letrare* të Ali Aliut.

#### 4. Dobia e kritikës së Ali Aliut

Mbas gjithë kësaj pune studimore të Ali Aliut (të cilën shkurtazi dhe me mungesa e paraqita si komentari) domosdo shtrihet çështja imamente e vlerësimit apo e theksimit të dobisë intelektuale, shkencore e kulturore të kritikës letrare të Ali Aliut. Në këtë udhë, vlerësoj se:

1. Kritika letrare e Ali Aliut e dëshmon autorin e saj si dashurues të kënaqësisë së leximit, fenomen ky që u zbeh në vazhdimësi pikërisht nga vllugu i jashtëzakonshëm i teorizimeve si *sisteme të relevancave* (Galim Tihanov) të ndryshme ideore evropëndimore, të cilat tashmë kanë nisur të zbehën dhe të kërkojnë rikthimin të “primitivja” letrare si kërkesë imanente e *kënaqësisë së leximit* (Tzvetan Todorov). Pra, leximi i tij mbeti gjenuin, i cili me gjithë fërkimet me ideologemat e lakuara nëpër kohë, në esencë, u lidh ngushtë me kërkimin e së mistershmes në verbin letrar, në një vrojtim të përherëshëm dashurues-mallëngjyes, pra *lirik*, të evolucionit letrar shqiptar.

2. Kritika letrare e Ali Aliut është kronika letrare-sociologjike e receptive e më se gjysmë shekulli të produksionit letrar shqiptar në trekëndëshin nacional Kosovë, Shqipëri e Maqedoni e Veriut, si larushi e refleksioneve, motiveve e temave të shprehësisë letrare të shekullit të modernitetit të letërsisë sonë.

3. Kritika letrare e Ali Aliut, ndoshta edhe pavërejtshëm, në studimet tona letrare, duke e ruajtur *biografinë* dhe *autoritetin e autorit*, sjell tipin e *Reader Response Criticism* (Kritikës së Reagimit të Lxuesit), e cila, siç dihet, gjithnjë ruan parimet themelore të leximit dhe të rikrijimit të kuptimeve me burimësi tekstin letrar. Ali Aliu, për aq sa heton etiken e estetikën e tekstit letrar, po aq komunikon dhe i jep *dome-thënie* botës letrare të autorëve të analizuar (Rolan Bart).

4. Kritika letrare e Ali Aliut është ndeshja e parë me tekstin letrar, në të shumtën e herëve të sapobotuar, si rrjedhojë autorë e vepra të letërsisë bashkëkohore nëpërmjet saj marrin receptimin e parë kritik, i cili çel udhë për studimet e mëvonshme të poetikës letrare. Pra, kritika letrare e Aliut ka karakter estetik e historik. Nuk mund të bëhen studime të vlerëshme letrare për “letërsinë e re shqipe” pa pranimin e *shtimungut* që e ofron kritika letrare e Ali Aliut.

5. Kritika letrare e Ali Aliut si opus kronologjik e monografik, nëse e pranojmë konceptin e Ernest Koliqit se formësimi i *historisë së letërsisë* kalon nëpërmjet interpretimeve të kritikës letrare dhe të studimeve monografike, domosdo do të bëhet burim themelor i kuptimit të gjallërisë dhe evolucionit të produksionit letrar, nga i cili kanonizohet strukturaliteti i historinë së letërsisë shqipe.

6. Kritika letrare e Ali Aliut është afirmative e integraliste, si rrjedhojë ruan karakterin e vetënjohjes estetike e kulturore nacionale. Ajo shpeshherë e pranon kureshtjen kërkimtare qoftë edhe për hir të po kësaj imanence të vetënjohjes, e cila, si pasojë e shtrëngesave politike e ideologjike, i ka munguar kulturës sonë nacionale. Domosdo në këto rrethana, si e tillë, ruan edhe karakter moralizues e didaktik. Pra, kritika letrare e Ali Aliut ruan mirësinë naimiane si jehonë neoromantike në kulturën tonë letrare.

7. Kritika letrare e Ali Aliut ridëshmon se, ndonëse bijë e letërsisë, ajo bëhet art i mendimit dhe i gjetjes së estetikës, fenomen që e kërkon edhe shkrimi letrar modern në trajtë krijimtare. Tipi i tillë i kritikës e relativizon kufirin ndërmjet krijimit dhe rikrijimit letrar. Prandaj, është inteligjent titullimi i kësaj Tryeze *Krijimtaria letrare e Ali Aliut* i vendosur nga akademik Sabri Hamiti.

8. Kritika letrare e Ali Aliut është *Një Vepër* dhe, për mendimin tim, duhet të botohet si e tillë, ngase titujt e deritashëm bibliografikë të saj, që nga *Kërkime* (1971) deri te *Libri i jetës* (2020), të vënë me modesti, sikur e thjeshtëzojnë ndërmarrjen jetësore leximtare e studimore të Ali Aliut. Kjo do ta bënte më të receptueshme botën e studimeve kritike të Ali Aliut për lexuesit e studiuesit e letërsisë shqipe.

9. Kritika letrare e Ali Aliut, si dashuri e përhershme me krijimtarinë letrare, vijon sikur para më se gjysmë shekulli dhe këtu po e përdor trepikëshin eliptik (...), të stilit shkrimor të Ali Aliut, si shenjë kontinuiteti...

## Libra të komentuar

- Ali Aliu: *Kërkime*, Rilindja, Prishtinë, 1971  
Ali Aliu: *Shqyrtime*, Rilindja, Prishtinë, 1974  
Ali Aliu: *Koha dhe krijuesi*, Rilindja, Prishtinë, 1975  
Ali Aliu: *Rrjedhave të letërsisë*, Rilindja, Prishtinë, 1977  
Ali Aliu: *Kritika*, Rilindja, Prishtinë, 1980  
Ali Aliu: *Artikuj kritikë*, Rilindja, Prishtinë, 1983  
Ali Aliu: *Ese letrare*, Rilindja, Prishtinë, 1987  
Ali Aliu: *Don Kishoti te shqiptarët*, Flaka, Shkup, 1995  
Ali Aliu: *Reflektse letrare*, Flaka, Shkup, 1999  
Ali Aliu: *Antologji e poezisë shqipe*, Klubi letrar-94, Tetovë, 2000  
Ali Aliu: *Antologji e poezisë shqipe* (ribotim i plotësuar), Albin, Tiranë, 2002  
Ali Aliu: *Kush do ta vrasë ujkun* (analizë e veprës së Ali Podrimjes), Albas, Tiranë, 2002  
Ali Aliu: *Magjia e fjalës*, Dukagjini, Pejë, 2003  
Ali Aliu: *Si ta lexojmë poezinë?*, Albas, Tiranë, 2004  
Ali Aliu: *Don Kishoti te shqiptarët*, ASHAK, Prishtinë, 2005  
Ali Aliu: *Shtegtim metafore*, Toena, Tiranë, 2006  
Ali Aliu: *Dëshmi letrare*, ASHAK, Prishtinë, 2008  
Ali Aliu: *Don Kishoti shqiptar*, Toena, Tiranë, 2010  
Ali Aliu: *Kënaqësia e leximit*, ASHAK, Prishtinë, 2012  
Ali Aliu: *Urtia e fjalës*, ASHAK, Prishtinë, 2018  
Ali Aliu: *Libri i jetës*, ASHAK, Prishtinë, 2020

Arian Leka

## E ARTA E POEZISË SHQIPE

Është i njohur tanimë përkushtimi i Ali Aliut si kritik i letërsisë në gjurmimin e *antologjikes* në letërsinë shqiptare. Mes kontributeve të tij të shumta si studiues, vend të veçantë zë *Gjysmëshekulli i artë – Antologji e poezisë shqipe*, një vepër që, bashkë me prurjet letrare, sjell përkufizime teorike dhe hulumtime, analizë të përmbajtjes dhe interpretime mbi poetikën e shqipes. *Antologjia* e hulumton praninë e estetikës si pjesë të gjuhës, shprehur në formën e saj më të lartë përmes poezisë, ku si zonë vëzhgimi është gjysma e dytë e shekullit të 20-të.

Përmbledhja shfaqet si praktikë e (ri)sjelljes së teksteve të autorëve të ndryshëm, mbi të cilët autoriteti i hartuesit ushtrohet përmes metodologjisë së ekspozimit të pjesës më të arrirë, sistematizuar simbas kriterit kronologjik e tematik të mirëpërcaktuar.

Autori u (ri)zbulon lexuesve hapësira të njohura letrare, duke i qëndruar larg pretendimit se *Antologjia* ndërthen poezinë shqipe si tërësi. Por, duke klasifikuar dhe veçuar lëndën, ai e përlligj *estetikën* si një konstante dhe *antologjiken* si përfaqësim të poezisë së shkruar në shqip. Në këtë vështrim, antologjia *Gjysmëshekulli i artë* nuk është realiteti poetik, por harta shpirtërore simbolike e tij.

Të gjitha këto elemente shoqërohen me theksime antropologjike kushtuar teksteve të zgjedhura, përmes së cilave Ali Aliu ndjek trajektoret e një bashkësie që, përtej dallimeve, ka të përbashkët gjuhën dhe traditën letrare, përmes së cilave ai mbron ekzistencën dhe identitetin e tij. Nëse duhet kërkuar një arsye për hartimin e *Antologjisë*, atë mund ta gjejmë në formulimin e përgjigjes se pse homogeniteti i një kulture poetike, si ai i poezisë shqipe, ngrihet përmbi veçimet dhe shkon përtej ndarjeve.

Teksa propozon një rend vlerash për poezinë e re të gjuhës shqipe, *Antologjia* mbart peshën e një manifesti letrar e kritik, që i mbivendos traditës letrare hierarkinë e modernitetit dhe që ka në thelb “ndërtimin e kombit përmes kulturës”. Në këtë marrëdhënie autori e vështron letërsinë shqipe si polisistem të një poetike, pjesët e së cilës, pavarësisht gjeografisë së kufijve, funksionojnë të ndërlidhura dhe që, në

kompleksitetin dhe ndërvarësinë mes sistemeve socio-kulturore, funksionon si rrjetëzim heterogjen i gjithanshëm dhe dinamik.<sup>1</sup>

Vepra ka strukturën, kriteret dhe rregullat e veta, prej së cilave burojnë sfidat e riorganizimit të një lënde të njohur poetike, e cila, përmes *Antologjisë*, hyn njëkohësisht në marrëdhënie me traditën dhe kulturën e bashkëkohësisë. Prej këtej autori zgjedh ta shndërrojë analizën e tij në instrument jo vetëm për estetikën e poezisë shqipe, por edhe për socialen dhe politiken e një etnosi. Nën këtë optikë, poetika e antologjikes mbetet mes tradicionales dhe novatores vendase, cilësuar si moderne, ku artisti dhe arti nuk ndahen nga realiteti socio-kulturor.

Është vetë autori ai që e çmitizon ngjyrimin fetar të *Antologjisë*, duke e mbajtur atë larg nga përfytyrimi si “libër i librave” të poezisë shqipe, duke qenë i vetëdijshëm se teorikisht, për shkak të teknikave të fragmentit, Bibla dhe Kurani konsiderohen gjithashtu antologji.<sup>2</sup>

Titulli i veprës – kronologjikisht i lidhur me bashkëkohoren dhe cilësisht me më të arrirën e saj – nuk e fsheh vështirësinë e akordimit të *Antologjisë* rreth një estetike të vetme, sikurse nuk mbulon as dallimet që kanë mes tyre poetët me etni të njëjtë, por me shqetësime të ndryshme.

Vlera e përfytyrimit të hartës së fjalës së një gjysmëshekulli qëndron në faktin se Ali Aliu veçon fenomenin kulturor në çastin kur hapësirën e tradicionales e zë novatorja apo “avantgarda” letrare vendase, si term relativ.

Në një rrafsh më të gjerë, tipari i avantgardës, si shfuqizuese modelesh, e afron poezinë shqipe me letërsinë europiane të shekullit të 20-të, duke e përfshirë këtë poetikë brenda gjesteve letrare të kontinentit. Jo të gjithën - të artën e saj - përfaqësuar nga poetët e saj të lindur dhe poetët e vet të mëdhenj, siç cilësohen nga Ali Aliu.

Pavarësisht se jo të përputhura në terminologji e në kohë dhe të pakoordinuara me lëvizjet e mëdha artistike të kontinentit, prania e novatores merr rolin e modernes, si institucion opozitar ndaj tradicionales në poezinë shqipe. Ajo shenjon pikën e kthesës, thyerjen radikale dhe kapërcimin drejt avantgardës konvencionale, sikurse vërehet në këtë *Antologji*.

<sup>1</sup> Shih: Itamar Even-Zohar, *Polysystem Studies*, in “Poetics Today”, International Journal for Theory and Analysis of Literature and Communication. Volume 11, number 1 (1990).

<sup>2</sup> C. H. Holman, *A Handbook to Literature*, “Odyssey Press”, Indianapolis, 1975, f. 31.

Sfida e hartuesit të *Antologjisë* ndeshet gjithashtu edhe me asimetritë kulturore, për shpjegimin e së cilave lipseshin çelësa të veçantë interpretativë, pasi tjetër domethënie kishte *Ardhmëria* e poetikës në Kosovë dhe tjetër kuptim mori e *Ardhmja* e realizmit socialist në Shqipëri.

Pjesë e asimetrisë bëhet edhe fakti se, brenda këtij gjysmëshekulli, një prirje e poezisë shqipe kishte punuar me simbolikën e ferrobetonit formal futurist dhe metaforat militare, ndërkohë që pjesa tjetër kishte përdorur hermetizmin, si speculum letrar, ku realitetet u veshën me alegori.

Prej këtej mund të vëzhgohet se pranë cilës perspektivë kritike rri më pranë *Gjysmëshekulli i artë*?

Nëse mbi poetët ka vepruar forca transformuese e kufijve territorialë, mbi autorin e *Antologjisë* është ushtruar forca e kufijve të zhanrit. Prej kësaj, hapësirës prej ku antologjia, si krijim ndërkufitar, vepron më lirshëm, i duhet vënë një emërtesë, për të shkuar përtej kundërvënies art/kulturë, qendër/periferi, e kodifikuar/jashtë kodeve, siç vetë autori shkon përtej mbledhësit, përzgjedhësit dhe kodifikuesit të tekstit letrar.

Por, janë vetë antologjitë, si kulturë e koleksionit, ato që takojnë një formë të veçantë të metalepsisë. Si koncept në historinë e poetikës, metalepsisi, nga pikëpamja e funksionit, lejon kalimin e kufirit ndarës mes autorit të *Antologjisë* dhe autorëve të teksteve poetike, për t' i vënë ata në marrëdhënie të shumëfishtë. Falë kësaj figure komplekse të transferimit të kuptimit, kufijtë shkelen, pasi transmetuesi i jashtëm, autori i *Antologjisë*, ndërhyt gjithashtu edhe mes lexuesit dhe autorëve të poezive, për t'u dekonstruktuar veprat e për të strukturuar një vepër të re prej pjesëve të tyre. Këto aspekte në dukje teknike, bëjnë të mundur që edhe antologjia *Gjysmëshekulli i artë* të jetë një mjet, akt dhe fakt letrar e shkencor ndërmjetës dhe ndërmjetësues njëkohësisht.

Tejkalimi i “kufirit të lëvizshëm, por të shenjtë, midis dy botëve narrative, botës në të cilën dikush tregon dhe botës për të cilën tregohet”<sup>3</sup> në këtë antologji bëhet për të propozuar një taksonomi, që merr shkas sa nga integriteti estetik dhe qëndrimi social i poetëve, aq edhe nga nevoja e brendshme e një poetike për t'u përfaqësuar simbolikisht përmes modeleve.

Ndërkaq, mbi poezitë e shkruara më herët dhe jo enkas për *Antologjinë*, vepron parimi i “ready made”, që i konsideron veprat e artit si

<sup>3</sup> Gérard Genette, *Narrative Discourse: An Essay in Method*. “Cornell University Press”, Ithaca, 1980, f. 236.

artefakte dhe tek “objekti artistik”, sheh jo thjesht shfaqjet, por përfaqësimet.<sup>4</sup>

Bëhet e dallueshme gjithashtu se antologjia *Gjysmëshekulli i artë* vepron si një ekspozitë ku “identiteti i vetvetes ndërtohet përmes artit”<sup>5</sup>, me qëllim “ndërtimin e kombit përmes kulturës”, siç është propozuar që herët prej Itamar Even-Zohar-it. Edhe pse autori i poezisë mbetet i njëjtë, edhe pse poezia është po ajo, objekti artistik ndryshon pasi elementi i gatshëm rikontekstualizohet. Artefakti letrar ofron një realitet të ri, që lexohet ndryshe në *Antologji*.

Falë statusit të “autorit të autorëve”, siç është Ali Aliu në këtë rast, krijimtaria e poetëve të zgjedhur shfaqet nën një dritë të re semiotike, ku vepra është e autorëve të përfshirë, po aq sa ç’është edhe e përzgjedhësit të *Antologjisë*.

Statusi i të qenit autor – brenda dhe njëkohësisht jashtë, krijues dhe rimodelues – lejon po ashtu edhe lexuesin të përjetojë simbiozën letrare të veprës së re, që dekonstruktin librat e poetëve, për të maksimalizuar përfaqësimet. Së këtejmi, nga formë e huazimit letrar, *Antologjia* e shndërron leximin e përzgjedhur në dialog epistemic, duke bërë që koncepti i kufirit të lëvizë drejt antologjisë si metazhanër, që u jep jetë të re krijimeve të vjetra, për t’i shndërruar në vlerë për historinë e shkrimit poetik.

\*

Përveç konceptimit të letërsisë si një polisistem, qëndrimin ndaj produktit “ready made”, metalepsis dhe përjetimit të simbiozës letrare, tipar tjetër dallues i antologjisë *Gjysmëshekulli i artë* është koncepti i multiterritorialitetit.

Termi nuk i referohet thjesht gjeografisë politike dhe fizike apo fakteve të perspektivës biografike në kritikën letrare. Zbulimet më të mëdha në *Antologji* nuk i takojnë territorit fizik<sup>6</sup>, por hapësirave letrare, ku autori, përmes bashkëkohores, i shërben pasurimit të hartës poetike, si hapësirë që nuk i përket thjesht “tokës amtare”, sikurse nuk i takon as “territorit tjetër”, por shqiptares dhe shqipes.

<sup>4</sup> Shih: Jerrold Levinson, *Artworks as Artifacts*, *Creations of the Mind: Theories of Artifacts and Their Representation*, “Oxford University Press”, New York, 2027, f. 74–82;

<sup>5</sup> Shih: Thomas Deane Tucker, *Derridada - Duchamp as Readymade Deconstruction (A Time for Deconstruction)*, “Lexington Books”, 2009.

<sup>6</sup> Michel Foucault, *Space, knowledge and power (The Foucault Effect)*, “Penguin, Harmondsworth”, 1991, fq. 239–256.

Po si duhet lexuar metafora e Ali Aliut mbi “gjysmëshekullin e artë”, të cilën ai e shndërron në një simbol kulturor, kur vetë *Poezia*, në përballje me *Kohën* nuk synon të artën dhe kur si të artë në letrat shqipe janë vështruar vitet '30 të shekullit të 20-të dhe jo prerja kohore pas gjysmës së dytë të këtij shekulli, propozuar nga *Antologjia*?

Për të përmbushur tejkalimin e territorit fizik dhe zëvendësimin e tij me hartën poetike, autorit të antologjisë i është dashur të pajtojë dy profesione, që jo rrallë kanë qenë pranë letërsisë: i është dashur të jetë njëherazi astronom dhe astrolog, që ka pranuar përgjegjësinë e vëzhgimit të hapësirës, ku jo vetëm i duhet të zbulojë çdo yll, por edhe të interpretojë fatin e tij.

*Antologjia Gjysmëshekulli i artë* nuk ngjason me ndonjë mision shpëtimi, që u vjen në ndihmë të mbijetuarve të sfidave “nga më vendimtarët për ekzistencën e kombit”, siç shprehet Ali Aliu. Ajo propozon hierarki, por nuk merr përsipër të kryejë elitizim brenda poetikës së shqipes. As ngulmimi për themelimin e një republike letrare me të zgjedhurit nuk synon përfaqësimin e një “Arbërie poetike”, shpërndarë nëpër “koine”. *Antologjia* e percepton si tërësi poezinë shqipe, dialektet e së njëjtës gjuhë sinkretizohen, duke e dhënë të plotë territorin, por duke lënë të lirë veçimet estetike dhe stilistikore të autorëve.

Mes letërsive të zhvilluara në territore dhe kushte të ndryshme, të cilat merren në shqyrtim shumëdisiplinar në këtë *Antologji*, autori nuk vëren kundërshti, por dallime, dinamikë, relieve, tematikë dhe peizazhe të ndryshme. Edhe pse, në librat e tyre të veçantë, autorët u janë drejtuar audiencave të ndryshme, organizimi i lëndës brenda *Antologjisë* shfaq kodet e deshifruara të kumtit poetik, ardhur përmes teksteve ndërmjetësuese me vlerë epiteksti apo periteksti, që, “më shumë se një kufi apo kufi i mbyllur... është një prag ndërlidhës.”<sup>7</sup> Këto ndërhyrje unifikuese kufi/prag, sikurse shprehet Philippe Lejeune, në të vërtetë “kontrollojnë gjithë leximin e tekstit” dhe e shoqërojnë lexuesin me interpretime të rrafshit estetik e social. Në ndërthurjen mes autorëve që përfaqësojnë traditën moderne dhe bashkëkohësinë, shtresëzimet kohore, që përfaqësojnë prozodinë homogjene, brenda heterogjenitetit të një letërsie, janë të lexueshme qartësisht.

\*

<sup>7</sup> Gérard Genette, *Paratexts. Thresholds of Interpretation*. Cambridge University Press, Cambridge, 1997, fq. 1-2.

Mënyra se si ndërtojmë, qoftë edhe një antologji, përcakton marrëdhënien tonë jo vetëm me kujtimet dhe ndjeshmërinë, por me të harrueshmen dhe harresën. Ali Aliu e ka ditur që në krye të herës se, si çdo krijim njerëzor, ky *Florilegium* trashëgon diçka prej hartuesit: e bekuar nga kujtesa dhe e pambrojtur nga format e amnezisë. Ndaj, ai propozon estetikën si kriter të parë për antologjikën dhe përzgjedhjen e kujdesshme mes teksteve të “lirikave për kohën dramatike”.

Është estetika ajo që korrigjon pritshmëritë publike ndaj poetit profet dhe hero epik, siç është përfytyruar ai tradicionalisht. Në këtë aspekt, *Gjysmëshekulli i artë i poezisë shqipe* ofroi praktikën e leximit të lirikës me theksim reflektiv, duke e bërë referenciale këtë vepër dhe të ngjashmet që do të buronin prej saj, mes të tjerave edhe *Si ta lexojmë poezinë*.<sup>8</sup>

Një vetëdije e tillë ia sjell si zbulim lexuesit dëshpërimin për “lirinë skllave”, lavdinë e humbësve, përgjegjësinë e të qenit fajtor te Fatos Arapi, që na bën të kuptojmë se nuk do të jemi kurrë më të lirë dhe më njerëzorë se në çastet kur dashurojmë.

Është po kjo vetëdije që interpreton natën, vetminë, mallin dhe heshtjen metaforike të Azem Shkrelit, shoqëruar nga jehona e krismës pas shpine dhe e durimit të tij proverbial, që digjet si Ian Husi dhe si zjarret e fshehura në kujtesën e një poeti që i zgjedh me kujdes fjalët.

Njohja e fuqisë së mirazhit e qartëson përfytyrimin mbi Itakën e brendshme të Bardhyl Londos, mbi shpresën e tij dhe ëndrrën e rikthimit, edhe kur ky kthim duket më i pamundur se vetëvrasjet e perëndive, duke i bërë njerëzore zhgënjimin dhe lotin e kaltër të poetit mbi hartën lirike.

Mitet e fisit mbi hartën tragjike të “shqipërive” të shprishura të Ali Podrimjes, mbetojat e kujtimeve ndaj të cilëve shfaqet Kosova, Arbëria dhe bukuria e një gruaje me këmishën qëndisur nga gjuhët e flakës, së cilës i duhet t’i kursejë lotët për gëzimin e afërm, u bashkohen këndvështrimeve të mësipërme.

Përzgjedhja hedh dritë edhe mbi dorën krijuese të Xhevahir Spahiut, teksa poeti shkruan nxitimthi, duke ecur, për t’u ndalur diku, i vetmuar, në fund të natës, që rri si shpezët mbi gjithçka që kishte ngjyrë dhe u bë gri apo që u vrenjtësua si moti e u nxi si buka.

Gjithmonë në kërkim të së bukurës, si kategori, Ali Aliu ka vëzhguar se e arta e poezisë shqipe nuk është objekt arkivistik, sikurse nuk

<sup>8</sup> Shih: Ali Aliu, *Si ta lexojmë poezinë?*, Albas, Tetovë-Tiranë, 2004.

gjendet vetëm duke rrëmuar në kujtesë. Bashkëkohorja e ofron atë përmes vargjeve të Linditë Ahmetit, që sheh sy të vizatuar mbi letër, grafika acari mbi qelqin e ngrirë, fabulistikën me krushq e me nuse të magjepsura dhe gëzimin e fashitur.

Me shije zbulimi vijjnë në *Antologji* edhe lodhja prej ritualeve, frika vërshuese, drynat e harrimit dhe dilemat ekzistenciale në vargjet e Salajdin Saliut.<sup>9</sup>

\*

Ata që do të merren me sistemimin e veprës së shquar të Ali Aliut, do ta ndjejnë vështirësinë e përzgjedhjes mes prurjeve cilësore. Ndodh pasi kompleksiteti i një vepre të begatë duket se ka përmbushur, vit pas viti dhe me përkushtim detyre, të njëjtin mision: përgatitjen e një antologjie jetësore, shpërndarë në libra të veçantë, të cilët, me kalimin e kohës, zënë vend brenda një antologjie të madhe, një antologjie të antologjive, ku kontributet e Ali Aliut bashkohen për të përruar antologjiken në vetvete. Të tilla janë veprat: *Magjia e fjalës* (2003); *Fjalë për fjalën* (2008); *Kënaqësia e leximit* (2012); *Një lexim i poezisë* (2022), apo libri i hapur *Don Kishoti shqiptar*, në të cilat ruhen portretet tona, kujtesa e fjalës, e kodeve dhe e kohërave.

Opusi i gjerë i mendimit kritik që Ali Aliu ka sjellë në shumë dekada krijimtarie e bën të kuptueshëm këtë synim edhe pa i ekspozuar bujshëm vështirësitë, siç është në stilin dhe narrativën e tij. Nëse duhet doemos një arsye për këtë, mund të thuhet se fenomeni ngjet pasi peizazhet e teksteve të tij më të qenësishme dhe më domethënëse në studimet dhe kritikën letrare nuk ofrojnë rrafshina, por maja, prej të cilave vërehet ngulmimi i hershëm e i sotëm i përfaqësimit të një kulture jo me të pruarën, por me të artën.

---

<sup>9</sup> Për rastet e marra në shqyrtim, shih: Ali Aliu, *Antologji e poezisë shqipe*, “Klubi letrar – 94”, Tetovë, 2000 *Antologji e poezisë shqipe*, (ribotim i plotësuar), “Albin”, Tiranë, 2002.



Fatmir Sulejmani

## NJERIU, STUDIUESI DHE KRITIKU LETRAR ALI ALIU

### I. Njeriu dhe veprimtari Ali Aliu

Emrin e Akademik Ali Aliut e kam hasur fillimisht në librat e leximit për klasat e larta të shkollës fillore, të cilët do të doja të jenë edhe në çantën e nipit tim. E them këtë, sepse nga vitet '80 e këndej, nxënësit shqiptarë në RMV nuk kanë pasur tekste më cilësore për nxënien e letërsisë, se ato të profesor Aliut.

Më vonë nisa t'i lexoja librat e tij me studime dhe kritika letrare, kurse nga fillimi i viteve '90, kur, për shkaqe të njohura, Tetova u bë qyteti ku organizoheshin aktivitete të nduarnduarshme kulturore, me pjesëmarrje letrarësh, gjuhëtarësh dhe shkencëtarësh të shquar të mbarë viseve shqiptare, takimet e shpeshta me të na afruan dhe na bënë miq. Prej Profesorit kam marrë mësim shumë të vlefshme. Ai posedon virtyte të larta morale dhe ka prirje për të bërë punë të mira. Arma e tij është fuqia e fjalës dhe e bindjes.

Është njeri serioz, me qëndrime të forta parimore, që gjërat i merr në mënyrë të qetë dhe të shtruar. Është i ditur, i vyer, i matur, i urtë, i qetë, shpirtgjerë dhe sillet mirë me të gjithë. Nuk ngacmon, nuk sjell ngatërresa dhe nuk i bie në qafë askujt. Prej tij nuk kam dëgjuar kurrë ndonjë fjalë të ligë për dikë. Këtë nuk e bën as për ata që e ndoqën si hije me vite të tëra, sepse e di se kë gjuajnë vetëtimat. Ai nuk flet prapa shpinës së askujt, nuk gënjen, nuk përgojon, nuk shan dhe nuk e njeh gjuhën kërcënuese, shpifëse dhe shantazhuese.

Është personaliteti më i palodhshëm që njoh, lexuesi më i pasionuar i letërsisë, prezent në çdo aktivitet të rëndësishëm kulturor, gjithandej ku flitet dhe shkruhet shqip. Ai është studiuesi dhe kritik i qetë që ka shkruar mijëra faqe librash të veçantë dhe të kërkuar nga libërdashësit. Jo rastësisht, emri i Tij gëzon autoritet si njeri, pedagog, shkrimtar, studiues, kritik dhe veprimtar.

\*

Ali Aliu u bë i njohur gjatë viteve të terrorit rankoviqian, kur punonte në Shkup si gazetar në *Flakën e vëllazërimit*, dhe ishte

vazhdimisht nën survejimin e agjentëve të UDB-së. Autoriteti i tij u rrit shumë në vitin 1967, pas serisë së shkrimeve me titull “*Tetova shikuar nga afër*”, me të cilat theu heshtjen kronike për padrejtësitë e parisë shoviniste maqedonase ndaj shqiptarëve. Aliut i mjaftuan vetëm 4 shkrime fejtunistike për t’u dhënë zjarrin shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut, me të cilin i zgjoi nga gjumi dhe ua bëri me dije sa është ora dhe për kë bien kambanat. Shkrimet në fjalë shkundën rehatinë e pushtetarëve dhe u konsideruan si nxitëse të demonstratave, që shpërthyen më 1968 në Tetovë e gjetiu. Ato u bënë objekt analizash nëpër komitete qendrore dhe nëpër strofulla spiunësh, të cilët në eliminimin e tij nga skena e jetës shoqërore e kulturore shihnin rastin e avancimit në karrierë.

Në vitet ‘80, pushteti maqedonas, bashkë me lakenjtë shqipfolës, hoqi nga përdorimi tekstet shkollore, antologjitë dhe veprat e tjera të Profesor Aliut. Ishte kjo koha kur me udhëzimet e politikës lokale e qendrore, u sekuestruan librat e bibliotekave të shkollave shqipe dhe u burgosën në bodrumet e ndërtesave shtetërore, gjersa u kalbën e u bënë të papërdorshme.

Kur përndjekja u bë e padurueshme, Profesori, njësoj si disa intelektualë të tjerë, erdhi në Kosovë, ku, nga viti 1974-1981, jeta frymonte pak më lirshëm se në Maqedoninë e Veriut, që asokohe u bë poligoni ku matej durimi i shqiptarëve dhe ku, që në vitet e tetëdhjeta, u ndërpre gati në tërësi shkollimi i mesëm në gjuhën shqipe, me të ashtuquajturat “paralele të përziera”.

Në ambientin e ri dhe pak më të kulturuar shoqëror, Profesor Aliu i dha sa mundi gazetarisë, arsimit, letërsisë dhe artit shqiptar, sidomos kritikës dhe studimeve letrare. Edhe pas rrënimit të autonomisë së Kosovës, shkeljes brutale të të drejtave të njeriut dhe përjashtimit masiv nga puna të shqiptarëve, përfshirë këtu edhe punonjësit e arsimit, shkençës, kulturës, medias..., Profesor Aliu ishte aty ku duhej. Ai nuk ndenji mënjane duke bërë sehir terrorin serb ndaj studentëve, profesorëve, gazetarëve dhe intelektualëve, por u solidarizua me ta dhe kontribuoi në përpjekjet për gjetjen e mënyrave për të mbajtur gjallë shpresën për ditë më të bardha.

Po përmend me këtë rast në mënyrë telegrafike vetëm disa prej pjesëmarrjeve të Profesorit të shquar në veprimtari të rëndësishme shoqërore:

Ali Aliu është njëri prej themeluesve të LDK-së (1989) dhe anëtar i Kryesisë së saj në dy mandate. Ai mori mbi vete detyrën për themelimin e degëve të LDK-së në diasporën e madhe shqiptare.

Pas mbylljes së shkollave shqipe dhe Universitetit të Prishtinës, bashkë me kolegët e tjerë, ligjëroi nëpër shtëpitë private.

Në vitin 1991, iu besua detyra e rrezikshme e drejtuesit të Zyrës së Kosovës në Tiranë, që ishte e një rëndësie tejet të veçantë për çlirimin e popullit nga thundra serbe.

Gjatë tërë kësaj kohe, UDB-ja e ndoqi këmba-këmbës, duke ia riaktivizuar edhe “mëkatet” e viteve ‘60 për shkrimet e lartpërmendura në gazetën *Flaka e vëllazërimit*.

Paralelisht me aktivitetet e shumta që bëri në Kosovë, Shqipëri dhe diasporë, Profesori ndihmoi edhe shqiptarët e Maqedonisë së Veriut në sferën e kulturës. Në vitin 1995, në rrethana shumë të vështira, themeloi Shoqatën e Shkrimtarëve Shqiptarë në Maqedoni, që në fakt ishte institucion paralel letërsie dhe arti, i ngritur në këmbë për ta shpënë udhëve të mbara krijimtarinë modeste të këtij krahu. Gjatë mandatit dyvjeçar si kryetar i SHSHSHM-së (1995 -1997), Profesori organizoi dy festivale brilante poetike të “Ditëve të Naimit”, aktivitetit bazë të saj.

Bëmat në fjalë portretojnë më së miri personalitetin poliedrik të Profesor Aliut, veprimtarit me kontribute konkrete në shumë fusha të jetës shoqërore, politike, arsimore, shkencore, letrare dhe artistike, të cilin nuk e ka dëgjuar kush të lëvdohet për këto gjëra.

## II. Studiuesi, kritiku dhe shkrimtari Ali Aliu

Akademik Ali Aliu është njëri ndër personalitetet më të shquara të kulturës dhe letërsisë shqipe, i pranishëm, i dashur dhe i nderuar në gjithë Shqipërinë. Opusi krijues i tij është shumë i gjerë dhe përfshin vepra të shumëllojshme: studime monografike, kritika, ese letrare, teori letërsie, antologji të poezisë shqipe, tekste për shkollat fillore dhe të mesme, artikuj mbi artin letrar dhe kulturën në përgjithësi, shkrime publicistike, polemika, përkthime...

Në epiqendrën e krijimtarisë së akademikut janë kritika dhe studimet letrare, kurse specialiteti i tij i ngushtë lidhet me poezinë refleksive të letërsisë bashkëkohore, që, siç shprehet vetë: *Është përplot shqetësim për fatet e qenies kolektive, për rrjedhat politike dhe moralin e kohës sonë..., poezi që s’është krejtësisht e hapur e që kërkon një mbathje teorike për të vënë kontakt normal me të.*

Profesionalizmin në këto fusha, Ali Aliu e ka dëshmuar qëmoti. Jo rastësisht, shkrimet korrekte dhe opinionin e mirë publik për to, kanë afirmuar veprat e arrira të shumë krijuesve dhe kanë ndikuar në gjetjen e vendeve të merituar në shkallët e hierarkisë së vlerave. Ai ka bërë shumë për kulturën shqiptare, në veçanti për artin letrar. Ka ndjekur në vazhdimësi krijuesit e mirëfilltë, duke vënë në pah vlerat e veprave të tyre. Si rrallëkush, ua ka zgjatur dorën edhe talentëve të rinj, duke i lëvdur për arritjet dhe njëkohësisht duke ua tërhequr vërejtjen për mangësitë që duhet t'i tejkalojnë. Për shkak të këtij përcaktimi dhe parimeve të shëndosha që nuk durojnë kompromise, është ballafaquar shpesh me zemëratën e mediokriteteve të cilëve nuk ua var veshin, i vetëdijshëm se, në vendet vogla, ku secili njihet secilin, kritiku letrar i paguan tagra të rëndë profesionit.

Në vështrimet kritike, ai ndalet në aspektet më të rëndësishme dhe të veçanta të veprave, në detajet që hedhin dritë mbi të tërën dhe nxjerrin në pah atë që është thelbësore në planin social, jetësor, njerëzor dhe veçmas në planin artistik. Këtë e arrin në saje të analizave filigraniste, qasjes serioze ndaj veprave të lexuara nga gjethet e rrënjët, zhytjes së thellë në shtresat e nëntëshme dhe në të pathënat e autorëve. Njohuritë e thella, të plota dhe të përpikta për letërsinë, i japin siguri t'u ofrojë libërdashësve mundësi të reja leximi, pa ua cenuar mënyrat e leximit të tyre, sepse një vepër arti komunikon me lexuesit në versione të pafundme.

Studiuesi dhe kritiku Ali Aliu në asnjë rast nuk e ka vënë shenjën e barazimit midis veprës dhe krijuesit, pavarësisht autoritetit të kujt do qoftë, të fituar në luftë, në politikë, në biznes apo në fusha të tjera pa ndonjë lidhje me artin letrar. Ai është sfidanti i ndikimeve politike dhe ideologjike në letërsi. Në saje të këtyre qëndrimeve nuk e bëri kurrë model krijuesi mediokritetin dhe nuk e ndihmoi me asnjë gjykim të vetëm akulturimin e shqiptarëve, nëpërmjet paçavureve të pavlera, që veçmas gjatë viteve '90 të shekullit të kaluar, stërkeqën shijen edhe ashtu modeste ndër ne.

Kujdes të veçantë ka treguar edhe për shqipen estetike. Prandaj, edhe në aspektin gjuhësor, analizat e tij janë ndër më korrektet. Ai e njihet mirë fuqinë e gjuhës, ndaj zgjedh fjalorin që i përshtatet subjektit të cilit ia dedikon. Gjatë përgatitjes së kësaj kumtese, duke shfletuar një vepër të hershme me kritika, më ra në sy gjuha me të cilën kishte shkruar për veprën e një autori me shumë libra, por me pak letërsi brenda tyre. Si në shumë raste të tjera, edhe në rastin që po marr si shembull, Profesori ka shmangur gjuhën e përçmimit dhe identifikimit të autorit

me veprën. Po i citoj dy-tri fjali, pa e përmendur emrin e autorit të veprës: *Është poezia më e pazhurmshme në këtë pjesë të letërsisë së sotme shqiptare... Ajo, njësoj si në fillim, edhe sot sikur nuk e 'pengon' askë... Duhet të pranoj se përshtypja ime e hershme, e krijuar mbase kalimthi lidhur me këtë veprë, akoma nuk ka pësuar ndryshime të dukshme.*

\*

Ali Aliu është autor i shumë veprave të arrira, por ajo që kërkohet dhe lexohet më shumë në ditët tona është *"Don Kishoti shqiptar"*, për të cilën kanë thënë e kanë shkruar fjalë miradije personalitete dhe specialistë të shquar të studimeve letrare shqiptare dhe jo vetëm. Ata e konsiderojnë me të drejtë: *një histori ndryshe të letërsisë shqipe*, veprë të rrallë dhe me shumë tipare të veçanta në krahasim me studimet e tjera. Ajo është përkthyer në gjuhën angleze, atë bullgare e atë maqedonase. Është ribotuar disa herë, në Kosovë, Shqipëri e Maqedoni, dhe çdoherë është pasuruar me studime monografike veprash të reja të autorëve të shquar, të pashkruara më parë në letërsinë tonë. Botimi i fundit nga Shtëpia Botuese *Toena*, Tiranë, me mbi 900 faqe, trajton në mënyrë të hollësishme çështje të veçanta të veprave të tetëmbëdhjetë autorëve, si: Jeronim de Rada, Naim Frashëri, Faik Konica, Fan Noli, Lasgush Poradeci, Ismail Kadare, Dritëro Agolli, Fatos Arapi, Zija Çela, Ali Podrimja, Azem Shkreli, Xhevahir Spahiu, Luan Starova, Sabri Hamiti, Mehmet Kraja, Zejnullah Rrahmani, Kim Mehmeti. Për estetin e shquar, Alfred Uçin: *'Don Kishoti te shqiptarët' është veprë e shkëlqyer sintetike, që dëshmon aftësinë e autorit për të kombinuar idetë e klasikës me parimet moderne dhe për të arritur në zbulimin e shtresimeve të shumta semantike të kryeveprës së Servantesit*<sup>1</sup>.

Se për ç' veprë është fjala, e sqaron edhe vetë autori: *Don Kishoti është hero gati i çdo populli në botë. Pothuajse dhe gjithë autorët shqiptarë, të shpërndarë mes Ballkanit dhe Evropës, mes Bizantit dhe Romës, mes Ballkanit dhe Perandorisë Osmane, mes traditës dhe modernitetit, kishin mbetur peng të një 'donkishotizmi' specifik fare pak të njohur nga popujt e tjerë. Përpjekja për të bërë pak më shumë për historinë e tyre, duke besuar në mundësinë e pafund të imagjinatës dhe mundësitë polivalente, poliforme gjuhësore, prej këtyre autorëve do të krijojë 'donkishotistët' e papajtueshëm, të cilët në periudha të gjera e të gjata kohore do t'ia dorëzojnë stafetën 'donkisheske' njëri-tjetrit, duke*

<sup>1</sup> Ali Aliu, *Vepra të zgjedhura IV*, Serembe, Shkup, 2005, (Alfred Uçi: parathënia e veprës), f. 18.

*besuar se jetën e tyre e kishin lidhur për kauzën e madhe: mbrojtjen e identitetit gjuhësor të popullit të tyre*<sup>2</sup>.

Me këtë vepër atipike, Ali Aliu ka arritur kulmin e sukseseve si studiues dhe kritik letrar, duke ofruar një lexim të ri të letërsisë, leximin e bashkautorit të aftë, që me imagjinatën e tij plotëson shtresat më të përfundshme të veprave letrare.

Mbështetur në gjykimet e kompetentëve të fushës së letërsisë, në interesimin që tregojnë për librin lexuesit brenda dhe jashtë sinoreve shqiptare, mund të themi pa teprimin më të vogël, se *Don Kishoti shqiptar* do t'i rezistojë kohës dhe do të lexohet e rilexohet edhe nga brezat e ardhshëm.

Veprën në fjalë e lindën zbërthimet e të pathënave të Servantesit nga Ali Aliu, i cili në librin *Artikuj kritikë*, që në vitin 1983, shkroi se në figurën e heroit monumental të gjeniut spanjoll, gjeti burimin e shqetësimeve, ëndrrave, protestës dhe zhgënjimeve njerëzore. Sipas tij, shkas për ritakimet e shpeshta me Don Kishotin, është introdukta që shkroi Noli në vëllimin e parë të romanit të Servantesit, në të cilën e portretoi bashkë me sejmenin e tij Sanço Pançon.

Për Fan Nolin, *Don Kishoti: Është një fantazmë e ikur nga muzeu që shëtit në Spanjën moderne. Është anakronizmi ambulant. Është vizionari që nuk e sheh realitetin, po ëndërron me sy të hapur... Është utopisti reaksionar, që përpiqet të kthejë rrotën e historisë prapa*<sup>3</sup>.

Por, ndryshe prej gjithë studiuesve të tjerë, që te aventurat e Don Kishotit dhe Sanço Panços nuk panë asgjë përtej shpjegimeve të përkthyesit të veprës, Ali Aliu i lidhi ato me dramën personale dhe kolektive të Nolit dhe shqiptarëve. Sipas tij, mund të besohet se Nolit ose iu duk ose deshi që kundërshtari i tij Ahmet Zogu t'i përngajë Don Kishotit, sepse, shpjegon Profesori: *Asokohe ishte kërkesë e domosdoshme e aktualitetit, që, edhe Don Kishoti, edhe Sanço Pançoja të luajnë rolin e bejlurçinës dhe të laros që po pinin gjakun e popullit*<sup>4</sup>. Megjithatë, më në fund: *Noli pranon se Don Kishoti është idealist që shkrihet për t'i bërë mirë njerëzimit. Aventurat i ndërmer për të mirë të njerëzimit dhe për të mirën e vet*<sup>5</sup>.

Kjo përputhet me bindjen e Profesor Aliut, sipas të cilit: *Jeta e Don Kishotit, pasi të kemi dalë në fund të aventurës së tij, duket si*

<sup>2</sup> Ali Aliu, Po aty, f. 12.

<sup>3</sup> Ali Aliu, *Artikuj kritikë*, Rilindja, Prishtinë 1983, f. 239.

<sup>4</sup> Po aty, f. 242.

<sup>5</sup> Po aty, f. 243.

*bredhja e një idealisti altruist, që pasi ka vënë në shërbim dhe ka sprovuar tërë fuqinë dhe urtinë për ndreqjen e botës, kthehet prapë atje ku ka qenë dhe nga është nisur në fillim, plotësisht i kthjelltë dhe i vetëdijshëm për pamundësinë e vet definitive<sup>6</sup>.*

Kaq besoj mjafton për ta kuptuar se objekt i studimit atipik të Profesor Aliut janë copëzat e donkishotizmit, të cilat i zbulon në librat e ajkës së krijuesve shqiptarë, ashtu siç nuk i kanë gjurmuar të tjerët.

Ja disa shembuj të dhënë si citate apo parafrazime:

Jeronim De Rada besonte se këngët popullore arbëreshe ishin copëza të një poeme të lashtë dhe të ngjashme me eposet e Homerit<sup>7</sup>. Don Kishoti kalabrez synoi shpëtimin e gjuhës stërgjyshore nga harresa, sepse, për të, baza e të gjitha dijeve është gjuha, që mban gjallë identitetin e popullit<sup>8</sup>.

Naim Frashëri u përpoq t'u sjellë dritë shqiptarëve, me besimin se do të bëhet Shqipëria dhe do të zgjohen shpresat e bashkëvendësve për t'u çliruar nga diskontinuiteti i shekujve të humbur<sup>9</sup>.

Fan Noli u aktivizua në jetën shoqërore e politike në rrethana tejet dramatike, duke synuar pajtimin e kundërthënies të vjetra dhe evolimin e identitetit të shqiptarëve të shpërndarë në vendet e tjera ballkanike, që u takonin tri besimeve abrahamike<sup>10</sup>.

Faik Konica iu përkushtua si askush tjetër luftës për zhvillimin, begatimin dhe standarizimin e gjuhës shqipe. Për këtë qëllim u shpalli luftë gjuhëve artificiale, nëpërmjet esesë *Mbi gjuhët e natyrshme dhe të sendërgjuara*, dhe nëpërmjet shkrimeve të tjera eseistike e publicistike<sup>11</sup>.

Lasgush Poradeci nuk bëri kompromise me idealet poetike, duke jetuar si asket gjatë kohës së monizmit. Ai me qetësi e durim çante përtej harresës, përtej “vdekjes së shqiptuar”<sup>12</sup>.

Fatos Arapi, i zhgënjyer nga rrethanat në Ballkan, në vitet e nëntëdhjeta të shekullit të kaluar, priste me trishtim kohën e shqiptarëve, gjë

<sup>6</sup> Po aty, f. 247

<sup>7</sup> Ali Aliu, *Vepra të zgjedhura III*, Serembe, Shkup, 2005, f. 35.

<sup>8</sup> Po aty, f. 49-50.

<sup>9</sup> Po aty, f. 59-67.

<sup>10</sup> Po aty, f. 103-105.

<sup>11</sup> Po aty, f. 146.

<sup>12</sup> Po aty, f. 159.

që kuptohet nga fryma e poezive të asaj kohe, nga iluzionet poetike donkishoteske<sup>13</sup>.

Një studiues si Ali Aliu nuk mund të mos e gjente Don Kishotin edhe tek Ismail Kadareja, për të cilin thotë: *Edhe pse qëmoti e ka kaluar madhëstinë e çmimit Nobel, vazhdon gjithnjë si 'donkishot' i pandaluar, ta pasurojë dhe përsosë projektin e vet romanesk... Misioni donkishotesk dhe i paparashikueshëm i Kadaresë ka qenë prej kohësh dalja nga mbyllja dhe inercia e tij, nga izolimi, përkatësisht si të futet në sferat universale të jetës*<sup>14</sup>.

Hapin e parë donkishotesk, Azem Shkreli e bëri në bankat e normales, përmes kryeheroit të romanit *Karvani i bardhë*, Dyl Mehmetit. Për veprën në fjalë, Ali Aliu thotë: *Romani nuk arriti t'i japë udhë konfliktit të brendshëm tragjik të kohës dhe ambientit të botës shqiptare: si të ruhet profili pozitiv i Kryeheroit të romanit nga njëra anë dhe të anatemohet lufta e tij nga ana tjetër, para se të rezervohet simpatia e lexuesit, përkatësisht e autorit për të, dhe të sugjerohet, të nxitet, e kundërta ndaj luftës që bën Dyli*<sup>15</sup>.

Donkishoteske janë dhe asociacionet e Ali Podrimjes në raport me Kosovën dhe me ars-poetikën e vet. Don Kishoti vihet në kërkim të ars-poetikës së vet, në kërkim të botës së përsosur dhe harmonike, hendeqet dhe mullinjtë e së cilës, "legjionet armiqësore", dëshiron t'i mposhtë me shigjetën e vet. Jo rastësisht, në veprën eseistike *Ëndrra kallëzohet në mëngjes*, qëron hesapet me maskarenjtë e historisë më të re kosovare<sup>16</sup>.

Luan Starova është Don Kishot atipik, njësoj si jeta dhe krijimtaria e tij. I shpërngulur nga Pogradeci në moshën 3-vjeçare dhe i vendosur në një ambient të huaj, në një lagje shkupjane me maqedonas, Luani nisi aventurën e kërkimit të identitetit dhe rrënjëve të familjes gjatë shekujve XIX dhe XX, të cilin e sfidoi në rrethana dhe në kontekste fare të veçanta dhe specifike<sup>17</sup>.

Njëri prej donkishotëve letrarë të shekullit të XX është Xhevahir Spahiu, për të cilin Aliu shkroi: *Poeti i formatit të madh... më shfaqet në ecje të shpejtuar, thuaja në vrap, për diku. Mbase vrapthi për në një cak të rëndësishëm, ku pritët ardhja e tij, ardhja që s'guxon të mënojë*

<sup>13</sup> Po aty, f. 167-168.

<sup>14</sup> Po aty, f. 229-230.

<sup>15</sup> Po aty, f. 241.

<sup>16</sup> Po aty, f. 226.

<sup>17</sup> Po aty, f. 270.

– për të ndrequr diç të pandreqshme, cak ku pritet shpata e tij poetike për të shpëtuar njeriun”<sup>18</sup>.

\*

Pjesa e fundit e kumtesës ka të bëjë me mbresat nga leximi i hershëm i 11 eseve të Profesorit në librin *Ese letrare*. Të shkruara në vitin 1987, ato e shpërfaqin të vërtetën e hidhur, të njëjës prej stinëve më të acarta historike për shqiptarët e mbetur jashtë kufijve të Shqipërisë londineze.

Kumtet e autorit përfaqësojnë zjarrin prometeian që ai ua jep bashkëkombasve nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Lugina e Preshevës. Këtë e bën nëpërmjet eseve letrare që trajtojnë veprat e disa kolosëve të letërsisë botërore, si: Volteri, Borhesi, Hasheku, Kundera, Brehiti, Orueli, Markesi, Rafael Alberty, Zhak Preveri dhe Janis Ricosi, disa prej të cilave hedhin dritë mbi tmerret e tiranëve ndaj më të vegjëlve, që përkojnë me tmerret me të cilat ballafaqoheshin shqiptarët në kohën e botimit të veprës së Profesorit. Ato janë mesazhet e një intelektualit të brengosur për fatin e popullit të pambrojtur; janë apele drejtuar robit në stinën kur duhet të jetë i zgjuar, i përgatitur dhe i gatshëm për të shpëtuar nga dhuna shtazarake e tjetrit; në kohën kur i shtypuri detyrohet të zgjedhë njëriën prej dy rrugëve: jetën e robit të padinjitet, ose çlirimin e vendit me sakrificë të dhembshme.

Ja disa apele lehtësisht të zërthyeshme, të shkëputura nga analizat e Ali Aliut:

Po e nisim me komentin që Profesori i bën tregimit *Teologët*, të Borhesit: *Diku në mesjetën evropiane në kohën e konfrontimeve të rrepta të besimeve të ndryshme, një teolog, heton herazi, blasfemi në ligjërimet e teologut tjetër... Teologu i parë denoncon dhe teologun e dytë e djegin në stavën e druve. Teologu i parë bën sehir flakën dhe çfarë ndien në ato raste? Mjerimin e të përkëdhelurit, mjerimin e vetmisë apo çlirimin përfundimtar? Po i dyti, ai që digjet ngadalë, çfarë përjeton ai? Deri këtu, siç shifni, në faqet e tregimit **TEOLOGËT**, nuk ka asgjë të jashtëzakonshme, asgjë që nuk është e përditshme, e afërt. Por, ja vjen dhe fundi i tregimit si një hapje e gjerë e horizontit: Zoti, në defterin e vet, u kishte vënë shenjë barazimi të dy teologëve! Bën që në defterin e tij të jenë ngatërruar dhe të adresohen gabimisht në ferr, përkatësisht në parajsë... Mbase, por është vështirë të mos hetoni*

<sup>18</sup> Po aty, f. 305-306.

*mprehtësinë e cinizmit tragjik në këtë rrëfim mbi teologët e manipuluar nga Zoti*<sup>19</sup>.

Në analizën për novelën *Kandidi të Volterit*, shkroi: *Volteri për-qesh optimizmin që nuk ka mbulesë. Por, optimizmin sikur e ka vetëm shkas: më shumë se e për-qesh, ai e sulmon, e diskrediton filozofinë e harmonisë së paracaktuar, bindjen se bota dhe gjërat në të janë kurdisur sipas kësaj ligjshmërie të pacenueshme, të paprekshme: nuk vihet dorë në atë që është ligj i paracaktuar!*<sup>20</sup>

Në romanin *Ushtari i mirë Shvejck*, të Jeroslav Hashekut, Shvejku flet për qentë: *Ka soj qeni që nuk jepet, që nuk dorëzohet lehtë, siç ngjan me disa të tjerë. Por ama nuk ka të tillë që të mos dorëzohen. Kam pasur rast të njoh edhe qen për të cilin mund të pandehni se është më i përkushtuar, më besnik ndaj të zotit. Kështu duket në fillim. Por po s'ia qëlllove oreksin ai i lë shëndenë të zotit!*<sup>21</sup>.

Heroi i romanit *Shakaja*, të Milan Kunderës, rrëfen: *Në njësitë e zeza spiunllëku lulëzonte në mënyrë të veçantë: të gjithë shprehim neveri ndaj saj e të gjithë i besonim si MUNDËSI që është kurdoherë prezente, meqë ishte mjeti më efikas për shpëtim. Afinitetin e spiunllëkut e nxisnin sidomos eprorët tanë që ishin të dënuar si ne. Mbase për shkak se ata kishin pushtet vetëm mbi ne, ishin aq brutalë. Pushteti i tyre ishte si përbindësh, që me patkonj kali qëllon në kokë përherë... Mos vallë duke ushtruar brutalitet total, eprorët tanë kishin iluzion se nxitin mëshirën e pushtetit absolut. Megjithatë, as atyre nuk u jepnin armë, meqë edhe ata, njësoj si ne, i konsideronin armiq.*<sup>22</sup>

Ndër apelet më të forta dhe më të drejtpërdrejta të Profesorit drejtuar bashkëkombasve janë vargjet e Bertol Brehtit, që përputhen plotësisht me situatën e rëndë në të cilën gjendeshin shqiptarët:

*Oh, ju fatzinj  
Vëllait tuaj i bëhet dhunë dhe ju mbyllni Sytë!  
I prekuri bërtet fort, dhe ju heshtni?  
Dhunëbërësi sillet rrotull dhe zgjedh Prejat e tij, dhe ju thoni:  
Ne ai na kursen sepse s'tregojmë asnjë Mospëlqim!*<sup>23</sup>

<sup>19</sup> Ali Aliu, *Ese letrare*, Rilindja, Prishtinë, 1987, f. 248.

<sup>20</sup> Po aty, f. 249.

<sup>21</sup> Po aty, f. 252.

<sup>22</sup> Po aty, f. 258.

<sup>23</sup> Po aty, f. 253.

Apelin tjetër të fortë dhe domethënës, e përcolli gjithashtu nëpërmjet vargjeve të poezisë *Çuditë e lirisë*, të Zhak Preverit:

*Në dhëmbët e një kurthi  
Shputa e dhelprës së bardhë  
Dhe gjak mbi borë  
Gjak i dhelprës së bardhë  
Dhe gjurmë mbi borë  
Gjurmët e dhelprës së bardhë  
Që ikën me tri këmbë  
Nëpër diellin që perëndon  
Me në dhëmbë shtrënguar  
Një lepur ende të gjallë<sup>24</sup>.*

Ja dhe vargjet e shkëputura nga poezia *Demi në det*, e Rafael Albertit, të shoqëruara me një copëz komenti të Ali Aliut:

*Oh, këtij demi të blertë  
tash ia djezin gjakun!  
Secili e kapi për brirësh  
Dhe e rrëzoi,  
E shkeli për tokë,  
E tërhoqi me goditje prej metalesh të skuqura  
Mbi detin që digjet.*

*Në tiparet e figurës së demit janë mishëruar ngjyrërat tragjike të atdheut të poetit. Në plan të parë sikur del fuqia e shurdhër, fuqia me-mece dhe e manipuluar e demit. Fuqia për të cilën demi nuk është i vetëdijshëm, fuqia që lejon të provokohet, që lejon të kapet për brirësh dhe të shndërrohet në lodër për zbavitje. Fjala është për fuqi të pavetëdijshme, të paqëllim, prandaj lejon të gjunjëzohet.<sup>25</sup>*

Nga vepra *Lavdi marrisë*, e Erazmo i Roterdamit, profesori nënvizoi një copëz ligjërate të zonjës Marri, mbi njeriun e kënaqur e të lumtur, përballë njeriut fatkeq: *Sikur njerëzit të këputnin çfarëdo lidhje me mençurinë dhe ta kalonin jetën me mua përherë, nuk do të dinin kurrën e kurrës për asnjë brengë dhe do të kënaqeshin të lumtur në rininë e përhershme... Shikoni budallenjtë e mi se si janë majur dhe*

<sup>24</sup> Po aty, f. 262.

<sup>25</sup> Po aty, f. 264-265.

*bërë topolakë, me lëkurë të ngrehur mirë, derrkucë të vërtetë, të cilët nuk do t'i ndienin kurrën e kurrës as të ligat e pleqërisë sikur herë pas here të mos infektoheshin nga kontaktet me njerëzit e mençur.*<sup>26</sup>

Në romanin 1984 të Oruelit, Aliu u ndal tek alarmi që autori ia përcolli njerëzimit për: *Botën tmerrësisht jonjerëzore që observon Orueli në këtë vepër, në të cilën individit duket si luspë njeriu, i shpërlarë prej botës shpirtërore. Pa të afërt, pa miq, pa shpresë, pa mendim. Edhe ëndrrat janë të përgjuara në botën e kontrollit total.*<sup>27</sup> Nga analiza e thuktë që Ali Aliu i bën romanit *Kronika e një vdekjeje të paralajmëruar*, të gjeniut kolumbianit Gabriel Garsia Marquezit, po shkëpusim fragmentin e mëposhtëm: *Rrethanat historike e shoqërore kolumbiase që inspirojnë veprën e Marquezit e shpjegojnë brenda një konteksti më të gjerë gjenezën e trashëgimisë së vëllavrasjes: kur manipulohet në të gjitha format e veprimit jetësor, njeriu nuk mund të mos jetë i manipuluar edhe në këtë aspekt.*<sup>28</sup>

Edhe nga poeti i madh grek Janis Ricos, Ali Aliu përzgjodhi një poezi, për të cilën thotë se *është portret që të përkujton qëndrimin burror të malësorit, portret tiparësh shpirtërore të afërta. Zaten, e afërt ndihet tërë vepra e poetit të afërt edhe për kah hapësira dhe koha:*

*Në sytë e tyre blegërojnë delet e mbrëmjes  
në flokët e tyre vëren hijet e gjetheve të rrapit  
dhe flasin pak, nuk flasin fare  
ndërkaq herë-herë i sheh që kanë  
bërë krushqi me bredh  
Pranë syve të tyre kanë një pemëz mirësie  
midis vetullave të tyre kanë një korb fuqi  
dhe një mushkë me zemërim në zemrën e tyre  
Që nuk ngreh dot padrejtësinë.*

Ja dhe komenti i Profesorit:

*Zemërimi i mushkës, aq i njohur në këtë hapësirë, që për dallim nga kali, është e dëgjueshme deri në absurd, njësoj siç është e qëndrueshme dhe modeste në kërkesa: mjafton një grusht tagji që të mbajë pa*

<sup>26</sup> Po aty, f. 255.

<sup>27</sup> Po aty, f. 259.

<sup>28</sup> Po aty, f. 267.

*pushuar barrën e rëndë. Por ama ka një zemërim, një inat të madh: nuk e mban dot barrë në shpinë të padrejtën.*<sup>29</sup>

Ky është Ali Aliu, shkrimtar dhe veprimtar i shquar, i cili, edhe në kohëra të rrezikshme kur mund të humbiste kokën, gjeti mënyra për t'u dërguar bashkëkombasve mesazhe, me të cilat deshi t'i zgjojë nga gjumi vdekjeprurës për KUSHJAMIN e qenies sonë.

Për shumëkënd, Ali Aliu është kronikani më i devotshëm i vlerave letrare shqiptare, që nga zanafilla e gjer në ditët e sotme. Ai nuk e ndau trungun e letërsisë shqipe në degë e në krande, siç tentojnë ta ndajnë disa të tjerë, ndaj shkroi dhe vazhdon të shkruajë me të njëjtin përkushtim për letërsinë e vetme shqipe, pavarësisht kufijve artificialë që ndajnë trojet tona. Ai shkroi me respekt edhe për veprat e autorëve të ekskomunikuar. Nuk shkeli në dërrasën e hatrit të rremë shqiptar, të cilësuar prej kohësh më i rëndë se topuzi – dhe ajo që është më e rëndësishme: nuk rrëshqiti dhe nuk la pas vetes shkrime për të cilat sot do të ndihej i turpëruar.

Profesor Aliu kërkon prej kohësh gjallërimin e komunikimit të vakët kulturor brendashqiptar, i shqetësuar nga rritja e numrit të jeniçerëve të kulturës, që kërkojnë ndarje në baza krahinore, dialektore, fetare, sikur nuk e kuptojnë se, me takatin dhe kujdesin që kemi ne për të ardhmen, mbijetesa e qenies sonë të rrethuar me nepërka, mund të rrezikohet si kurrë më parë.

Shqiptarët janë me fat që kanë një njeri, një veprimtar, një pedagog, një studiues dhe një kritik të palodhshëm, që ndjek prej dekadash hapërimin, dritë-hijet, rëniet dhe ngritjet e vlerave letrare shqiptare.

---

<sup>29</sup> Po aty, f. 268-269.

## Bibliografia

Ali Aliu, *Don Kishoti te shqiptarët*, ASHAK, Prishtinë, 2005.

Ali Aliu, *Vepra të zgjedhura I-IV*, Serembe, Shkup, 2005.

Ali Aliu, *Dëshmi letrare*, ASHAK, Prishtinë, 2008.

Ali Aliu, *Urtia e fjalës*, ASHAK, Prishtinë, 2018.

Ali Aliu, *Libri i jetës*, ASHAK, Prishtinë, 2020.

Ali Aliu, *Ese letrare*, Rilindja, Prishtinë, 1987.

Ali Aliu, *Kritika*, Rilindja, Prishtinë, 1980.

Ali Aliu, *Artikuj kritikë*, Rilindja, Prishtinë, 1982.

Zija Çela

## I PANGJASHËM MES TË NGJASHMËVE

Kur më erdhi ftesa për këtë Tryezë, megjithëse dimër, dita kishte plot dritë dhe vetiu m'u kujtua çfarë i kisha thënë njëherë Ali Aliut. I kisha thënë se gjatë vitit, Prishtina vërtet ka tërheqje, por edhe Tirana ka shumë ditë me diell. Nuk e di pse, përveçse si albanolog i shquar, edhe si personalitet njerëzor, Ali Aliu më vjen në mend sidomos në ditë me diell. E kështu ndodhi që ky vegim m'u bë nxitje për t'i hedhur lirshëm ca shënime edhe në letër.

1. Akademiku 90-vjeçar, që na nderon mes nesh, ka një zakon të pashqitshëm. Kur është duke shkruar, ai sikur e këndon nën zë tekstin që po komponon. Dhe kjo ndodh prej fjollave të frymëzimit. Nga *Katër Stinët* e Vivaldit, ndoshta për harenë e saj, do ta vija gishtin te *Pranvera*. Ali Aliu i përket kritikës dhe filozofisë pozitiviste. Kur bën objekt studimi krijimtarinë e një shkrimtari, ai hedh dritë në anët më të forta të autorit, i analizon një për një, por me llupë në dorë nxjerr në pah edhe sythe që ose janë në zhvillim, ose premtojnë të zhvillohen. Në shkrimet e tij nuk ka asgjë toksike. Ai nuk helmon as me dashje, as pa dashje, përkundrazi, vihet në krah të shkrimtarit të cilit i dhuron vlerësim dhe ndjesi gëzimi. Nuk ka autor që mund të ankohet se Ali Aliu ia ka ngrënë hakun, siç nuk kam dëgjuar ta ketë pohuar dikush mbipeshën, kur mund t'i jetë dhënë më tepër.

2. Ali Aliu e ka të lindur Dashninë për leximin dhe Pasionin e fjalës për letërsinë. Pa e pasur fare qëllim, madje pa i shkuar asfare në mend, çfarë ka pasur të brendshme e ka shpallur si kryemotiv qysh në fillimet e veta. Ja si mund të lexohen të bashkuar tre titujt e tre librave të tij të parë: "Kërkime e Shtjellime në Rrjedha të Letërsisë". Tre tituj në një, kredo e plotë. Ali Aliu është studiuesi në simbiozë me zekthat që ka përditshmëria e kritikut. Ky është tharmi që, ashtu siç nuk e ka lënë në rini, nuk e lë rehat as në moshën e patriarkut. Kur i ka ardhur për të folur, atij nuk i ka ngrirë lapsi në dorë, madje me raste nuk është stepur për ta trajtuar një vepër edhe si kryevepër, pa manipuluar me heshtjen si element i estetikës së reagimit, apo si koncept i dilemës etike. Romancierët ndoshta s'janë aq bujarë sa poetët, të cilët jo rrallë ngopen me aromën e lavdërimeve, ndërkohë që prozatori ndalet ndër paragrafë e detaje, duke kërkuar argumentin në shumësinë e tyre. Nuk po i shtyj më tej reagimet e palës së shkrimtarëve, por po them se ndodh

diçka e çuditshme me palën tjetër. Në vend se të presë mirënjohje nga autorët e librave që ka pëlqyer, Ali Aliu sillet vetë i pari falënderues ndaj tyre.

3. Sigurisht, me sy të lirë askujt nuk i duken shenjat e botës së brendshme. Por, askush që merr guximin të shkruajë, sado të përpiqet, për një sy të stërvitur, nuk mund ta fshehë transplantin e zemrës në tekstin e tij, në terma të kardiologjisë, ritmin, aritminë, suficencën, insuficencën, etj. Ashtu si për çdo krijimtari, në rreshta e midis rreshtave, shpirti i kritikut pulson në tekst, duke dëshmuar si ndihet fjala aty, vjen si harmoni, vjen si llogaritje matematike, rënkon nga mungesa apo kërcet nga teprimi. Modalitetet e shqyrtimit kritik janë nga më të ndryshmet, rekomandohet objektiviteti. Mirëpo, kur e kanë pasur prirje, edhe kritikë e studiues të shquar në botë, ia kanë dalë ta arrijnë objektivitetin jo vetëm përmes dijes, kulturës e kapacitetit mental, por edhe ndihmës së urtësisë shpirtërore. Më duket se kjo urtësi e karakterizon tekstin e Aliut. Në pjesën e shkrimeve kritike ai nuk është i shkarkuar plotësisht nga barra emocionale, porse emocioni i ngarkohet vetë zbulimit të një thelbi, bie fjala, thelbit të përgjigjes se çfarë është e re në librin e këtij apo atij autori. Dhe, nuk mund të mohohet, për vetë natyrën e tij zbulimi është ngritje e velit, njëfarë dasme e përjetshme, ai e ka në aksionin e vet emocionin.

4. Në veprën e Ali Aliut gjenden referenca, por zakonisht të natyrës pohuese, mbështetëse dhe informuese. Duke mënjanuar frymën e debatit dhe të polemikës, ai përqendrohet sidomos në faktorët e tij të analizës, në thellimin e argumenteve dhe depërtimin shpesh kapilar. Si fryt i punës së Ali Aliut, ndër të tjera, në librin voluminoz “Don Kishoti shqiptar”, që sapo është ribotuar i plotësuar, sot kemi një tablo plot ngjyra mbi krijimtarinë e disa prej poetëve e prozatorëve më të spikatur bashkëkohorë. Herë në rolin e historianit, e herë të propozuesit për historianët e letërsisë, në këtë antologji vetjake të mendimit kritik gjejmë problematika të rëndësishme të estetikës dhe përgjithësisht të teori-ve letrare. Aty shtrohen pyetje e jepen përgjigje për çështje bazike të prozodisë, individualitetit dhe narracionit, raportit të reales me irealen, gjuhës së tekstit e të nëntekstit, etj.

5. Njëherë, teksa bisedonim për një shkrim të botuar në gazetë, vërejta se Aliut i kishte mbetur peng përse redaktori kishte ndajshuar pranë emrit të tij ofiqin e akademikut. Dhe këtë nuk mund ta merrje as si shtirje, as si trill, aq më pak si rastësi. Ai gjithnjë nuk ka kërkuar ndonjë potencim me statuset zyrtare, për ta lënë lexuesin të lirë në gjykimin e tekstit, duke ia respektuar mendimin e pavarur dhe mënyrën

e leximit. Tekefundit, tërë jetën edhe vetë është treguar një lexues i hatashëm, nga ata të thekurit, të cilët lënë sytë mbi shkronjat e tjetërkujt.

6. Por, si lexon Ali Aliu? Kam krijuar një përshtypje nga biblioteka e tij private. Me gjasë, me t'iu ndezur ndonjë shkëndijë përgjatë lëçitjes, ai hedh shënime në margjinat e librit, në ato hapësirat e bardha sa një pentagram. Si ta përfundojë leximin, do të këqyrë pikërisht këto nota të shpejta. Nëse ka mundur të nxjerrë esenca, ndihet thujse gati për shkrimin; nëse ende jo sa duhet, i rikthehet librit pjesërisht. Përndryshe, me kalimin e kohës, ato shkëndijat ftohen dhe shënimet nuk dalin nga raftet. Mes mënyrave të larmishme, pse jo, mua më pëlqen gjithashtu ky qëndrim, që afron me krijimtarinë e mirëfilltë: të punosh jo vetëm për të kënaqur të tjerët, por së pari për të ndier kënaqësi vetë gjatë procesit të shkrimit.

Ali Aliu ka lexuar shumë libra të rëndësishëm. Por, ma do mendja nuk ka profesionist që të ketë lexuar sa ai edhe libra të parëndësishëm. Nëpër vite, për t'i dhënë skenës emrin që ka, kam parë si i "vërsulen" në panairë duke i dhuruar libra prej kahmos. Siç është e pritshme, nuk mungojnë autorë të afirmuar, por nuk mungon sidomos bylyku i fillestarëve, amatorëve të vonuar e maniakëve të shkrimit. Si drejtin e ndiejnë këta se kanë gjetur "babaxhanin" e duhur?! Sepse Aliu, me torbat plot, shkon pastaj përtej mirësjelljes: i lexon thujse të gjithë ata libra, madje cili është me fat edhe recensionohet. Kam menduar ndonjëherë se Aliu nuk është fort i rreptë si kontrollor. Por, më mirë genuin, sesa ta lidhte veten duke u bërë autocensor. Natyrisht, ne do të kishim edhe ashtu një profil letrar, por jo kaq të personalizuar prej shenjave të tij, domethënë një personalitet të pangjashëm midis të ngjashmëve, ose të ngjashëm me të pangjashmit. Shkurt fjala, një kritik kaq empatik.

7. Në përvojën time, kur shkruaj një roman, synoj të kaloj në katër nivele, që nuk është rasti të përmenden. Por, ekziston edhe një i pestë. Ky është niveli kur kritika letrare zbulon në veprën e shkrimtarit çfarë s'e ka ditur më parë vetë autori i saj. Kështu ndodh edhe me kritikët e studiuesit, jo rrallë dinë për veten më pak se të tjerët dinë për ata. Dhe sa mirë kur kolegët janë të gatshëm t'ia thonë.

8. Dhashtë Zoti që, një ditë, të jemi çliruar përfundimisht nga bizantinizmi i trashëguar, ai i llojit që, siç thotë Brodskij, sa më afër qëllimit të ndritur të jetë dikush, aq më të mjegullta ia bëjmë mundësitë e arritjes. Afërmendsh, auditori më i drejtpërdrejtë për çfarë shkruhet sot janë bashkëkohësit. Por, unë besoj se do të mbizotërojnë interesat e pastër, të cilët punën e çmuar të studiuesve tanë do t'ia përcjellin edhe së ardhmes.

9. Ah, edhe diçka në fund, meqë pajtohem se çka është e mjaftueshme, mbetet gjithnjë e pamjaftueshme. Po, gjatë vitit Prishtina ka vërtet tërheqje, por edhe Tirana ka shumë ditë me diell... Vijon në 100-vjetorin e lindjes.

## Resul Shabani

### AKADEMIK ALI ALIU – ANTOLOGJIST

Për Tryezën “Krijimtaria letrare e Ali Aliut” është me interes të them diçka për profesorin Ali Aliu si antologjist, duke u ndalur në mënyrë më shkoqitëse te tri antologjitë e tij të përgatitura për publikun maqedonas:

1) Poezia bashkëkohore e Shqipërisë, (Современа поезија на Албанија, СБП ’96), botuar nga Festivali Mbrëmjet Strugane të Poezisë më 1996, me rastin e prezantimit të poezisë së Shqipërisë, që ndodhte për herë të parë. Përveç përzgjedhjes, ai shkroi edhe Parathënien. Antologjia përfshin 33 poetë, çelet me Seremben e mbyllet me Ervin Hatibin, duke përfshirë 152 poezi;

2) Antologjia e poezisë bashkëkohore shqiptare (Антологија на современата албанска поезија, Pro Litera, Скопје 2001 год.) Prezantohen 31 autorë, nga Vorea Ujko (1918-1989) deri te Mimoza Ahmeti (1963). Profesor Aliu, përveç përzgjedhjes dhe shënimeve për poetët, kontribuon edhe si përkthyes: Ante Popovski, Ali Aliu, Resul Shabani;

3) Poetë dhe tregimtarë (Поети и раскажувачи, Скопје 2017 год.) Në këtë antologji, publikut maqedonas i prezantohen krijuesit anëtarë të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Librit i prin poeti Esad Mekuli, kryetari i parë i Akademisë, dhe librin e mbyll prozatori Mehmet Kraja, kryetari aktual i saj.<sup>1</sup>

Nuk më kujtohet nëse ishte viti 1957 apo ’58, kur më rastisi ta vizitoja për herë të parë Arvatën e Prespës,<sup>2</sup> vendlindjen e akademikut tonë të respektuar, që sot na ka mbledhur këtu për t’ia kremtuar 90-

---

<sup>1</sup> Autori i këtij punimi, Resul Shabani, në kohën e përgatitjes së Programit të Tryezës Shkencore “Krijimtaria letrare e Ali Aliut”, ka paraqitur këtë Abstrakt, mirëpo, në një letër që i dërgon më vonë Këshilli Organizues, thekson se “për shkaqe shëndetësore, sinopsisi i kumtesës më mbeti ‘skelet’ i papërfunduar”. Si rrjedhojë, teksti i mëposhtëm, të cilin Këshilli Organizues ka vendosur ta botojë, ka tipare të një skicimi të ideve të paraqitura në Abstrakt. Shikuar si tërësi, nuk merr trajtë të përmbyllur. Si rrjedhojë, mbetet një tekst fragmentar. Mirëpo, edhe si i tillë, ruan vlerë dëshmuese së miqësisë letrare.

<sup>2</sup> Fshati Arvat është i përngjitur me fshatin Kranjë të Prespës, si rrjedhojë afërsia ndërmjet tyre shpeshherë e relativizon saktësinë e emërtimeve.

vjetorin e lindjes dhe, dhëntë Zoti, të na mbledhë edhe pas dhjetë vjetësh.

Kisha shkuar në fshatin e tij si interpretues arti, meqë luaja rolin e Pepit, djalit të çiftit Skerco, në komedinë e Hivzi Sulejmanit *Miu në Xhep*.

Për mua, Arvati u bë edhe më i dashur, kur njoha kritikun tonë të papërsëritshëm, Ali Aliun. Dhe jo vetëm për mua, por për shumë krijues, miq të ftuar apo kalimtarë rasti. Kulla e Aliut u shndërrua në një teqë të njohur mikpritëse, e ngrohtë dhe e dashur. U bë njëra nga simbolet e Prespës, përveç Sarajeve të Nijazi Bej Prespës (1873-1913)<sup>3</sup> mollëve dhe kurbetit.

Thënë më drejt: Prespa tani njihet si vendlindja e Ali Aliut dhe Nijazi Bej Prespës. Ka pika përputhëse në mes të Nijazi Bej Prespës dhe Akademikut Ali Aliu.

Të dy janë patriotë në mënyrën e vet, të dy e duan artin dhe kulturën (Nijaziu atë franceze), të dy janë bujarë dhe aristokratë në sjellje dhe në mënyrën e jetesës. Të dy, pra, kishin edhe sarajet, pallatet apo kullat e tyre: Aliu të trashëguar e Nijaziu të ndërtuar, por që nuk e trashëgoi.

Jam i bindur se Ali Aliu është aristokrati i fundit në mesin tonë. Ai e zgjedh poezinë, e zgjedh librin, i zgjedh miqtë dhe shokët, e zgjedh teshën, e zgjedh edhe ambientin ku e pi kafënë, i zgjedh fjalët...

Nuk e di si m'u imponua krahasimi me vlerësimin e gazetarit italian Indro Montaneli (cituar sipas Visar Zhitit) për ish-kryeministrin shqiptar – Mustafa Kruja, kur thotë: *Sukseset e nderimet nuk kanë mundur ta shndërrojnë natyrën edhe sjelljen e jashtme të këtij burri... (që) nuk i jep rëndësi vetes me poza e me fjalë të mëdha. Vazhdon të flasë me maturi e... thotë të vërtetën... Jeta e tij ngjan me atë të Mazzinit e programi i tij është ky: dua një Shqipëri të bashkuar në kufijtë e saj natyrorë*. Kurse unë, duke u lidhur me krahasimin e mësipërm e për analogji, do të shtoja: Aliu do dhe lufton për një letërsi shqipe të bashkuar e të përparuar.

E bëra këtë digresion për ta ardhur te bujaria dhe qëndrimi i Aliut sa i përket pasurisë materiale. Dhe këtu më duhet të përmend një varg të poetit të madh palestinez, Mahmut Daruishi (1941-2008), që i kaloi

<sup>3</sup> Ahmed Njazi Prespa ishte Beu i Resnjës, figurë patriotike shqiptare e lidhur me organizimin politik e ushtarak të Revolucionit të Turqve të Rinj (shënim i redaksisë).

26 vjet në ekzil, ku thotë: *Nuk dua të posedoj asgjë, / që mos të jem i poseduar, ose: S'dua të kem asgjë, / që mos më ketë askush.*

Dhe Aliu ynë e fal kullën e tij.

Këto janë dhe tiparet më të spikatura që na e bëjnë tërheqës dhe të dashur portretin e këtij heroi, në rastin tonë të këtij njeriu me emrin Ali Aliu. Vetëm një njeri i mbrujtur me këto tipare është i përkushtuar, misionar dhe i besueshëm. Vetëm ky njeri mund t'ia përkushtojë pa yjem tërë qenien e tij njerëzore, intelektuale e krijuese mirëqenies dhe përparimit të popullit të vet, se, siç thotë publicisti dhe intelektuali Ismet Toto në skicën e tij të fundit para varjes: *Sa je gjallë digju dhe nëpër ato djegie lësho dritë dhe ngrohtësi. Bota nuk është e atyre që ngrohen. Bota është e atyre që digjen.* Unë jam i prirë ta besoj thellë se ky është tipar themelor i karakterit të Aliut, që është i gatshëm të flijohet për të mirën njerëzore në përgjithësi, e për atë kombëtaren në veçanti. Mbase në këtë aspekt ka ndikuar edhe filozofia dhe mistika bektashiane, si dhe ndikimi jo i vogël i leximit e më pas edhe i studimit të thellë të veprës së Naim Frashërit, si përfaqësuesit më tipik të këtij mësimi.

Aliu Aliu sot pranohet si njëri ndër njohësit më të mirë të poezisë së Naim Frashërit, e cila fund e krye përshkohet nga nota patriotike dhe kjo nuk i përshkruhet vetë karakteristikës së romantizmit si drejtim letrar, por edhe tiparit të bektashizmit. Naimi, aq e do Shqipërinë, sa ia sjell edhe Abaz Aliun pranë, për ta mbrojtur. Te *Qerbelaja* e tij hasim edhe këto vargje:

*Ç'është ai që shkon kaluar,  
Ikën si veriu,  
Me dy-tri foshnja në duar  
Është Abaz Aliu*

*Abas Aliu zu' Tomorë,  
Erdhi afër nesh,  
Shqipërija s'mbet e gjorë,  
Se Zoti e desh.*

Kështu thotë Naimi në një nga krijimet më të bukura të tij, te *Qerbelaja*. Prandaj, nuk është fare e rastësishme që gati në të gjitha antologjitë e hartuara të Ali Aliut, vend të konsiderueshëm zë lirika patriotike.

Ali Aliu ka të njëjtin qëndrim si për lirikën atdhetare, intime apo sociale, mirëpo parimi kryesor te përzgjedhja e tij është ai estetik, pa marrë parasysh motivet e lirikës. E do lirikën e realizuar në aspektin artistik gati të përkryer. E preferon poezinë refleksive, duke mos e përfillur poezinë-parullë, apo të pankartës. Është ihtar i poezisë që të nxit të reflektosh, të shqetësohesh kur e lexon. Ka një lagje kritikësh që reklamojnë poezinë “e qartë”, të “kuptueshme” nga të gjithë. Aliu ynë është ihtar i poezisë që s’është e thënë të kuptohet nga çdo lexues. Shumë sish deklarojnë se nuk e kuptojnë poezinë. Dhe këtyre kritikë Ali Aliu u përgjigjet, apo mund t’u përgjigjet, me një fjali: S’është e thënë ta kuptoni, mjafton që ajo t’ju prekë. Gjatë përzgjedhjeve që bën antologjistit ynë, kujdes të veçantë i kushton mesazhit që përcjell ajo. Ai është i vetëdijshëm se poezia nuk e ndryshon botën, pra nuk ushqehet me këto iluzione, dhe nuk ia detyron as lexuesit, por ka dëshirë që poezia ta sundojë botën. Thuajse këtë bindje dhe kërkesë e ka edhe poeti francez Zhan-Pjer Simeon, i cili në vargjet e poezisë me titull *Poezia duhet ta sundojë botën* thotë:

*I ashtuquajturi rend që shohim dhe jetojmë  
është thjesht rrëmujë e dëshiruar nga ata që na qeverisin...  
Fundi i fundit  
Ka ardhur koha që poezia të sundojë botën  
Edhe pse nuk ka asnjë fuqi të garantojë siguri.*<sup>4</sup>

Akademiku Ali Aliu është studiues, kritik dhe eseist i përveçëm. Këtë me gojën plot e thonë dhe e pranojnë, jo vetëm kolegët e tij, por edhe opinioni më i gjerë lexues. Bile studiuesi dhe eseisti i njohur, profesori Alfred Uçi, e vlerëson me gradën “gjeneral”.

Më pak është folur për profesorin tonë kur bie fjala për kontributin e tij në fushën e gazetarisë, atë të përkthimit dhe atë të

<sup>4</sup> Poeti francez Zhan-Pjer Simeon (1950) është Laureat i Kurorës së Artë të Mbrëmjeve Strugane të Poezisë për vitin 2024. Në mesazhin dërguar festivalit, me rastin e ndarjes së Çmimit, poeti Simeon, thotë: “Guxova para disa vitesh të shkruaj një ese me titull *Poezia do ta shpëtojë botën*. Ky afirmim i pakushtëzuar, shumicës që besojnë se poezia është vetëm një ornament sharmant, iu duk qesharak, një lojë fjalësh që mund t’u interesojë vetëm një grushti gjuhëtarësh. Përkundrazi, unë jam fort i prirë të mendoj se poezia më sublime që i bën të pavdekshëm poetët e të gjithë meridianëve, është shprehje e një vizioni memorial dhe universal, e cila është e vetmja që mund t’i japë kuptim aventurës së njeriut në këtë botë të pakuptimtë”.

mësimdhënies. Jam shumë i disponuar të gjej pika ngjashmërie midis Abaz Aliut dhe Profesor Ali Aliut. *Ato dy-tri foshnja në duar* që Abaz Aliu i shpëton nga tmerri i luftës të Qerbelasë, unë i shoh si qindra studentë që Aliu Aliu i shpëtoi nga terri i injorancës dhe dhjetëra krijues që ai i nxori nga mjegulla e iluzioneve dhe e lajthitjeve gjoja krijuese.

Një investim shumë të vlefshëm për afirmimin e letërsisë sonë, Ali Aliu e ka dhënë në lëmin e publikimit të krijimeve të përzgjedhura, duke ndarë, gjithnjë sipas kriterëve të shëndosha të tij, grurin nga egjra. Këtu do të përmendim disa syresh: *Antologjia e poezisë bashkëkohore e Shqipërisë* (maqedonisht), *Antologji e poezisë shqipe*, *Antologjia e poezisë bashkëkohore shqipe* (maqedonisht), *Një lexim i mundshëm i poezisë*, *Poetë dhe tregimtarë akademikë* (maqedonisht). Këtu patjetër do të përmendim edhe përzgjedhjet e poezive të autorëve të veçantë, përzgjedhje krijimesh (edhe në prozë) të botuara si tekste për shkollat tona.

Profesor Ali Aliu është shumë i vëmendshëm kur këto përzgjedhje i bën për lexuesin e huaj. Ai ua bën të njohur historinë e poezisë sonë, etapat e zhvillimit, motivet dominuese, gjakimet e saj shoqërore, karakteristikat e vargëzimit, etj..

Poetët e zemrës së Ali Aliut janë Naim Frashëri, Fatos Arapi, Azem Shkreli dhe Ali Podrimja. Po ashtu, Ali Aliu është ‘zbuluesi’ i poezisë së Mihal Hanxharit.

Ali Aliu është përkthyes i rreth 20.000 vargjeve poetike, të autorëve të lartpërmendur, por edhe të shumë autorëve të tjerë.

Të marrim shembull portretimin fiziko-psikologjik më mbresëlënës, më të veçantë dhe më të saktë në tërë antologjinë *Poetë dhe prozatorë akademikë*:

*Krijuesin Sabri Hamiti e mbaj mend nga një takim, për mua të parin, këtu e tridhjetë e një vjet të shkuar. Ishte një dhomë pune e Edicionit të botimeve – Rilindja, ku asokohe isha redaktor së bashku me poetin Rrahman Dedaj, edhe ai redaktor, dhe poeti njëzetënjëvjeçar, i ulur në një karrige përballë. Me siguri do të paskësh ardhur të interesohej për dorëshkrimin e parë me poezi, që do të botohej disa muaj më vonë. Nuk më kujtohet me saktësi asgjë konkrete nga biseda, mbase me Dedajn, përgjegjës për poezi, e megjithatë përshtypja nga ky takim paskësh mbetur e gjallë në mbamendje: fytyrëngrysur, fjalëpakë, një rrëzitim zemërimi në kufi të revoltës, i akumuluar ndër vite, përkatësisht ndër shekuj, një vetëbesim që s’tundet...*

*Pikërisht ky refleks–përfytyrim u veçua zëshëm nga kujtesa gjatë shfletimecjes nëpër katër mijë faqet e dhjetë vëllimeve të kompletit të Sabri Hamitit, që, në botim të Shtëpisë Botuese Faik Konica, Prishtinë, doli këto ditë, e që janë pesë të parat me shkrime letrare – poezi, prozë, drama dhe, pesë me shkrime ese, kritikë, studime. Secili vëllim i kompletit hapet me një foto, gjithnjë të ndryshme, në moshë e disponim, të autorit. Po i përmend fotot për arsye se janë kapitull më vete i veprës që po përurojmë, e njëherësh ngasësi kryesor për të veçuar pamjen e mbajtur mend e që e zura ngoje më sipër. Të shtoj, po ashtu, se nuk më ka rastisur të has edhe një rast ku prania e fotografisë së një autori në veprën e vet të vihet kaq sugjestivisht në funksion të shpalosjes, të njohjes së konteksteve kohore, shpirtërore, intelektuale, brenda të cilave ka lindur vepra së cilës i prin fotoja. Po le të kthehemi në vitin 1971, kur u regjistrua pamja e fiksuar: Sabri Hamiti, njëzetenvjeçar, me dorë-shkrimin e parë poetik nën sjetull, poet që po përfundonte studimet albanologjike në Prishtinë, që kishte pas vetes pjesëmarrjen aktive në protestat e studentëve më 1968, që ëndërronte t’ia mësynte Sorbonës në Paris – ku do të regjistrohet një vit më pas – ky i ri, pra, ç’revoltë poetike sillte në Edicionin e atëhershëm të Rilindjes? Ngrysja vjeshitore dhe ëndërrimi, apo revolta ëndërrimtare, ishin parashenjat njohëse të poezisë së tij – si veshje, si ekspresion dhe si aromë. I riu, me talent të shquar, gjakonte ta trazonte nga kotja e mbërthyer fjalën, ta nxirrte atë nga kallëpet kuptimore, nga konvencat e ngurosurra dhe njëdrejtimëshe, ta provokonte atë në shkallë rrezatimi të pakufishëm... Me kohë, gjakimi do ta shtrijë edhe në kërkim të hapësirës së lirë të fjalës, të gjuhës së gjakut, me rrënjë e trung antik e ilirik. Gjakimi i parë, asokohe, për zhvendosje kufijsh të fjalës poetike, ishte rebelim krijues, ndërsa gjakimi i dytë rebelim politik. Të dyja së bashku, përbënin projektin e përcaktuar nga brenda e që do ta thurin veprën poetike të Sabri Hamitit, gjithnjë me fjalën e cila do të ecë tehut të shpatës, me jehonë e ndikim të veçantë në hapësirën poetike të shqipes.<sup>5</sup>*

Po ashtu, të themi disa përshtypje edhe për Antologjinë: *Poezia bashkëkohore e Shqipërisë* (1996).

Më 1996, rastisi që të jem anëtar i Këshillit Artistik të Festivalit.<sup>6</sup> Dhe, çdonjëri që do të ndodhej aty, do të interesohej pak më shumë për

<sup>5</sup> Antologjia: *Poetë dhe tregimtarë* [Поети и раскажувачи, Скопје 2017], f. 236.

<sup>6</sup> Bëhet fjalë për Festivalin Ndërkombëtar Mbrëmjet Strugane të Poezisë, me rastin e 35–vjetorit të themelimit të tij.

poezinë e gjuhës së tij. Propozova që një mbrëmje t'i kushtojë poezisë së Shqipërisë.<sup>7</sup> Propozimi u miratua. Mbrëmja duhej të shoqërohej edhe me një Antologji rasti dhe me prezencën e një delegacioni zyrtar. Ali Aliu bëri një Parathënie të shkëlqyer, ku e përmendte edhe faktin e propozicioneve.

Pjesë nga Parathënia e Ali Aliut në përzgjedhjen *Poezia bashkëkohore e Shqipërisë*, MSP, 1996:

*Një zgjedhje poetike si kjo, e tipit antologji, e hartuar për lexuesit e një gjuhe tjetër, nxit dilema, pikërisht nga vetëdija se kjo zgjedhje poetike do t'i dhurohet lexuesit të një gjuhe tjetër, të një tradite tjetër. Dilema, përkatësisht shqetësimi, lidhet me faktin se në një gjuhë tjetër nuk mund të përçohen të padëmtuara vlerat burimore, të cilësdo qoftë poezi, dhe ajo që është akoma më brengosëse ka të bëjë me vështirësitë në rrafshin e komunikimit me një pjesë të një letërsie të shkoqur nga tërësia historike, shpirtërore, kulturologjike, shoqërore...*

*Poezia e këtij krahu nuk bën pjesë në këtë zgjedhje. Duke respektuar propozicionet e manifestimit Mbrëmjet Poetike të Strugës, në kuadër të kësaj zgjedhjeje janë përfshirë vetëm poetët e krahut të parë, prandaj portreti aktual i poezisë shqipe është i mangët për gjysmën e artikulluar në nivel të pjekur artistikisht.<sup>8</sup>*

Ndërsa në antologjinë poetike të shoqëruar me interpretime *Një lexim i mundshëm i poezisë* (2016), Ali Aliu kategorizon poezinë patriotike me shembull vjershërimit të Ali Podrimjes, ku thotë: *Pse e tmerrojnë poetin shqipëritë? Një (Shqipëri), po edhe një, edhe një – shumëshqipëritë! E ëndërruara ndër shekuj: Një, s'u bë që s'u bë! Secili (bajraktar) do nga një shqipëri për vete... E ajo assesi të ketë një të vetmen kërthizë – një pikëmbështetje edhe guri arbëror... Nga sytë këmbët, me një grusht dhe të zhuritur, në kërkim të hartave tragjike të shumëshqipërive.*

Dhe në përngjitje jep poezinë e Ali Podrimjes:

### **SHQIPËRITË**

(Dr. Pandeli Çinës)

*Na tmerruan shqipëritë*

*Edhe tej e tej e tej*

<sup>7</sup> Me Rregulloren e Festivalit ishte përcaktuar që, për arsye praktike të komunikimit, të prezantohen poezitë e krijuara brenda një shteti dhe jo një gjuhe.

<sup>8</sup> Ali Aliu: *Vepra të zgjedhura II*, Serembe, Shkup, 2005, ff. 55-59.

*Varre e nishana pikëllues*

*Në ëndrra pikëlojnë sy  
Një asnjëherë perëndi  
Të ketë 'i kërthizë guri*

*Të dridhen tokeqiell  
Kur të dëgjohet në log  
At e bir e shenjtë të betohen  
Nadjembrëmje*

*Na bebe pikepesë shqipëritë  
Nuk dimë ku e bëjmë vdekjen  
Vaji na është këngë*

*Frymë bëhemi e nga 'i grusht dhe  
Duke i kërkuar të uruarat  
Nëpër harta tragjike*

*(Tiranë, nëntor 2001)*

Ndërsa, në kategorizimin e *poezisë erotike* merr shembull poezinë *Përsiatje tri ditë para vjeshte* të Resul Shabanit, së cilës i prin interpretimi i kritikut e poetit maqedonas Mateja Matevski, e mbas tij ai i Ali Aliut:

Mateja Matevski: *Motivet e dashurisë dhe lidhshmëria me shtëpinë, babën, motrën, etj., e zgjerojnë vjershërimin e tij edhe në frymëzimin e amshueshëm – të dashurisë ndaj së dashurës. Ka në këtë dashuri edhe dalli dhe ngazëllim me bukurinë e femrës, por ka, si edhe te vargjet e tjera, edhe një melankoli të lehtë elegjiake dhe reflektim të lënduar. Kjo elegji e prajshme endet te sugjerimi i vargjeve për kalimtarin, sidomos te poezia “Përsiatje tri ditë para vjeshte”. Shpërthimi i bukurisë së dashurisë dhe dalldisë i bën hije njohjes dhe lidhshmërisë pas asaj që e mbjell luleborën në shpirtin e tij të shkretëruar, në vjeshtën e tij të vonuar.*

Ali Aliu: *Në mbamendjen time mbi lirikën e dashurisë, poezia “Përsiatje tri ditë para vjeshte”, është ndër poezitë më të përsosura,*

*ndër më të bukurat, ndër më dramatiket – më tronditëset më vjen të them. Nga vargjet e saj, shpërthen në kupë të qiellit një mall pikëllues, i stuhishëm, mall që shpërthen e rebelohet vullkan i gjallë, që përplasat sa në ëndërrim lumturues, sa në vuajtje, në varr pa ngushëllim. E artikuloar mbi shtyllën poetike të antitezës, poeti e zë veten mbi urën e ujit që rrjedh në pakthim, mbi urën me dërrasa të çara – e çarë, ulëritëse çdo gjë, shpirti dhe universi dhe kujtimi i saj: i zanës së dallgëve, i orës së liqenit, që vjen të qetësojë mallin, mërinë dhe xhelozinë, dhembjen që kullon mungesë e saj, në ditëvjeshtën e poetit që ngryset. Dhe vargu që jehon më dëshpërues: Unë s'jam i zoti të të fal / asnjë ëndërr për ta ëndërruar.*

Poezia e Resul Shabanit:<sup>9</sup>

#### PERSIATJE TRI DITE PARA VJESHTE

*Derisa unë ngryset ditëvjeshtën e vakët  
Te këmba e urës së ujit,  
Urës me dërrasa të çara  
Prej marrëzie, prej mërie - xhelozie,  
Urës me parmakë dafine  
Prej mirësie, prej bukurie - dashurie,  
Mbi të cilën shkel këmba jote e bukur,  
Nën të cilën noton krahu yt - flutur;  
Ti shpërndan mjegullën e dendur,  
Prej portretit tim të venitur.  
Po ti, sirenë vale, zanë dallge, orë liqeni  
Ti, nuse nuri, nuse syri, nuse zhuri;  
Ç'kërkon në varfërinë time  
Më të varfër se varfëria?  
Derisa ti mbjell luleborën  
Në shpirtin tim të shkretuar,  
Sjell fllad pranvere  
Në vjeshtën time të vonuar,  
Unë s'jam i zoti të të fal  
Asnjë ëndërr për ta ëndërruar,  
Asnjë shpresë për ta shpresuar,*

<sup>9</sup> Shih: Ali Aliu: *Një lexim i mundshëm i poezisë*, 2016, f. 240.

Veç një tufë rrezesh,  
 Që as dritën s'e ndriçojnë,  
 As terrin s'e zbardhëllojnë  
 Dhe një qiri të ndezë me lutje Shën Mërisë  
 Syri i keq mos të të shohë, sy i keq i xhelozisë.

(Strugë, 18. 09. '12)

Në antologjinë e komentuar *Një lexim i mundshëm i poezisë*, Ali Aliu përzgjedh dhe kategorizon edhe *poezinë sociale* e *poezinë deskriptive*, duke prezantuar autorë që artikulohe në gjysmën e dytë të shek. XX dhe autorë që nisin krijimtarinë e tyre poetike në shek. XXI.

## Appendix

Ekstrakt nga intervista e Ali Aliut për revistën javore letrare *Ex Libris*, numri 85, 27 qershor 2020, e realizuar nga Bujar Hudhri, me titull: *Ali Aliu: Ndryshe ndihem mirë në Shkup, ndryshe në Tiranë, ndryshe në Prishtinë*, ff. 1-4.

*Më 2005, shtëpia botuese “Serembe” në Shkup jua botoi kompletin e veprave në katër vëllime, deri atëherë ju ua botonit të tjerëve veprat në komplete. Si e pritët këtë ndërmarrje?*

Po, në vitin 2005, Shtëpia Botuese “Serembe”, në “Vepra të zgjedhura”, botoi katër vëllime nga krijimtaria ime letraro-shkencore. Falë themeluesit dhe udhëheqësit të kësaj shtëpie botuese, shkrimtarit Resul Shabani, në Shkup për herë të parë u përkrah një projekt i tillë nga Ministria e Kulturës edhe për një krijues nga radhët e shqiptarëve. Dua të përmend se ishte fatkeqësi dhe dëm për jetën letrare në gjuhën shqipe në Maqedoni që Shtëpia Botuese “Serembe”, në mungesë të përkrahjes nga pushteti i atëhershëm, nuk arriti të mbijetojë, që do të thotë se aktiviteti botues shqiptar në Maqedoni dhe jeta letrare shqiptare nuk e shfrytëzoi përvojën e Resul Shabanit në këtë fushë, nuk e shfrytëzoi profilin e tij si njohësi më i mirë i të dy letërsive në Maqedoni, asaj shqiptare në përgjithësi dhe asaj maqedonase, për komunikimin e së cilave është një nga kontribuuesit më të shquar.

*A nuk duket sikur është zbehur roli i kritikut që me rënien e regjimit të kaluar? Më saktë: duket sikur mungon dukshëm, siç thuhet. Dihet roli që kishte kritiku atëkohë, por edhe mbështetja e madhe që kishte nga lart, për arsye të qarta ideologjike. Mos duhet ta gjejmë këtu arsyen*

*pse nuk kemi një koncept të qartë të kritikut në kohën e sotme? Në Tiranë dhe Prishtinë janë një numër studiuesish dhe kritikësh të rinj që kanë studiuar në Perëndim. A janë ata shpresa për një zhvillim të pritshëm të kritikës?*

Duke u pajtuar me konstatimin tuaj, përgjigjen po e nis nga fjalja e fundit e pyetjes: po, hapësira shqiptare e Ballkanit për çdo vit përcjell qindra të rinj për shkollim nëpër botë. Një numër i mirë i tyre kthehen. Natyrisht, jo të gjithë me diploma të universiteteve prestigjioze. Të tillët, edhe pse janë pakicë, për fatin tonë të keq, nuk pranohen nga kjo perspektivë përparësie, por trajtohen në turmë, bashkë me ata që kthehen me përgatitje modeste. Në mesin e pakicës ka të rinj me formim të lartë profesional që do ta gjallëronin kritikën letrare, do ta rrisnin nivelin shkencor, por u mungon hapësira që do t'i stimulonte. Media jonë e marrosur pas reklamës dhe klikimit pëlqyes mekanik ka përjashtuar, në limite minimale, vlerat në art, në estetikë, në etikë... Këta të rinj, me përgatitje të lartë dijeje dhe formim nga këto fusha, edhe me pasionin për t'iu përkushtuar shkencës letrare, qoftë në Tiranë, qoftë në Prishtinë, dalin në rol të dytë përballë shoumenëve, që, përditë e më agresivisht, e pushtojnë hapësirën mediatike, sidomos në fushën e vlerave për të cilën flasim, duke mos mundur të sigurojnë as minimumin e ekzistencës së përditshme sociale. Që do të thotë se për një ndryshim serioz në këtë fushë duhet ndërhyrje e përkrahje institucionale tash për tash e munguar.



Rexhep Ismajli

## DISKUTIM: IMPRESIONI / REFLEKSIONI

Më së pari, i dashur Ali, urime për përvjetorin dhe uroj të shkojmë sa më larg!

Unë i dëgjova me shumë vëmendje kumtesat dhe nuk dua të komentoj kumtesat, natyrisht, por sikur të kisha marrë pjesë në një diskutim që është pak më i veçantë i degës – dhe jo i degës ku jam unë – do të kisha problematizuar një çështje që nuk është çështje që lidhet me Aliun, por që është një çështje më e përgjithshme. E kam dëgjuar jo rrallë, ndoshta edhe këtu dikush e ka përmendur – më falni që nuk i mbaj mend të gjitha detajet – që ekziston një distinkcion midis kritikës impresioniste dhe kritikës tjetër, më duket se Sabriu e përmendi lidhjen me Konicën në fillim, dhe do të kisha menduar për këtë çështje në një mënyrë pak më konsekuente – deri në fund ta çojmë çështjen. Sigurisht se leximi i letërsisë është në pikën e parë përshlyetje – impresionin është gjëja e parë që vjen. Impresioni nuk do të thotë se në procesin e kritikës pastaj mbetet vetëm impresion, ai shndërrohet në refleks, refleksion, dhe refleksioni shkon pak me tutje, pra kemi të bëjmë me një çështje që shkon pak më larg.

Me Aliun njihemi shumë kohë, në vitet '70 p.sh., kishim ndonjë diskutim dhe diskutohej ta zëmë një koncept tjetër, integraliteti, koncepti integralist e të tjera, dhe natyrisht mund të kishim mendime të ndryshme. Unë qysh atëherë kisha vërejtur se Ali Aliu nuk ishte ndër ata që do t'i shtrohej as atij koncepti që ishte shumë imponues atëherë për shkak të rrethanave, por impresionin tek Aliu unë qysh atëherë e hetova si diçka tjetër, si refuzim i katalogizimit, i teknikitetit dhe i vështrimit të detajit, pra si një refuzim i kësaj. Dhe ndër ata që sot kam parë, ndonjëherë e vlerësojnë kritikën impresioniste si kritikë të kësaj natyre apo të kësaj shkalle të vlerësimit – ka keqkuptim në këtë drejtim. Mendoj se nuk ka të bëjë këtu asgjë me një orientim të atillë. Aliu, pos të tjerash, ka qenë profesor i *Teorisë së letërsisë*, ka përkthyer tekste letrare dhe nuk ka mundur të jetë jashtë këtyre rrjedhave, por është zgjedhje e tij që përmes formës së impresionit ta përçojë sa më mirë dhe sa më larg idenë themelore që ka për veprën. Dhe, kuptohet, në këta 50-60 vjet sa njihemi, koncepti i tij edhe për impresionin ka ndryshuar. Prandaj, është e mundshme që të shihet në një mënyrë të frytshme në këtë drejtim edhe si një ndihmesë për ta parë letërsinë në zhvillimet e

saj, me dinamizmin e saj, duke refuzuar numërimet, elementet e tjera teknike si përbërëse.

Faleminderit!\*

---

\* **Sabri Hamiti:** Rexhepit faleminderit, sepse shtroi dy gjëra esenciale rreth kuptimit dhe interpretimit të letërsisë. Kjo është e pritshme, sepse Rexhepi sot e ka zërin si gjuhëtar, sigurisht një ndër gjuhëtarët më të mirë që kanë shqiptarët. Madje, i ngjet pak Eqrem Çabejt të fillimit. Dy librat e parë të Rexhep Ismajlit: *Shenjë e ide* dhe *Shumësia e tekstit*, në të vërtetë janë libra afër letërsisë dhe për letërsinë, për lidhjet e gjuhësisë me letërsinë, duke shpaluar metodat moderne të kohës. Edhe sot Rexhepi është lexues me shkrim i letërsisë shqipe dhe përkthyes i saj i njohur në gjuhë të tjera.

Ali Aliu

## FJALA PËRSHËNDETËSE

(Qirinjtë e jetës)

Përshendetje të gjithëve që janë të pranishëm! Mua në këto çaste m'u kujtua një poezi e Kavafit, "Qirinjtë e jetës". Në një përvjetor, ai thoshte "i kam fikur kaq qirinj dhe nuk e di sa më kanë mbetur, por kanë mbetur pak". Dhe mes rrugës se lexuar dhe kësaj është që është ende e palexuar, është enigmë, është mister. Unë mendoja që të bëja një tekst dhe hoqa dorë. Hoqa dorë edhe për një arsye praktike të moshës, se në ekspozime të tilla të gjata mjafton një digresion i vogël dhe të thuash "o ku mbeta, ku e lashë". Doja disa fjali t'i them edhe lidhur me letërsinë. Letërsinë gjithnjë e kam konsideruar si gati diçka të shenjtë. Dhe në Prishtinë kam punuar një kohë edhe te Shtëpia Botuese *Rilindja*. *Rilindja* gjatë viteve '60-'70 ishte shtëpi e të gjithë shqiptarëve në Jugosllavinë e atëherëshme dhe unë kisha dëshirë e ambicie të lexoja gati çdo gjë, çdo botim. Një univers librash i kufizuar, ndaj nuk ka qenë vështirë që një lexues i rëndomtë, me pak kërshtëri, gati të lexojë çdo gjë. Dhe gjithnjë kam qenë mirënjohës ndaj shkrimtarëve, edhe ndaj atyre që i kam lexuar dhe nuk kam folur publikisht, por kam komunikuar me ta duke bërë shënime në margjina, sikur t'u dal hakut dhe kështu kam menduar për krijuesit, shkrimtarët dhe shpesh kam thënë kur ndonjë nga shkrimtarët më ka thënë faleminderit për shkrimin, them duhet të ndodhë e kundërta, lexuesi duhet të falënderohet për shkrimtarin që ofron e dhuron një kënaqësi, një vepër ku lexuesi e identifikon veten me situata e me personazhe dhe ajo është një kënaqësi. Dhe them ky ka qenë raporti im me letërsinë shkurtimisht, se u fol mjaft dhe në mënyrë shumë të sistemuar për këtë raport. Në fund dua të theksoj një nismë të kësaj Tryeze – kjo ka ndodhur gati këtu e një vit përpara, në mos harroj në qershor të vitit të kaluar, në një nga mbledhjet e zakonshme të seksionit tonë. Shefi i atij seksioni, Sabri Hamiti, doli me një propozim të tillë dhe ai kur i bën propozimet, i bën në mënyrë shumë të sistemuar, i mendon mirë, jo të natyrës kur ne ndonjëherë kujtohem filani mbushi tetëdhjetë vjet edhe organizohemi të ndërmarrim e ta shënojmë atë përvjetor. Epo, kjo e bërë gati një vit përpara, do të thotë e ka parë edhe kalendarin, e ka parë në një mënyrë vëmendjen time për autorë të

caktuar, për miq, dhe doli me një projekt të saktë, siç e kishte menduar dhe herë pas here në kafene, pas një muaji dy, do të thoshte “ej, po më ecën shumë mirë, po komunikoj me ata të cilëve iu drejtova për një pjesëmarrje në tryezë të tillë dhe e kanë pranuar me dëshirë”. Kështu e ka ndjekur këtë projekt, me një zell miqësor. Dhe unë do të flas pak për këtë miqësi që njeriu e ndien në mjedisin ku jeton, një familje, një degë e familjes siç është seksioni ynë, por edhe streha e një institucioni siç është Akademia. Të ndihesh mirë, të ndihesh që rreth vetes ke një ndjeshmëri miqësore, është punë e madhe. Unë e mbaj mend gjyshen time nga babai, që jetoi 102-103 vjet – ajo gjithnjë urimin e parë për vete dhe për të tjerët e kishte *pleqëri me nder, pleqëri e mirë*, dhe të ndiesh një atmosferë miqësore në një strehë ku unë tashti jam gati tridhjetë vjet, këtu me miq e me ish-kolegë në universitet, është pleqëri e mirë, të ndihesh kështu është pleqëri e mirë.

Faleminderit Sabri Hamitit për këtë përjetim, për këtë ndjeshmëri, edhe Kryetarit të Akademisë dhe Akademisë si institucion.

Faleminderit!

**AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS  
AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË**

**Tryezë shkencore**

**KRIJIMTARIA LETRARE E ALI ALIUT  
Në 90-vjetorin e lindjes**



**2 PRILL 2024, ORA 9:30  
SALLA E AKADEMISË  
PRISHTINË**





KRIJIMTARIA LETRARE E ALI ALIUT  
(Në 90-vjetorin e lindjes)

Tryezë shkencore  
Prishtinë, 2 prill 2024

2024

*Botues:*  
AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

*Redaktor teknik:*  
ASHAK

*Realizimi kompjuterik:*  
ASHAK

*Madhësia:* 7.5 tabakë shtypi  
*Tirazhi:* 300 copë  
*Formati:* 16x24 cm

*Shtypi:*  
Focus Print  
Shkup

Katalogimi në botim – (CIP)  
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

821.18.09(496.51)(063)Aliu, Ali

Krijimtaria letrare e Ali Aliut : (në 90-vjetorin e lindjes) : tryezë shkencore = Ali Aliu's Literary Work : (On the 90<sup>th</sup> anniversary of his birth) : A discussion / Këshilli organizues: Sabri Hamiti, Mehmet Kraja, Shaban Sinani. - Prishtinë : Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. - 117 f. : ilustr. ; 24 cm. - (Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë ; Akademia e Shkencave e Shqipërisë)

1. Hamiti, Sabri      2. Kraja, Mehmet      3. Sinani, Shaban

**ISBN 978-9951-26-086-2**